Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0074434/24 dt. 15.11.2024
Mitrovicë

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesja e Kuvendit të Komunës për të **martën** më dt. **26.11.2024**:

T H Ë R R E T
Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës
Seanca e 36-të

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft-Rregullore për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale
3. Draft-Statuti i Bibliotekës së qytetit "Latif Berisha"
4. Plani i veprimit për persona me aftësi të kufizuara për vitet 2025-2027
5. Plani i veprimit për shërbime sociale e familjare
6. Pyetje dhe përgjigje

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë

Kryesuesja e Kuvendit
Vesa BROJA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0069482/24 /24 dt. 23.09.2024
Mitrovicë

P R O C E S V E R B A L
Nga mbledhja e 35-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

Koha: 30.10.2024 ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Egzon Hamza, Lavdim Zeneli, Nafije Rexha, Mentor Vinarci, Faruk Mujka, Hysen Muzliukaj, Naser Muja, Armend Begu, Ekrem Sadiku, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Xhyljeta Imeri, Sevdaim Uka Gazmend Asllani, Muhamed Hoti, Oltion Ahmeti, Ardita Aliu, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Vesel Neziri

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Mungoi: Shkëlqim Ibrahimi, Hamdi Hasani, Flutura Beka Kamberaj, Elidiana Budini Haziri, Shkurta Shosholli Musa dhe Xhevrije Bahtiri Ademi.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës ka thirrur mbledhjen e 35-të të rregullt të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje. Para se të hap diskutimin për rendin e ditës dua të propozojë propozim Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së datës 31.07.2024 Për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Është një çështje që e kemi diskutua në një seancë para se me u miratua këtë pikë edhe është çështja e 40.000 € tjera, për shkak se 120.000 kanë qenë të ndara në kodin i cili na ka ardhur në propozim-vendim, edhe u shkaktua problemi për 40.000 € të tjera, ku na ka ardhur përgjigjja se nga cila kategori dhe nga cila drejtori mu marr këto mjete për me i paguar edhe katër familje që kanë mbet pa u kompensua me Vendimin të cilin e kemi marrë. Propozim vendimin propozoj ta fusim si pikë e katërt e rendit ditës, edhe po e hapi për diskutim, nëse ka dikush diçka për rend dite.

Faruk Mujka: Nuk kam pikë shtesë, por dua të lidhem me këtë pikën që na ka ardhur shtesë, veç po du me ju thënë që padrejtësisht na keni sulmuar atë ditë nëpër media, kur ju kemi tregu që këto 40.000 € nuk munden me u procedua dhe ju po atë ditë na keni sulmuar nëpër media si bllokues të familjeve të prekura, si pengues të realizimit të pagesave, e tjerë, e tjerë. Edhe sot po vijmë prapë këtu, ku nga ana juve jeni ardhur në përfundim prapë që nuk ka mundur me ecë ashtu qysh na kemi thënë. Pra, absolutisht jena për t'u ndihmua familjet, por nuk jena për mënyrën se si e keni trajtuar atë çështje para katër muajve. Prandaj, mendoj që duhet me pas një reagim prej anës suaj.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Asamblesë Komunale, për drejtorët dhe të gjithë të pranishmit. Ose më ka ikur mua, mirëpo unë të paktën nuk kam parë që ka pas kundërshtime prej anëtarëve të Asamblesë Komunale që ato familje me u përkrahë, pa dallim politik. Atyre ju

ka ndodhur një fatkeqësi, realisht dëmet i kanë shumë të mëdha, kjo çka po e bën Komuna e Mitrovicës, Kuvendi Komunal, është një ndihmë e cila për familjet realisht nuk është që ia zgjidh problemin, po të paktën është një përkrahje, një mbështetje. Po çfarëdo keqkuptime që ka mund me pas, unë s'e kam problem me kërkuar falje. Mirëpo, çfarë është tash dhe çfarë duhet me pas kujdes edhe në të ardhmen, në situata të tilla, në bazë të përvojës së kaluar, sikur në nivel qendror e edhe në atë lokal, kur të merren mjetet duhet me qenë bukur specifik për me pas në procesverbal, edhe për me pas të incizuar. Përndryshe, kuvendi me shtuar shumën, mundet me rrit numrin e familjeve, nëse ka gjithmonë bazë të arsyeshme, mundet me rrit shumën, por gjithmonë duhet me u specifiku prej cilës linjë paguhen. Këtu në këtë rast do të thotë teknikisht pse është mbete e pa plotësuar kjo pjesa, se nga ku merren mjetet për shkak se aty kanë qenë 120.000 €, ndërkohë janë bërë 160.000 € se janë shtuar edhe katër familje, ka pas rrëshqitje të dheut më vonë dhe dëmtime të shtëpive. Kështu që tash po kërkohet për me u specifiku edhe për 40.000 € që familjet me u kompensua. Përndryshe, po e them me sinqeritetin më të madh, ose diçka mu më ka ikë ose s'jam në informacion, ose çfarë ka ndodhë tjetër nuk mund me e ditë, por unë nuk kam pa që ka kundërshtime prej ndonjë partie politike, asamblisti për me ju ndihmua atyre njerëzve. Prandaj, as këta s'kisha pas qejf me nda si meritë e një subjekti, e një individi, e një asamblisti, e një drejtori, kjo është gatishmëri edhe përkrahje nga asambleja komunale, pa dallim politik për ato familje, të cilat përnjëmend kanë pësua një dëm shumë të madh, sepse aty iu ka pamundësua jeta edhe ata janë të detyruar me u shpërngulë prej aty. Prandaj, e thashë z. Mujka me sinqeritetin më të madh, çfarëdo mungese e komunikimit, çfarëdo qëndrimi, çfarëdo situate ku dikush donë me përfitua merita e dikujt ti hidhet faji, për mua në këtë rast janë të papranueshme.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Njëra ndër çështjet që u diskutua ditën kur vendimi nuk i ka marrë votat e mjaftueshme me kalua si pikë, ka qenë çështja e 40.000 €, kjo është e qartë. Ditën kur u votu pika, nuk e kemi specifiku decidivisht se në cilën kategori kanë me u marrë edhe këto 40.000 €. Na është paraqitë si problematikë dhe për këtë arsye e kemi sjell që të zgjidhet kjo çështje.

Hysen Muzliukaj: Pikërisht për temën e njëjtë para disa muajve kur ka qenë kjo pikë në rend të ditës e që nuk ka kalua, pyetja ime lidhet me atë që e tha shefi i grupit të vetëvendosjes, që kam thënë ju në buxhet i keni projektua 120.000 €, buxheti është ligj. Kryetar, kam thanë se këto 40.000 € se ku do t’i merrni. Nuk ma kanë specifiku në atë kohë, edhe realisht na jena sulmu në atë pikë pse na nuk e kena kalu. Mirëpo na proceduralisht kemi tregu edhe atëherë që duhet me specifiku kodin se ku do t’i marrim këto 40.000 €, për arsye se 120.000 € për 12 familje janë projektua në buxhet dhe buxheti është ligj. Po ashtu, absolut asnjëri prej neve nuk ka shprehë një qëndrim negativ kundër kësaj ndihme, të gjithë kemi qenë unik për procedurën, për gjetjen e procedurës.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Po besoj që për këto që jemi në linjë të njëjtë, do të thotë seancën kur është diskutuar, tani nuk kam qenë, ashtu qysh është specifiku, seancën e fundit kam qenë prezentë, tash të them të drejtën, unë jam ithtar i asaj që gjithçka të shkon më përpikëri, mirëpo kur janë pyetje mallrat dhe shërbimet dhe subvencionet, nuk është krejt sikur te investimet kapitale, por sidoqoftë. Është e nevojshme që sot ta specifikojmë ku merren këto 40.000 € që t'i kompensojmë edhe këto katër familje. Unë e thashë, çfarëdo qëndrimi që ka bëjë me marrjen e meritave apo me akuza ndaj dikujt, se s’ka qenë në përkrahje të kësaj apo kësaj, për mua nuk janë të pranueshme. Qysh s’kanë qenë për shumë raste ku kjo asamble ka votua në mënyrë unike pa dallim, se në fund nuk mund të them që shqetësimet e mia janë më të mëdha se shqetësimet e kujtdo qoftë këtu në këtë kuvend për ato familje. Prandaj, besoj që e kemi të qartë, po e lypim mirëkuptimin e juaj që e njëjta të futet në rend të ditës, të votohet prej nga të merren mjetet të jetë një praktikë për të ardhmen që kur ka raste të tilla të specifikohet edhe në vendim.

Fahri Jashari: Më lejoni që si pikë të rendit të ditës ta propozoj çmimin “Lah Nimani”, ne si drejtori kemi filluar procedurat për formimin e këtij komisioni, kemi caktuar edhe anëtarët të cilët do të jenë nga ana e drejtorisë. Prandaj, po besoj që edhe pjesën tjetër kuvendi do t'i propozojë sot.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Atëherë, propozimi konkret është propozim vendim për formimin e komisionit për ndarjen Çmimit “Lah Nimani”. Nëse kemi dakordancë, na e fusim si pikë të rendit të ditës, edhe unë, sekretaria merret tash sa i përket materialit si propozim vendim,

Vesel Neziri: Unë po shpresoj që propozimi i dhënë nga drejtori është propozim me vend, duke i parë rrethanat qysh ndodhi vitin e kaluar, ku u vonuam me procedura dhe u vonua për gjithçka. Shpresoj se

është një propozim mjaft me vend edhe ky propozim, pa hezitim prej gjithë këta subjekteve politike, duhet përkrahur në mënyrë që na t'i vazhdojmë punët dhe që viti i ri na gjen me ndarjen e çmimit dhe mos të ketë vonesa sikur në vitin e kaluar.

Gazmend Asllani: Unë së pari kërkoj një raport për fund të mbledhjes, por drejtoresha e Arsimit nuk qenka këtu, një raport të konkursit të datës 27.09.2024 Për përzgjedhjen e agjencisë së udhëtimit të nxënësve për ekskursion në Shqipëri. Aty, po flas për Shkollën e Mesme të Mjekësisë, kompania më e shtrenjtë është dalë përfituese. Në këtë mënyrë e dua një raport prej drejtorisë së arsimit me e pa se pse u dalë "agjensioni" më i shtrenjtë përfitues. Çështja tjetër, kërkoj nga drejtoresha e arsimit një raport për regjistrimin e nxënësve në klasat e dhjeta, në Shkollën e Mesme Mjekësisë, ku kriter në konkurs ka qenë 24 nxënës për klasë, ndërsa aty tash janë regjistrua qe dy javë, pothuajse mbi 31 nxënës nëpër klasë. Edhe këtu dua të kem një raport prej drejtorisë së arsimit pse është ky numër kaq i madh edhe pa kriter pas konkursit.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Duke e marrë parasysh që edhe nuk drejtoresha këtu, po edhe me pas qene ajo, nuk po besoj që kishin pasur mundësi me nxjerrë një raport sot brenda ditës. Kështu që me mirëkuptim, dy kërkesat tua do t'i shkojnë drejtoreshës, por me mirëkuptimin tënd me i lënë në seancën e ardhshme, faleminderit shumë.

Kushtrim Zeneli: Për pikën që dua të diskutoj vlerësojeni ju si të doni, ose le të futet në pikë të rendit të ditës, ose në fund të seancës le të jetë si një pikë sqarimi pra mund t'i bashkëngjitet propozimit të z. Asllani, kjo pikë ka të bëjë me transportin e nxënësve të shkollave fillore prej klasës së 5-të deri në klasën e 9-të, një numër i madh i fshatrave të Mitrovicës, tash e disa muaj janë pa transport të nxënësve edhe itinerari që e bëjnë atë, janë prej 3 deri në 6 kilometra në këmbë. Pra kërkoj që të kemi një sqarim se pse po e ndodh kjo. Nuk është një problem i vetëm këtij viti, edhe vitin e kaluar ka qenë një problem, mirëpo tash po fillon të ftohet koha edhe po e shohim edhe praninë e qeneve endacak e sigurisht që dihet se rrezikohen më së shumti fëmijët. Të marrim ndonjë hap që të mos vije situata deri te ndonjë pasojë.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Faleminderit z. Zeneli, sepse e keni ngrit një shqetësim që është shqetësim i gjithë neve, çështja e transportit të nxënësve, por po besoj që definitivisht është adresuar kjo. Ka qenë kryesisht për shkak të sigurimit të mjeteve për lidhjen e kontratës, zotimet të mjeteve dhe kanë qenë procedura administrative. Nuk them që nuk kanë mund të kryhen më herët, po janë përfundua dhe nuk shoh më ndonjë pengesë që kjo çështje përfundojë. Unë dua të besoj se gjithçka është zhvillu në procedurë, në rregull dhe nxënësit me pas transportin e vet. Por, mbi të gjitha kanë qenë kryesisht procedura administrative rreth zotimit të mjeteve dhe çështje tjera që ndërlidhen me nënshkrimin e kontratës.

Kushtrim Zeneli: A ka ndonjë afat se kur pritet të përfundohet kjo, mbase veç jemi në këtë temë.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Unë nuk po shoh më asnjë pengesë që ata me fillua, prej javës së ardhshme me i bartë nxënësit.

Erseka Barani: Meqë jemi në muajin e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, kam pritë që këtë muaj të kemi një raport nga drejtoria e shëndetësisë, pak a shumë me na informua se sa gra janë përkrahë nga kjo drejtori përmes subvencioneve, sa gra të prekura nga kanceri i gjirit, cilat janë aktivitete që pikërisht Drejtoria e Shëndetësisë i ka ndërmarrë për të lehtësuar gjendjen e grave të prekura nga kanceri i gjirit, si dhe shërbimet që janë kryer në mamografi, në Qendrën Kryesore Të Mjekësisë Familjare.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: nëse është e mundshme drejtor, çështjet që i ngriti znj. Erseka me na ardhur në seancën e ardhshme me një lloj informate nga drejtoria e shëndetësisë.

Ekrem Sadiku: Seancën e kaluar unë pata kërkua me një arsyeshmëri këtu që Drejtoresha e Arsimit me e sjellë një raport në lidhje me mungesën e mësimdhënësve nëpër shkollat e Mitrovicës. Mirëpo atë sot nuk po e shoh edhe me sa di unë pjesa dërrmuese e atyre shkollave të cilat i kam potencuar kanë qenë diku në 14 deri në 17 mungesa të mësimdhënësve dhe ajo çka ka qenë më se shqetësuese është se e kam potencuar edhe atë ditë që mësimdhënësit kanë vazhdua të mos jenë nëpër ligjërata në lëndë të caktuara edhe për një vit të tërë kalendarik. Kjo ka qenë jashtëzakonisht shqetësuese, mirëpo fatkeqësisht atë raport nuk jam duke e parë dhe nuk e kam marrë këtë informatë as përmes e-mail-it.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Po besoj që veç çështja juaj mundet me ju bashkëngjit dy çështjeve që i ngriti z. Asllani edhe me na ardhur edhe kjo çështje si informatë nga drejtoresha e arsimit në seancën e ardhshme, pasi që sot drejtoresha nuk është prezente.

Kushtrim Zeneli: Pasi që u diskutua për drejtorinë e arsimit, dhe pasi që po pritet edhe në seancën e ardhshme me ardhur një raport tjetër, unë kisha propozua që me u shtua edhe një çështje shumë e rëndësishme. Kryetari e din se një numër i madh i shkollave nëpër fshatrat e Mitrovicës, e sidomos fshatrat e Shalës së Bajgores, po mbyllen, janë mbyll edhe ndoshta pritet edhe me u mbyllë. Po ashtu edhe ato shkolla janë pronë e komunës dhe drejtorisë së arsimit. dy ose tri shkolla prej tyre i kam vizitua vetë, është shkolla në Fshatin Tërsten, shkolla në Fshatin Mazhiq, po edhe në Selac, janë në gjendje të mjerueshme, është mirë që drejtoresha me ardhë me një raport së çka është duke ndodhë me ato shkolla që janë mbyllë, kush i mirëmban ose tash kush duhet me u marr me to? E vërtetë që ato janë mbyllur mirëpo mos t'i shkatërrojmë.

Kryesuesja e Kuvendit znj.Vesa Broja: Në rregull, e bashkëngjisim edhe pyetjen e tillë edhe kërkesën e z. Kushtrim Zeneli në kërkesat që i cekëm. Atëherë po vazhdojmë me plotësimin e rendit ditës.

Kryesuesja e Kuvendit: Pasi nuk ka të lajmëruar të tjerë për diskutim për rendin e ditës vë në votimin propozimin që pikë e 4-të e rendit të ditës të jetë Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 02-060/01-0049042-2/24 /24 dt. 31.07.2024 për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së jugut.

Rezultati i votimit 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar propozimin që pikë e 4-të e rendit të ditës të jetë Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 02-060/01-0049042-2/24 /24 dt. 31.07.2024 për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së jugut.

Kryesuesja e Kuvendit: Pasi nuk ka të lajmëruar të tjerë për diskutim për rendin e ditës vë në votimin propozimin që pikë e 7-të e rendit të ditës të jetë Propozim vendimi Për formimin e komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani".

Rezultati i votimit 29- për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar propozimin që pikë e 7-të e rendit të ditës të jetë Propozim vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani".

Kryesuesja: Hedh në votim rendin e ditës të plotësuar:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim-vendim për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025
3. Propozim-vendim për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave
4. Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 02-060/01-0049042-2/24 /24 dt. 31.07.2024 për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së jugut.
5. Kërkesë për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë për mbulimin e shpenzimeve të varrimit
6. Raporti financiar për periudhën janar-shtator 2024
7. Propozim- vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani"
8. Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit: 29- për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja hapi diskutimin për Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Rezultati i votimit: 29 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht pa diskutim.

Pika 2

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Si pjesë e kësaj pike hyn edhe formimi i komisionit për ndarjen e bursave, ku do t'i kemi tre anëtarë të cilët zgjedhën nga anëtarët e kuvendit dhe dy anëtarë nga ekzekutivi. Po ashtu edhe numrin e bursave, cilat do të ndahen këtë vit, fjalën ia kaloj Kryetarit.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Mendoj dhe shpresoj që kemi me pas edhe mirëkuptimin e përkrahjen si gjithmonë të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Duke pas qëllim përkrahjen e studentëve, propozoj që numri i bursave të ngritet në 300 bursa për vitin e ardhshëm. Çdo vit kemi pas rritje të numrit edhe çdo vit kemi pas kërkesa më tepër se që kemi pas mundësi. Mjetet shtesë, nëse kemi bartje të hyrave do të sigurohen nga bartja e të hyrave, ndërsa, në rast se nuk kemi bartje të të hyrave, mjetet shtesë do të ekzekutohen nga kategoria subvencione programi për shërbime sociale. Isha shumë specifik.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Pasi që i kemi tre anëtarë nga kuvendi, propozoj që të shkojmë një anëtar nga pozita dhe dy anëtarë nga opozita, si dhe dy propozohen pastaj prej Kryetarit nga ekzekutivi. Ju kisha lutë me pas parasysh edhe barazinë gjinore gjatë propozimeve. Atëherë fillojmë me propozimet e kandidatëve për anëtar të komisionit nga përfaqësuesi i G.P. të PDK-së.

Fisnik Suma: Për anëtarë të Komisionit për ndarjen e bursave nga radhët e PDK-së propozoj z. Fisnik Krasniqi.

Faruk Mujka: Për anëtarë të Komisionit për ndarjen e bursave nga radhët e LVV-së propozoj z. Jeton Zeneli.

Xhyljeta Imeri: Për anëtarë të Komisionit Komunal për ndarjen e bursave nga radhët e LDK-së propozoj z. Gazmend Asllani.

Kryetari i Komunës nga ekzekutivi propozon znj. Drita Kadriu dhe znj. Igballe Islami.

Kryesuesja e Kuvendit: Hedh në votim Propozim vendimin për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025 dhe formimin e Komisionit për ndarje të bursave, me këtë përbërje:

1. Fisnik Krasniqi,
2. Jeton Zeneli,
3. Gazmend Asllani,
4. Drita Kadriu dhe
5. Igballe Islami.

Rezultati i votimit: 29- për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025 duke përfshirë edhe përbërjen e Komisionit për ndarje të bursave.

Pika e 3

Kryesuesja sa i përket Propozim vendimit për formimin e Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave, Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, dy anëtarë nga kuvendi, dy nga ekzekutivi, dhe një anëtarë nga shoqëria civile. Atëherë propozoj të fillojmë me propozimet.

Faruk Mujka: Për anëtar të Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave propozoj: z. Armend Begu.

Xhyljeta Imeri: Për anëtar të Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave propozoj z. Muhamed Hoti.

Kryetari i Komunës për anëtarë të Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave nga ekzekutivi propozon znj. Drita Ibrahimi dhe z. Ferdi Kadriu.

Kryesuesja Vesa Broja: Për shkak të kuotës nga shoqëria civile e propozojmë ndërsa nga shoqëria civile znj. Valbone Sadiku , Meqenëse nuk kemi propozime të tjera atëherë hedh në votim propozimin për formimin e Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave me këtë përbërje:

1. Armend Begu,
2. Muhamed Hoti,
3. Drita Ibrahimi,
4. Ferdi Kadriu, dhe
5. Valbone Sadiku.

Rezultati i votimit: 29 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për formimin e Komisionit e Komunal të ankesave për ndarjen e bursave.

Pika e 4

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Propozim Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 02-060/01-0049042-2/24 /24 dt. 31.07.2024 për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së jugut.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja hedh në votim Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 02-060/01-0049042-2/24 /24 dt. 31.07.2024 për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së jugut.

Rezultati i votimit: 27- për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 02-060/01-0049042-2/24 /24 dt. 31.07.2024 për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së jugut.

Pika e 5

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Po e hapi diskutimin për këtë pikë. Me këtë vendim, autorizohet Kryetari të bëjë marrëveshje me Kryetarin e këshillit tëbashkësisë islame për shpenzimet e varrimit.

Xhyljeta Imeri: Vazhdimi i kontratës me bashkësinë islame në Mitrovicë për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët myslimanë është e mirëseardhur për secilën familje që përfiton këtë shërbim. Dua të ngriti një çështje, duke u bazuar në ligjin për liritë fetare. Ku në nenin katër parashihet ekzistimi i shtatë bashkësive fetare, të cilat sipas ligjtt përbëjnë edhe trashëgiminë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit. Në nenin 4.1 bashkësitë fetare ekzistuese dhe ato të reja që regjistrohen do të fitojnë statusin juridik dhe kanë të drejtën e themelimit të institucioneve të ndryshme brenda tyre me karakter humanitar fetar, edukativ, arsimor apo karakter tjetër të ngjashëm. Në bazë të këtij Ligji, por edhe nga aspekti njerëzor, kërkoj nga ekzekutive të marrin vendim për rregullimin e shpenzimit të varrimit me të njëjtën shumë edhe për qytetarët e besimeve tjera fetare në qytetin tonë.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Këtë çështje e kemi diskutuar edhe në Komitetin për politikë dhe financa dhe e kemi lut drejtorinë që një çështjeje të tillë t'ia bëj zgjidhjen edhe kur të bëhet zgjidhja, të na vijë me propozim konkret edhe në kuvend, pasi që jemi dakordua që të gjithë kemi qenë për që me ju bë zgjedhje edhe feve tjera.

Kryesuesja hedh në votim Kërkesën lidhur me vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë për mbulimin e shpenzimeve të varrimit dhe të Autorizohet Kryetari i Komunës të rinegociojë dhe të arrijë Marrëveshje me Këshillin e Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë për vazhdimin e Marrëveshjes Për kryerjen e shërbimeve dhe ceremonive fetare.

Rezultati i votimit: 21 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Kërkesën lidhurvazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë për mbulimin e shpenzimeve të varrimit dhe të Autorizohet Kryetari i Komunës të rinegociojë dhe të arrijë Marrëveshje me Këshillin e Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë për vazhdimin e Marrëveshjes Për kryerjen e shërbimeve dhe ceremonive fetare.

Pika e 6

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Raportin financiar për periudhën Janar-Shtator 2024, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtoreshës znj. Igballe Islami.

Pas arsyetimit të pikës nga znj. Igballe Islami, Kryesuesja Vesa Broja hapi diskutimin.

Fadil Veseli: Raporti financiar Janar-Shtator 2024, ka arritur të realizohet 68%, në këtë raport duke mos e përfshirë edhe të hyrat e gjobave nga trafiku që janë pjesë e të hyrave indirekte dhe gjykatave, disa shpenzime që barten tek buxheti i komunë. Kështuqë nëse shikohet si përqindje, domethënë aty për aty i afrohet 75% që nëse llogaritet për nëntë mujor diku 100% i realizuar. Shpresojmë se me këtë angazhim dhe pak me një angazhim shtesë të ekzekutivit, unë po shpresoj që të hyrat vetanake në këtë vit do të tejkalohen, çka është pozitive se sa më shumë të hyra mundësohet në njëfarë forme që të plotësohen edhe disa nevoja të qytetarëve. Te tabela numër 2, te kategoritë ekonomike, shihet se pagat dhe mëditjet janë të realizuara deri më tani 87%, nëse shikohet në mënyrë direkte këtu shihet se diku edhe një muaj ka paga, më shumë në njëfarë forme nuk do të ketë mbulesë prej këtij fondit të pagave që janë parapa nga buxheti i vitit. Mirëpo kjo eshtë e theksuar, edhe në komuna tjera, që është një problem kompleks dhe po nxjerr telashe ndërmjet Qeverisë dhe Komunave, për shkak të kontratave kolektive që në njëfarë forme disa komuna veç kanë has në vështirësi që po kanë bllokadë të buxhetit, tek ne ende po mbijetojmë. Unë po shpresoj që do të gjendet zgjidhja, por do të goditen sidomos investimet kapitale, se shuma diku duhet mu marrë për me u paguar pagat, se realisht me shikua në bazë të kësaj përqindje edhe një muaj, më shumë nuk ka mbulesë. Te investimet kapitale gjendja është, nëse merret parasysh tash realizimi 49%, domethënë të planifikuara kanë qenë total 7,500,000.00 €, janë realizuar3,700,000.00 €, mirëpo nëse merret edhe si bazë viti kaluar, atëherë shihet se ka një ngritje prej 41% sa ka qenë vitin e kaluar, këtë vit është 49%, pra është një ngritje dhe duke u bazu në punët në terren që janë, shpresohet që kjo kategori e investimeve kapitale së paku do ta kalojë 80%. Pra që është pozitive edhe për performancë. Tjetër, tash nëse shikohet te lëndët e ekzekutuara nga thesari, këtu nuk del aq hijeshi për shkak se katër 4,100,000.00 € veç janë tërhekë direkt prej ministrisë, mirëpo nëse shikohet përmbajtja e shifrës për diku në afër 3,000,000.00 €, domethënë janë të tërhekura vetëm prej kategoritë e pagave dhe mëditjeve, që përfshin kontrata kolektive, që i është bartë komunave pa pëlqimin në njëfarë forme të tyre dhe e ka goditë direkt. Kjo është njëfarë telashe sepse e mira është që edhe qeveria dhe kryetarët e komunave ta gjejnë një model, për shkak se këto mjete të cilat iu takojnë mësimdhënësve në aspektin ligjor e gjyqësor, jemi të obliguar si komunë t'i paguajmë në njëfarë forme, por nuk janë paraparë me ligj. Pra , është një performancë jo e mirë, sidomos për vitin e ardhshëm, që ka me qenë pengesë edhe për ekzekutivin, edhe për neve, për performancë jo të mirë për shkak se e bën debalancin te kategoritë ekonomike, domethënë këto mjete diku duhet me i marrë, që kanë qenë të parapara nëpër kode dhe kur ti marrësh atëherë, automatikisht aty jetë zbrazëtirë dhe mbetet puna pa u përfundua.

Hysen Muzliukaj: Unë i kam i kam disa pyetje lidhur me Raportin financiar. Kam pyetje për drejtoreshën e financave meqë është këtu. I shikova pagesat me përmbarim, pyetja ime e parë është, pse pagesat nuk po i kryeni me kohë dhe në formë të rregullt por po e dëmtoni në këtë formë buxhetin? Kam parë operatorë që janë jashtë kontratës kolektive licencave etj, por ka operatorë që kanë kontratë aktive dhe janë paguar me përmbarim, madje goxha shifra të larta. Dhe pyetja ime e dytë është, që është tema aktuale në Kosovë, a jemi duke i rreziku punëtorët e komunës me i lënë pa paga? Domethënë, me këto me këto përmbarime, me këtë numër kaq të madh, a kemi me u ballafaqua edhe ne si komunë e Mitrovicës me mbet punëtorët e komunës pa paga? Si dhe pyetja e tretë, për fund është që të n’a tregoni me vlerë të saktë, drejtoreshë, sa e keni keq klasifikimin deri në këtë periudhë Janar-Shtator? Këtë pyetje të kam parashtruar edhe në Komitetin për politike dhe financa, po e bëjë përsëri. Si dhe te kodet tjera, pyetja e radhës është pse nuk po e paguani rrugën “Mbretëresha Teutë” ? sepse aty po figuron zero, rruga veç është përfundua dhe vazhdimisht po figuron zero. çka ka ndodhë, a mundeni me japë ndonjë arsyetim, pse nuk po kryhet kjo pagesë? A ka pranim teknik të kësaj rruge? nëse ka pranim teknik, rruga deri më tani është dashtë me u pagua. Njësoj vlen edhe për urën tek liqeni, dhe nëse e keni theksu si ekzekutiv që ajo veç ka përfunduar, në të njëjtën kohë e keni bërë edhe përurimin e rrugës “Mbretëresha Teutë”, atëherë a mund ta dimë arsyen e mos pagesës?

Muhamed Hoti: Në lidhje me raportin financiar të tre mujorit të parë, Janar-Shtator, ç‘është e vërteta dhe po të imponohet pak me qenë edhe analist financiar me këtë raportim. Tek ky raportim, e nderuar drejtoreshë, po të drejtohem direkt ty, unë kam ca kritika, të cilat lutem që të jem gabim, është fjala rreth mallrave dhe shërbimeve, dhe tek investimet kapitale. Fillimisht, po e parashtroj pyetjen, sa janë reale këto që janë paraqitur? Po filloj të citoj kështu. Është dallimi tek mallrat dhe shërbimet, tek shërbimet kontraktuese të tjera me mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe mirëmbajtjen rutinore të rrugëve, ku vlera e cilës është përmbi se 1,300,000.00 €, po këtë po e kufizoj, që mos të marrë kohën që të citoj me vlera të sakta. Shembull, tek shërbimet kontraktuese të tjera është 663,000 €, tek mirëmbajtja e rrugëve lokale është 486,000.00 €, si dhe mirëmbajtja rutinore e kemi vlerën 286,000.00 €. Te investimet kapitale, sa janë reale paraqitja e investimeve

kapitale që i keni paraqitur në këtë raport financiar Janar-Shtator? Jam kureshtar të dijë, fillimisht, keni paraparë që keni bërë blerjen e një ashensori dhe keni kryer një pagesë rreth 40,000 €, për të cilin ashensor të objektit të komunës jemi duke folur? Çfarë është e vërteta unë nuk e di, a është brenda këtij objekti ai ashensor, a është në një objektet tjetër brenda territorit të Mitrovicës. E dyta, pak jam njohës edhe i çështjes kompjuterike, por softuer për menaxhimin e lejeve ndërtimore, a është blerë për herë të parë tash këtë vit? Në qoftë se është blerë për herë të parë këtë vit, vlera e të cilës është dhënë një pagesë shumë e vogël, po si janë lëshuar më herët lejet ndërtimore, pa këtë softuer. Shkolla e muzikës, këtu po figuron që e keni kryer një pagesë 180,000.00 €. Ne jemi të kënaqur me u bë nisja e ndërtimit të shkollës së muzikës, a është një kompani që ju ka obliguar që të paktën ta kryeni parapagesën 180 mijë € që ai të nis procesin e punës, apo është gabim i shtypur teknik kjo vlerë? Si dhe pyetja e katërt, unë te them të drejtën, jam edhe banor i Lagjes të quajtur "Gorimahalla", edhe jam rritur në atë shkollë, e kam përfunduar shkollën fillore në shkollën "Abdullah Shabani", po gëzohem që keni bë një investim në sallën e sporteve, por mos ia keni ndërruar shkollës territorin diku? Nuk është pyetje nënçmuese, është pyetje shumë e sinqertë, unë nuk jam në dijeni se ku është nisë të investohet për sallën e sporteve në shkollën "Abdullah Shabani", vlera e investimit e cila ka arritur në 20,000.00 €, tashmë janë këto pyetje, që është duke n'a interesuar të dimë ky raport të cilin është paraqitur, me këto vlera. Pra, pyetja ekonomike, sa është real që e ke paraqitur, si dhe kush i qëndron mbrapa këtyre numrave të paraqitur në Raportin Janar-Shtator.

Xhyljeta Imeri: Së pari ju falënderoj për përgatitjen e raportit financiar, por fillimisht dua të ndalem tek pagat ku janë shpenzuar 87% e buxhetit për këtë vit, 14% më shumë sesa në vitin e kaluar 2023. Sipas Asociacionit të komunave, komunat e Kosovës nga Kontrata kolektive janë dëmtuar rreth 12,000,000.00 € ku edhe komuna jonë ka pësuar me mbi 2,000,000.00 €. Këtu dua të pyes, edhe për sa muaj do të kemi paga dhe a ka mundësi të na bllokohen llogaritë bankare të komunës sonë nga Qeveria, sikurse ka ndodhur me komunën e Suharekës. Dua të ndalem tek arsimi, sipas tabelës 9, faqe 20, investimet kapitale në arsim janë shqetësuese, duke marrë parasysh që në këtë raport figurojnë objekte si të realizuara e që realisht nuk ekzistojnë, si për shembull, siç edhe e ceku kolegu, Ndërtimi i Shkollës së Muzikës, Shkolla "Harun Beka", Palestra sportive, e tjera, dua një shpjegim se ku kanë shkuar këto mjete. Gjithashtu, kërkoj një shpjegim ku ka shkuar procesi apo pse nuk janë realizuar objektet, si në vijim: ndërtimi i çerdheve, rregullimi i objekteve të shkollave të mesme të larta "Frang Bardhi" dhe "Arkitekt Sinani", Shkollat Fillore "Migjeni", "Shaban Idrizi", pajisje për kabinetet shkollore, tabela digjitale, aneksi në shkollën "Azis Sylejmani" në Suhodoll e veçanërisht për çerdhen në Shipol, është për të ardhur keq se si nuk po arrinë të funksionalizohet një çerdhe që nga viti 2020, gjithashtu na tregoni se kur do të fillojë rregullimi i oborrit të shkollës "Abdullah Shabani"? E si përfundim, dua të kthehem tek tabela 7, faqe 9, tek investimet kapitale. Në ndërtesa arsimore janë shpenzuar vetëm 218.230 €, që realisht po vërtetohet atë që e theksova më lart, që 49% e investimeve kapitale nuk është real.

Faruk Mujka: Është përshkrim i atyre që kanë ndodhë gjatë këtyre 9 muajve dhe kjo tregon thjesht se kemi ngecje në performancën financiare të komunës, duke filluar nga të hyrat të cilat nuk është që preken nga kontratat kolektive e nga investimet kapitale, të cilat edhe mund të preken nga kjo kontratë dhe unë plotësisht pajtohem me diskutimet e paraardhësve, por me z. Veseli vetëm për një gjë nuk mundem të pajtohem, këtë diskutimin që e ka pasur sot, është dashur të ketë edhe para 4-5 viteve, pra, këtë diskutim ka mundur t'a ketë edhe më herët, edhe kontrata kolektive, se më pak ka raste prej kontratës kolektive edhe kontrata mbi licenca, të dyja këto kontrata janë sjellë në kohën e qeverisjes së PDK-së. Ku janë, nga ku komunat me bë pagesat edhe as PDK-ja e as ky Asociacioni i komunave, asnjëherë nuk ka reagua atëherë, pse padrejtësisht po ngarkohen komunat. Më tepër, kur ka qenë z.Veseli opozitë, edhe ti kryesuese, kur jemi munduar të shpjegojmë këtë çështje, e keni synuar për keq menaxhim të financave, dhe për keq klasifikim të financave komunën. E tani po ju vjen me kamatë kjo punë, duhet duruar edhe me mbajt edhe duhet me vazhdua tutje se nuk keni dashur të ndihmoni atëherë kur keni pasur mundësi, e tash kot e sulmoni Qeverinë, sepse edhe fillimisht, i është dërguar një shkresë të gjitha komunave, për të ndarë një fond posaçëm, prej ku pastaj edhe do mundet me marrë mjetet për këto pagesa, po rrallë ndonjë komunë e kanë marrë parasysh, po nuk ka dëgjua askush, tash ju marrin normal. Nuk është mirë, padrejtësisht ngarkohen komunat si çdo herë, mirëpo duke shikuar të bëjnë politika të vogla lokale, kundër njëri tjetrit, kemi mbërri tash ku jena, tash madje edhe këta kolegët tanë që kemi pasur ne, se edhe ne kemi qenë këtu para 3 viteve, kolegët tonë kanë me e vuajte këtë gabimin tonë, të përbashkët që e kemi bërë më përpara.

Vesel Neziri: Kur Fadili e kritikonte VV-në, VV-ja është mbrojtur me mjetet e veta, e tash e njëjta gjë kur PDK-ja ngriste rrogat në kohë të fushatës, VV-ja, i thoshte PDK-së. kjo tani, është blerje votash. Domethënë,

vetëm po sillen rreth një cikli. Me i rritë pagat, mirë, por të rriten ashtu si duhen jo vetëm në prag të fushatave. Prandaj është mirë me u rritë pagat edhe mu pagu borxhet që i kanë mbet edhe mësimdhënësve e të tjerëve. Unë po besoj që ky cikël për mësimdhënës, do të mbyllet ne Janar me gjasë, dhe përfundon kjo punë, fillojnë borxhet tjera që i lënë të tjerët, po megjithatë po bëhet mirë që po e shohim të gjithë se si blihen votat.

Erseka Barani: desha të shprehë shqetësimin tim sa i përket përqindjes jo reale tek investimet kapitale, ku disa prej projekteve kolegët veçse i cekën që nuk ekzistojnë fare. Ne e dimë shumë mirë edhe nga tabelat që na janë bashkëngjitur në raport, që prej atyre 3,706 000.00€, të shpenzuara tek investimet kapitale 1,381,386.00 €, janë shpenzuar vetëm nga përmbaruesit, kështu që, kjo ka ndikuar tek rritja e përqindjes së shpenzimit të investimeve kapitale. Tek mbledhja e KPF-së kemi pasur një sugjerim nga kolegu Fadil, ku ka kërkuar që të jetë një listë që i tregon këto projekte që nuk janë realizuar fare ose që figurojnë gjysmë të realizuara, kështu që kërkoj që në raportet e ardhshme të shpenzimeve të jetë një listë e veçantë, ku specifikon që secili projekt që nuk është realizuar apo figuron si i realizuar të jetë i bashkëngjitur në atë raport, sepse ato mjete realisht kanë shkuar tek përmbaruesit dhe projektet nuk janë realizuar fare.

Igballe Islami: Sa i përket diskutimit të z. Veseli dhe bartjes së të hyrave, komuna e Mitrovicës veçse e ka aprovua buxheti komunal dhe jemi në pritje që ky buxheti komunal të aprovohet edhe në kuvendin e republikës së Kosovës. Kurse nisma e Asociacionin e komunave domethënë drejtorët e buxhetit dhe financave kemi kërkua që bartja e të hyrave, pra neni 9, të pësojë ndryshim edhe t'ju lejohet komunave që bartjen e të hyrave të kryejnë përmes vendimit të asamblesë komunale, sikurse ka qenë në të kaluarën duke ruajtur strukturën e shpenzimeve. Meqenëse jeni dëshmitarë që këtë vit bartja e të hyrave është kryer nga departamenti i buxhetit dhe komunat e kanë pasur të pamundur që të dedikojnë mjetet për mbulimin e obligimeve qoftë financiare, qoftë aktuale për vitin e ardhshëm fiskal. Z. Muzliukaj, tek kryerja e obligimeve financiare, ku drejtoria për buxhet dhe financa, për aq kohë sa kemi të bëjmë me respektimin e Ligjit vjetor të buxhetit, në ndarjet buxhetore janë kryer të gjitha pagesat në përputhje me Ligjin dhe ndarjet buxhetore të atij programi. Kështu që të gjitha pagesat e rregullta, të cilat kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me ndarjet buxhetore të programeve të faktuara janë kryer në procedurë të rregullt nga drejtoria për buxhet dhe financa, pjesa tjetër, te ekzekutimi i vendimeve gjyqësore kemi të bëjmë me vendime gjyqësore të formës prerë, urdhëra përmbarimor si pasojë e Kontratës kolektive, se a i rrezikohen pagat e rregullta të komunës së Mitrovicës nga ky ekzekutim nga ministria e financave, punës dhe transfereve, ne jemi në koordinim të vazhdueshëm me ministrinë e financave, departamentin e divizionit të pagave dhe për muajin Tetor veçse është ekzekutua çeku i pagave, domethënë kemi qenë njëra ndër komunat që nuk kemi vështirësi për momentin dhe për hapa tutje do të jemi prapë në koordinim të vazhdueshëm me divizionin e pagesave në kuadër të Ministrisë së financave dhe do të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme dhe të gjitha hapat ligjorë që kemi të drejtë në mënyrë që nëpunësit e administratës së komunës së Mitrovicës të mos mbeten pa paga të rregullta. Janë disa, udhëzime administrative, të cilat ne na lejojnë si drejtori edhe me kryetarin e komunës t'i bëjmë harmonizimet e nevojshme edhe në mënyrë që të realizohen pagat e rregullta për nëpunësit e komunës. Sa i përket keq klasifikimit të shpenzimeve, këtë çështje e kemi diskutuar në Komitetin për politikë dhe financa, unë e marr përgjegjësinë e plotë sa i përket pagesave të rregullta të cilat janë kryer nga Drejtoria për buxhet dhe financa, nuk ka as keq planifikim, nuk ka as keq klasifikim të shpenzimeve, meqenëse të gjitha obligimet financiare janë kryer me kodet adekuate, në kategoritë adekuate. Tek pagesa e investimeve kapitale, është potencua rruga "Mbretëresha Teutë" dhe ura tek liqeni. Drejtoria për buxhet dhe financa gjatë kësaj periudhe, ka raportua se të gjitha obligimet financiare, të cilat u dorëzuan në drejtorinë për buxhet dhe financa, të gjitha atje janë ekzekutua. aty ku nuk ka pas faturë, normalisht nuk ka pas as shpenzim. Si dhe përgjigje për z. Hoti, unë nuk e mora pyetjen tënde aspak nënçmuese, madje shumë pyetje profesionale, e sa i përket pjesës qe the se a janë reale, unë po të them që janë shumë reale të dhënat të cilat janë paraqit në këtë raport financiar. Edhe u qëndroj shumë mbrapa secilës shkronjë edhe secilit numër që është paraqitë këtu, sepse janë të dhëna të sistemit. Është e pamundur që ne me ndërhy në sistem, edhe nëse kish me qenë kështu me pas mundësi ne me ndërhy, as unë nuk kisha thënë. Kështu që unë i qëndroj mbrapa raportit financiar, të cilin sot e kam paraqitë para juve. Edhe tani të ndalem tek kodet ekonomike. Ju i jeni referuar tabelës 2.4 mallra dhe shërbime, këto kode të cilat janë të pozicionuara këtu si shërbime kontraktuese e tjera, mirëmbajtje rutinore, larje e fshirje e rrugëve, pastaj shërbimet e arsimit, trajnimit janë kode ekonomike, të cilat neve na vijnë nga ministria e financave çdo fund vit, domethënë është manual edhe është plani kontabël, domethënë zyrtarët për buxhet dhe financa, varësisht natyrës së krijimit të obligimit financiar atje, e akomodojnë brenda kodit ekonomik. Kode ekonomike ka të shumta mirëpo është e vështirë me gjetë kodin adekuat dhe shërbime kontraktues e tjera ka të bëjë me të gjitha

shërbimet për të cilat ka kontratë, domethënë kemi obligime kontraktuale ndaj tyre. përndryshe e ke të specifikuar, e ke internetin me kod ekonomik, edhe ke krejt kode tjera ekonomike. Është diçka që as përshkrimin nuk mundemi me ndërrua si të tillë, mirëpo as kodin ekonomik nuk mundemi me ndërrua si të tillë, sepse varësisht kur është krijua obligimi financiar aty edhe kodohet edhe kryhet ekzekutimi deri në certifikim, e kjo ka të bëjë pastaj me keq klasifikimin e shpenzimeve kohore. Jam shumë e lumtur që përbrenda këtyre tri viteve asnjë pagesë nuk është e keq klasifikuar sa i përket pagesave të rregullta të kryer nga zyrtarët e drejtorisë për buxhet dhe financa.

Te investimet kapitale, jo Fadili mirëpo unë atë vetë atë ditë kam kërkuar dhe nuk kam gjetë miratim tuaj, përndryshe edhe në komitetin për politikë dhe financa ju kam thënë nëse ka disponim tuaj që me plotësua tabelën e investimeve kapitale edhe me shtu një rubrikë me ja u specifiku cilat investime kapitale janë kryer me përmbarim? Nuk është që dikush ka thënë që mundem, e si përndryshe është shumë teknike edhe mundem nesër me jua sjellë edhe me ju tregu specifikisht cili projekt kapital është ekzekutua në formë përmbarimore. Ka qenë diskutim, nëse është transkripta lirshëm mundeni edhe është jam shumë e sigurt në këtë që e them pa problem e nxjerrim procesverbalin. Në fund kam thënë nëse ka konkluzione, nëse ka disponim, mundem me e sjellë. Mirëpo në të kundërtën edhe sot prapë ne mundemi me plotësua, është shumë teknike kjo punë për me u bë edhe e specifikojmë edhe një kolonë tjetër, larg kësaj, shpenzimi të investimit kapitale edhe të tregojmë saktësisht se cilat projekte kapitale janë realizuar në formë përmbarimore, krejt kjo për transparencë e për ndryshe, këto veç janë të paraqitura edhe tek softuer për leje ndërtimore është një projekt, i cili ka që në buxhetin e vitit 2023, mirëpo qysh e thashë është bartur në vitin 2024 nga departamenti i buxhetit. Pra, është në buxhetin e vitit 2023 si projekt kapital, i cili nuk ka arritur të realizohet, të shfrytëzohet dhe si i tillë është transferuar me vendim të departamentit të buxhetit, në këtë rast në sistemin e vitit 2024. Ju e keni pranua edhe në raportin 3 mujor edhe 6 mujor pa këtë projekt, kështu që nuk e di ndoshta sot veç keni dashur të diskutoni më mirë. Edhe sa i përket shpenzimit të tij, nuk është shpenzua, është fundi i njëzet e dy, nuk ka as procedurë të nisur për të, realisht këto mjete sot veçse janë ekzekutua nga departamenti i buxhetit prapë për kontratë kolektive. Sa i përket duke thënë prapë këto projekte lidhen krejt me ekzekutimin e tyre, të cilat janë bërë në formë përmbarimore edhe nëse ka disponim në fund unë mundem nesër në fund të orarit me u sjellë tabelën e investimeve kapitale edhe me specifiku saktësisht cilat projekte janë kryer me përmbarim dhe largohen këto dilema, atë sa i përket "Abdullah Shabani" palestrës edhe projektet tjera që ishin. Znj. Imeri e përmendi që Asociacioni veçse ka dalë me një deklaratë dhe thotë që të gjitha komunat janë rreziku edhe pagat e rregullta edhe keq-klasifikimi që ka ndodhë nga ministria e financave, punës dhe transfereve kështu që edhe komuna e Mitrovicës është njëjtë si komunat tjera, sepse edhe ne i kemi bartë obligimet e kontratës kolektive. Çerdhja në Shipol ka kontratë, janë punime duke u kryer për aq sa unë jam në njohuri. Oborret në Shkollën "Abdullah Shabani" dhe "Skënderbeu", është një kontratë, e cila, sa kam informata, veçse ka arrit me u nënshkrua, ndërsa për projektet tjera si shkolla "Aziz Sylejmani" dhe projekte tjera të cilat janë të Drejtorisë komunale të arsimit unë mundem me tregu vetëm projektet për të cilat janë marrë zotimet, projektet të cilat janë shpenzua, ndërsa për faza se ku gjenden projektet, qoftë fazën e prokurimit, qoftë fazën e vlerësimit, janë drejtorë të drejtorive ata që i kanë informata specifike dhe munden saktësisht me ju dhënë informata, sepse ne si drejtori e shohim fazën e planifikimit, fazën e zotimit të mjeteve dhe fazën e shpenzimit, ndërsa procedurat e prokurimit dhe vlerësimit të procedurave atje janë drejtorët e drejtorive bashkë me stafin e tyre që i përcjellin këto.

Znj. Barani bëri pyetjen e njëjtë sa i përket shpenzimeve kapitale, të cilat domethënë janë ekzekutuar për mbulimin e obligimeve nga kontrata kolektive. Unë po e konkludoj që ne jemi të gatshëm me sjellë listën e investimeve kapitale, shtohet një kolonë edhe tregues saktësisht se cila është kryer. Kjo praktikë e raportimit është nga raportet financiare të kaluara, i kemi pas pak diskutim si në KPF me siguri nuk jemi kuptua aty saktë, se përndryshe kemi mundur me sjellë edhe në këtë seancë. Po ashtu edhe ashensori është përmes procedurës përmbarimore.

Kryesuesja e Kuvendit znj.Vesa Broja: Unë po kërkoj që raporti financiar vjetor kur të na vjen pas këtij, me pasë të specifikuar edhe tabelën se cilat mjete janë marrë me përmbarim, sepse është në interesin e të gjithë neve me ditë këtë informatë, shumica e pyetjeve i kem për projekte të cilat veç janë shkua me përmbarim edhe nuk kemi pa asgjë në terren.

Fadil Veseli: Kjo çështje është duke u përsërit me vite, pra nuk është vetëm e këtij mandati, e kësaj qeverie, por edhe e mandateve tjera. Bile, e kam cek këtu se nëse këto raporte mbesin zyrtare edhe dorëzohen çdo vit, në arkivë dhe tash, nëse shikojmë ne për shembull, çerdhen e fëmijëve në vitin 2019 ose 2018, janë ndarë 100.000 € dhe është mbyllë raporti që janë ekzekutua, janë realizua për çerdhen e fëmijëve 100.000 €, realisht

ato nuk janë ekzekutua, për shkak se i ka marrë përmbaruesi. Krejt çka kam kërkua unë, që kjo shtesa që e tha edhe drejtoresha, kjo ekziston dhe nuk ka mundësi pa u mbulua këto mjete. Mirëpo krejt çfarë po kërkohet është me u thjeshtësua raporti aty për aty.

Hysen Muzliukaj: Për me qenë ma korrekt, Ministria e financave as nuk t'i merr mjetet as nuk t'i qet, veç sa të takojnë do t'i jap dhe do ti marr, Ministria e financave para se me u përmbyll buxheti, ju ka thënë të gjitha komunave, këtë e kam të saktë, lëreni një nënkod ku keni të drejtën e krijimit të nën kodit ku i parashihni këto obligime pra borxhet perfshi kontratën kolektive dhe licencat, mirëpo çfarë ka ndodhur është, ne këtë buxhet e kemi votuar këtu dhe nuk e kemi planifikuar, e në të njëjtën kohë ne e kemi prej komunës një marrëveshje me avokatë, për dy herë me i marrë paratë. Mirëpo kjo dy herë nuk u specifikua në atë marrëveshje se a bëhet fjalë për 2024 apo për 2025. Faturën që nuk e paguan komuna mos t'ia lëmë fajin Ministrisë të financave, sepse ajo e bënë ekzekutimin edhe të pyet ju lutem, prej cilit kod dëshironi ta bëni pagesën. Tjetra, drejtoreshë pse të pyeta për rrugën Mbretëresha Teutë, është sepse këtu ka pas një kërkesë për transfer të mjeteve për pagesën e rrugës Mbretëresha Teutë dhe është votuar në këtë kuvend ndërsa këtu tash po ma qet zero, pse?

Xhyljeta Imeri: Po ashtu edhe unë dua vetëm ta ri-konfirmoj që tabela nuk është reale, investimi. Na vetëm atë po e themi, sepse figuron që është realizuar, por realisht nuk është realizuar. Shkolla e muzikës nuk ekziston, na vetëm kërkuam se ku kanë shkuar ato mjete, na po e dimë që përmbaruesi, por na u desht përgjigjja juaj.

Muhamed Hoti: Pa dashur që të keqkuptohemi, neve këtu si pjesëtarë të këtij kuvendi epitetin apo titullin e secilit prej neve e kemi këshilltarë të kuvendit. Në momentin që ne etiketohemi asisoji, na po të japim këshillë. Një raport i paraqitur këtu para neve si material janar-shtator unë i qëndroj mbrapa citimit tim të mëparshëm, se nuk është raport real. Në çdo moment, në çdo kohë, ku juve si drejtoreshë e financave, për të mirën e qytetit, unë jam i gatshëm të ballafaqohem me juve vetëm në aspektin ekonomik edhe raportin numerik që ju e keni paraqitë para neve.

Kryesuesja e Kuvendit Vesa Broja: Jena dëshmitarë edhe raportet e kaluara, edhe raportet para katër-pesë vitesh, që i përmendi z. Mujka, shpenzimi kur ndodh, duhet me ndodhë dhe duhet me u raportua, se paret janë shkua. Nuk munden drejtoria me qit zero, ato pare nuk janë, se i kam marrë përmbaruesit për një çështje tjetër. Krejt kësaj i jep fund ajo kolona në fund që nëse janë shkua me përmbarim ose nëse janë shkua në formë të rregullt.

Erseka Barani: Ne vetëm kërkuam që me qenë më transparent edhe ndaj nesh edhe ndaj qytetarëve, duke e bashkëngjitë në raportin e fund vitit një kolonë ku specifikon saktë cilat projekte figurojnë si të realizuara, po në realitet janë kryer obligimet e komunës.

Igballe Islami: Në pyetjen e asamblistit se pse nuk janë planifikuar në nën kod, nuk ka këtu nën kod, është kategori ekonomike e veçantë që është rezerva edhe realisht edhe me qarkoret buxhetore komunave kur ju shpërndahet qarkore buxhetore, është një kategori e veçantë, janë rezervat. Mirëpo ne i kemi marrë për bazë që nuk kemi mjete financiare të mjaftueshme për të planifikuar rezerva, për arsye që kemi pas obligime kontraktuale, obligime financiare, ndaj operatorëve ekonomikë. Është fat që komuna e Mitrovicës ka arrit me u konsolidua deri në këtë pikë financiare, meqenëse e dimë që keni pasur obligime shumë të pa paguara dhe çdo vit na kanë përcjellë këto obligime si pasojë e atyre obligimeve që kanë qenë me marrjen tonë të mandatit. Sa i përket asaj se unë e kam sjellë një vendim për transfer për Rrugën Mbretëresha Teutë, po e kam sjellë, vendimi ka kalua edhe në asamble komunale, ka kalua edhe në departamentin e buxhetit, ka qenë kërkesë e drejtorit për shërbime publike dhe infrastrukturë që të ketë transfer ose ri-alokim në këtë kod ekonomik meqenëse kemi kontratë dhe kemi obligime kontraktuale. Kur flas kemi obligime kontraktuale, në këtë moment kemi obligime kontraktuale mirëpo nuk ka obligime financiare ndaj operatorit ekonomik. Në momentin që kemi obligime financiare ndaj operatorit ekonomik, drejtoria për buxhet dhe financa ka me procedua pagesën. Sa i përket asaj sepse pagesat edhe tona të rregullta kanë shkua në ministrinë e financave, unë besoj që isha e kjartë dhe qëndroj mbrapa saj që drejtoria për buxhet dhe financa ka kryer pagesa, të cilat kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ligjin për menaxhimin e financave publike, përgjegjësitë ligjin e buxhetit, si dhe në përputhje me ndarjet buxhetore të nën programeve. Me qëllim që kur është votua një buxhet në asamble komunale, secila drejtori ka ndarjen buxhetore në kategori ekonomike. Kështu që ne kemi shkua duke respektuar përputhshmërinë dhe ndarjet buxhetore të secilit program. Edhe sa i përket marrëveshjes të avokatit të komunës, unë nuk kam njohuri dhe nuk e di se me çfarë afatesh është lidh ajo. Krejt çka mundem me e ditë është që ne vazhdimisht pranojmë numra përmbarimore si pasojë e kontratës kolektive, ku edhe sot para se me fillu kjo seance janë në pritje 300.000 € që kanë me ekzekutua prapë si pasojë e kontratës kolektive. Kështu që

kjo nuk e di edhe deri kur ka me përfundua sepse janë obligimet kontingjente, të cilat nuk dihet deri kur e kanë fundin. Dua të ju tregoj që edhe unë qëndroj prapa diskutimit tim, sepse tabela e investimeve kapitale thotë shpenzimi as nuk thotë në mënyrë të rregullt as në mënyrë përmbarimore. Përderisa ka ndodhë shpenzime në sistemin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, pa dyshim që unë e kam publiku këtë sepse është shpenzim. Herën tjetër, kemi me specifiku, pagesa të rregullta dhe përmbarimore pa problem.

Kryesuesja e Kuvendit Vesa Broja: Meqenëse nuk ka atë lajmëruar të tjerë për diskutim pra është raport dhe nuk ka nevojë për miratim, kalojmë në pikën e radhës.

Pika e 7

Kryesuesja para se të hap diskutimin lidhur me Propozim vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani" ky propozim-vendim ka ardhur nga DKRS-ja, e cila i ka propozuar shtatë anëtarë të komisionit, pra katër anëtarë nga kuvendi dhe tre nga ekzekutivi, andaj po vazhdojmë me propozime për komision, por ju lutem te keni parasysh kuotën gjinore.

Gjergj Beka: Unë e propozoj z. Vesel Neziri.

Fadil Veseli; Unë e propozoj znj. Florina Çitaku

Faruk Mujka: Unë e propozoj z. Erseka Barani.

Xhyljeta Imeri: Unë e propozoj z. Gazmend Asllani.

Fahri Jashari: nga DKRS i kemi tri propozime: z. Taip Kabashi, z. Veton Çitaku dhe Kaltrina Feka

Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani" me këtë përbërje: Vesel Neziri, Florina Çitaku, Erseka Barani, Gazmend Asllani, Kaltrina Feka, Veton Çitaku dhe Taip Kabashi.

Rezultati i votimit: 22 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani".

Pika 8

Armend Begu: Që tri vite asnjëherë nuk kemi marr përgjigje nga ekzekutivi, gjithmonë përgjigjet ose nuk i kanë jap fare ose i kanë jap në mënyrë asnjanëse. Kur e keni përpilua programin që keni pas kërkesat pikat e programit, nuk i keni qitë pikat që janë për qytetarët po i keni qitë pikat sa ma popullsitë që me marrë vota. P.sh këtu, asnjë fushatë, asnjë strategji nuk është për të heqjen e mbeturinave për një ambient të pastër. Pastaj problem tjetër është në fshatin frashër kanalizimi, trotuaret nuk kanë se ku të ecin këmbësorët pra janë të rrezikuar se nuk ka trotuare. Pra ky problem nuk është vetëm në frashër mirëpo është në shumicën e fshatrave të Mitrovicës. Po ashtu edhe fëmijët janë të rrezikuar për shkak se nuk ka trotuare, rruga nuk ka shenja është pa sinjalistikë, qentë endacakë po ashtu janë rrezik për qytetarët, pastaj u cek që transporti për nxënësit u rregullua po ne nuk e dimë ende se a është bërë zgjidhja apo jo, atëherë unë po përfundoj me kaq, a keni përgjigje për këto që i ceka.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:50 min.

Mitrovicë	**Procesmbajtës:**	**Kryesuesja e Kuvendit**
	_____	_____
	Afërdita MAXHUNI	**Vesa BROJA**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	14.11.2024
REFERENC-Ë:	02-110/25-0074202
PËR/ZA/TO:	**znj. Vesa BROJA, Kryesuese e Kuvendit të Komunës**
CC:	**Anëtarët e Kuvendit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa,**
PËRMES/PREKO/THROUGH	**z. Bedri HAMZA, Kryetar i Komunës** 18.03.24
NGA/OD/FROM:	**Komisioni për Hartimin e Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, znj. Teuta SELMANI PLLANA – Kryetare e Komisionit** Selmani
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Propozim për Miratim të Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale**

Bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenin 77, paragrafi 1.10, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020), nenet 26 dhe 27 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kryetari i Komunës i propozon, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës këtë:

PROPOZIM
(Për Miratimin e Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale)

1. I propozohet Kuvendit të Komunës përmes Komitetit për Politik dhe Financa që të miratojë **Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale**.

ARSYETIM

Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0064559/24, dt. 27.09.2024, ka formurar Komisionin për Hartimin e Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, ku ky Komision ka përfunduar Draftin Final të Rregullores së

lartcekur, konform Vendimit për Emërimin të tij, dhe dispozitave ligjore në fuqi për hartim të tij.

Pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara ligjore për hartimin e këtij Drafti, dhe duke u bazuar në të thënat e lartcekura, i propozojmë Kuvendit të Komunës përmes Komitetit për Politik dhe Financa që të miratoj këtë Draft - Rregullore.

Shtojcë:
1x1 Draft – Rregullorja për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	12.11.2024
REFERENCË:	02-110/05-0073744/24
PËR/ZA/TO:	**znj. Vesa BROJA - Kryesuese e Kuvendit të Komunës** **z. Bedri HAMZA – Kryetar i Komunës**
CC:	**Anëtarët e Kuvendit të Komunës**
PËRMES/PREKO/THROUGH:	**z. Nazmi JASHARI – Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit**
NGA/OD/FROM:	**znj. Teuta SELMANI PLLANA – Kryetare e Komisionit për Hartimin e Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Raport nga Konsultimi Publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale**

Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenin 32, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, Komisioni ka shpall Diskutimin Publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, për datën 11.11.2024, në Sallën e Mediave të Komunës, duke filluar nga ora 10:00 h.

Ecuria e procesit

Komisioni në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, ka publikuar Njoftimin për Konsultim Publik të Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale në ueb faqen e Komunës 8 (tetë) ditë para mbajtjes së takimit në linkun:

https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2024/11/Diskutim-Publik-Draft-Rregullorja-per-Ndryshim-Plotesim-te-Rregullores-01-2022-per-

Organizimin-Kompetencat-dhe-Pergjegjesite-e-Administrates-Komunale.pdf, në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës (https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42666), dhe në rrjetet sociale të Komunës.

Njoftimi për Konsultim Publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, respektivisht, nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, duke u interesuar që të sigurohet Njoftim i Plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me Njoftimin për Konsultim Publik palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur Draft – Rregullorja për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, që ka qenë objekt i konsultimit publik, shpjegime shtesë, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Metodat e Konsultimit	Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Publikimi në ueb faqe	8 ditë para mbajtjes së takimit kryesor	10

Në konsultim publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale kanë marrë pjesë: Komisioni Punues i Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, Njësia për Komunikim me Publikun, Pjesëmarrës nga Shoqëria Civile, dhe disa nga zyrtarët e drejtorive.

Në këtë Diskutim Publik nuk ka pasur kërkesa për ndryshime shtesë jashtë Draftit të punuar nga Komisioni, përveç që kërkonin sqarime shtesë lidhur me ndryshimet e propozuara në këtë Draft.

Nuk ka pasur pjesëmarrës tjerë.

SHTOJCË:

Lista e pjesëmarrësve në Diskutim Publik.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Komuna e Mitrovicës
Nr. 01-060/04-0073590/24 dt. 11-11-2024
Mitrovicë

PROCESVERBAL

(I Diskutimit Publik, të mbajtur më datë 11.11.2024 nga Komisioni për hartimin e Draft – Rregullores për Ndryshim-Plotësimin e Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale)

Në Diskutim Publik morën pjesë: Kryetarja e Komisionit, dhe Anëtarët e Komisionit, Zyra për Informim e Komunës, përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, dhe disa nga Zyrtarët e Komunës.

Diskutimi Publik filloi në ora: 10:00 h
Përfundoi në ora: 11:00 h.

Në diskutim publik Kryetari i Komisionit së bashku me Anëtarët u dakorduan që të mbahet dhe një takim që të analizohen disa ndryshime që i kanë dërguar përmes e-mailit pas publikimit të Draftit Final në Ueb faqen e Komunës. Pasi që nuk pati pjesëmarrës të tjerë në takim dhe Komisioni e ka përfunduar obligimin ligjor për mbajtjen e këtij diskutimi, i njëjti vendosi që të mbahet dhe një takim punues i Komisionit për të përfunduar Draftin Final të Ndryshi,-Plotësimit të Rregullores, dhe përfshirjes së ndryshimeve të dërguara nga Drejtoritë Komunale dhe Zyrat në Komunë.

Ky takim u vendos që të mbahet më datë 11.11.2024, në orën 14:00 h, me ç'rast dhe do të finalizohet ky Draft.

Takimi përfundoi në ora 11:00 h.

Pjesëmarrësit e takimit:

Teuta Selmani Pllana

Gëzim Stavileci

Lavdim Musa

T'i dërgohet:
1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Anëtarëve të Komisionit

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Lista e pjesëmarrësve në Diskutim Publik për Hartimin e Ndryshim – Plotësimin e Draft - Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, i mbajtur më datë 11.11.2024, në ora 10:00 h

Nr.	Emri/Mbiemri	Pozita /Org.	Tel	Email	Signature
1.	LAUDIM MUSA	U.D. MENAXHER I BURIMEVE NJ	049-566 019	laudim.musa@rks-gov.net	
2.	Sofije Rustiti-Peci	Zyrtare per Informim	044227880	sofije.rustiti@rks-gov.net	
3.	Fahrije Kabashi	Koordinatore Gjeo/SCIK	044118517	fahrije.kabashi@rks	
4.	MIRANDA VORFAJ	ZYRTARE OPERACION-EVE TË REAGIMIT	045/480-888	MIRANDA.V.GASHI@rks-gov.NET	MVorfaj
5.	Teuta Selmani Pllana	Zyrtare Ligjore	049-802-920	teuta.selmani@rks-gov.net	
6.	Bukurije Ujkani Kuka	Zyrtare Ligjore	044540835	bukurij.ujkani@rks.gov.net	
7.	Albana Tejza	Zyrtare ligjore	049/242-771	albana.tejza@rks-gov.net	Tejza
8.	Valbona Peci	Zyrtare	049-384-118	valbone.peci@rks-gov.net	
9.	Shëndriza Kllokoqi	OSCE	049 958 900	—	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Nr.	Emri/Mbiemri	Pozita /Org.	Tel	Email	Signature
10	Gëzim Stavileci	Mefoci	044/225 970	Gezim.stavileci@[illegible]	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	01.11.2024
REFERENCË:	01-030/03-0071769/24
PËR/ZA/TO:	**znj. Blerina Kastrati Idrizi - Udhëheqëse e Njësisë së Komunikimit me Publikun / Zyra e Informimit**
Cc:	**z. Bedri HAMZA, Kryetar i Komunës**
NGA/OD/FROM:	**znj. Teuta Selmani Pllana – Kryetare e Komisionit për Hartim e Ndryshim – Plotësim të Draft - Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Shpallje e Diskutimit Publik**

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe Vendimarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020; Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, Komuna shpall:

DISKUTIM PUBLIK

(Për Hartim të Draft – Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale)

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultim Publik, i cili do të mbahet ditën e **hënë**, me datë **11.11.2024**, në Sallën e Mediave të Komunës, duke filluar nga ora **10:00 h**.

Duke pasur parasysh rëndësinë e Hartimit të Draft – Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, pjesëmarrja në këtë fazë të procesit është e nevojshme, prandaj të gjithë të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij Njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet dhe sugjerimet mund t'i japin përmes e-Mail adresave elektronike tek Kryetarja e Komisionit për Hartimin e Draftit të Rregullores: teuta.selmani@rks-gov.net.

Bashkangjitur gjeni Draft-Rregulloren për Ndryshim – Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

RREGULLORE NR. _____/_____,
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 01/2022
PËR
ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATËS KOMUNALE

Nëntor, 2024

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. _____ dt. _____
Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Rregullorës (MAPL) Nr. 02-2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin të Akteve të Komunës, nenin 13, paragrafi 1.3 Nr 02-060/01-0056607/20-4 dt.24.09.2020 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë _____, miraton këtë:

RREGULLORE NR. ____/_____,
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORËS NR. 01/2022
PËR
ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATËS KOMUNALE

Nëntor, 2024

Neni 1

Kjo Rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Neni 2

Neni 2, paragrafi 2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

2. Komuna kryen punë dhe detyra përmes drejtorive të administratës komunale, zyrave, njësive, sektorëve dhe institucioneve vartëse të saj, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe dispozitave pozitive.

Neni 3

Nenit 4, të Rregullores bazë i shtohet një paragrafi i ri, dhe atë paragrafi 6, si në vijim:

6. Me punën e Institucioneve vartëse udhëheq Drejtori i Institucionit, dhe puna e tij është e rregulluar me ligjet dhe aktet nënligjore dhe me Statutin e Institucionit.

Neni 4

Neni 8, paragrafi 1.10 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

Neni 5

Neni 18 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

Neni 6

Neni 19, tek paragrafi 1.12 i Rregullores bazë fshihet emërtimi "Pyjeve".

Neni 7

Neni 28, tek paragrafi 1.2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1.2 Sektori për Administratë në Shëndetësi.

Neni 8

Neni 30, i Rregullores bazë emërtimi "Sektori për Administratë dhe Financa në Shëndetësi" zëvendësohet me fjalinë "Sektori për Administratë në Shëndetësi".

Neni 9

Neni 32, tek paragrafi 1.2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1.2 Sektori për Administratë në Arsim.

Neni 10

Nenit 33 i shtohet një paragraf i ri, paragrafi 1.18:
1.18 Në bashkëpunim me drejtorin e DKA-së dhe Sektorin për Administratë përpunon kërkesat dhe nevojat e shkollave për stafin edukativo arsimor dhe mbështetës dhe në bashkëpunim me sektorin e administratës planifikojnë konkurset e rregullta dhe plotësuese në fillim të vitit shkollor, për vitin vijues shkollor.

Neni 11

Neni 34, i Rregullores bazë emërtimi "Sektori për Administratë dhe Financa në Arsim" zëvendësohet me fjalinë "Sektori për Administratë në Arsim", dhe këtij neni i shtohet paragrafi 1.10:

1.10 Në bashkëpunim me drejtorin e DKA-së dhe Sektorin për Zhvillimin e Arsimit përpunon kërkesat dhe nevojat e shkollave për stafin edukativo arsimor dhe mbështetës dhe në bashkëpunim me sektorin e administratës planifikojnë konkurset e rregullta dhe plotësuese në fillim të vitit shkollor, për vitin vijues shkollor.

Neni 12

Neni 75 i Rregullores bazë, fshihet emërimi "Pyjeve".

Neni 13

Neni 78 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

Neni 14

Pas nenit 89 shtohen 2 nene të reja dhe atë:

Neni 89A
Sektori i Shërbimeve Sociale

1. Sektori i Shërbimeve Sociale kryen këto detyra dhe përgjegjësi:
   - **1.1** Mbështet dhe ofron këshilla për drejtorin e Qendrës për Punë Sociale dhe sipas kërkesës për Udhëheqësin më të Lartë Administrativ të Institucionit;
   - **1.2** Kontribon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësive, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes;
   - **1.3** Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
   - **1.4** Trajton rastet dhe përgatit raport për gjykatën, për heqjen e zotësisë se veprimit të personave të paaftë për të vepruar;
   - **1.5** Trajton mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, birësimin, kujdestarinë dhe strehimin e përkohshëm familjar;
   - **1.6** Trajton rastet e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikuente, rastet e angazhimit të fëmijëve në punët e rënda dhe të lënies pa kujdes;
   - **1.7** Monitoron rastet e dhunës në familje dhe angazhohet në përmirësimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe bënë propozimin për besimin e fëmijëve në raste të shkurorëzimit të prindërve dhe përcjell realizimin e kontaktimeve;

1.8 Përkujdeset edhe për kategoritë tjera të personave me nevojë, të moshuarit, fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme, personave që konsumojnë substanca narkotike, alkoolike etj;

1.9 Vlerëson statusin zhvillimor, psikologjik, emocional dhe të sjelljes së fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve bazuar në matjet psikologjike të standardizuara, teknikat projektuese dhe vendimet tjera profesionale, vlerëson nevojat e familjeve dhe përcakton në bashkëpunim të ngushtë me familje,t llojet e shërbimeve;

1.10 Punë këshillëdhënëse me familjet dhe fëmijët në fushën e mirëqenies sociale dhe kujdesit për fëmijë;

1.11 Përkrah procesin e hartimit të planeve familjare të zhvillimit dhe punë me fëmijët dhe familjet bazuar në ato plane;

1.12 Jep ndihmë prindërve, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre në mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve;

1.13 Organizon aktiviteteve rekreative dhe edukative për fëmijë, të rijnë dhe familje;

1.14 Terapi Individuale, familjare dhe grupore;

1.15 Identifikon burime të mundshme të ndihmës nga komuniteti;

1.16 Siguron zbatimin e të gjitha parimeve dhe procedurave që dalin nga Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe vepron në përputhje me to.

Neni 89B
Sektori i Skemës së Ndihmave Sociale

1. Sektori i Skemës së Ndihmave Sociale kryen këto detyra dhe përgjegjësi:

1.1. Mbështetë dhe ofron këshilla për Drejtorin e Qendrës për Punë Sociale dhe sipas kërkesës për Udhëheqësin më të Lartë Administrativ të Institucionit, për fushën e përgjegjësisë së sektorit që udhëheq;

1.2. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësive, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes;

1.3. Bën procedimin e aplikacioneve të palëve që aplikojnë për ndihma sociale dhe verifikon informacionet e dhëna me kriteret e pranimit;

1.4. Shpjegimi i kritereve dhe procedurave për aplikantët dhe lëshimi i fletë-aplikacioneve për palët e interesuara;

1.5. Janë përgjegjës që të pranojnë fletë-aplikacionet e plotësuara në tërësi të shoqëruara me të gjitha dokumentet përcjellëse të nevojshme;

1.6. Futja e informacioneve të aplikantit në bazën e të dhënave;

1.7. Përgatitja dhe dërgimi i aplikantëve në komisionin mjekësor;

1.8. Shqyrtimi i aplikacioneve në kohën e duhur dhe marrja e vendimeve në bazë të kritereve që i përcakton Ligji i S.A.S (Skemës së Asistencës Sociale);

1.9. Llogaritja e saktë e ndihmës që duhet ti ndahet familjes në bazë të kritereve të përcaktuara me ligj;

1.10. Mbajtja e sistemeve efikase të dosjeve, dhe përfshirja e dokumenteve të reja dhe futja e tyre në dosje.

Neni 15

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullorje është Lista e Klasfikimit të Pozitave për Shërbimin Civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Neni 16

Kjo rregullore shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

Teuta Selmani

From: Teuta Selmani
Sent: Tuesday, November 12, 2024 9:22 AM
To: Bekim Sadiku
Cc: Bedri Hamza; Lavdim Musa; Zenel Citaku; Gezim Stavileci; Lulzim Hajra
Subject: RE: Përshëndetje!

I nderuar, pas takimit të mbajtur me anëtarët e Komisionit për hartimin e Draft – Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, dhe pas shqyrtimit të propozimeve nga ana juaj ju njoftojmë si në vijim:

Sa i përket Rekomandimeve numër 1 dhe 2 të dërguara nga ju, struktura e tyre mund të ndryshojë me Kërkesën e Njësive Përgjegjëse të cilat kanë qenë të njoftuara për ndryshimin e Rregullores, mirëpo nuk kemi pranuar Kërkesë për ndryshim nga ana e tyre. Ndërsa, sa i përket Rekomandimit numër 3, për vendosjen e Sektorit për Integrime Evropiane në kuadër të Organizimit dhe Përbërjes së Zyrës së Kryetarit të Komunës, ju njoftojmë se Rregullorja Nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian, e cila Rregullore ka rregulluar që kjo Zyrë të themelohet në kuadër të Zyrës së Kryetarit, është shfuqizuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/109, dt. 23.11.2022, pas analizës jurdike për vlerësimin e bazës ligjore dhe nënligjore për aktet e nxjerra nga kjo Qeveri.

Ju faleminderit për angazhimin dhe kontributin tuaj, dhe komentet e dërguara për hartimin e këtij Drafti.

Me respekt,

Teuta Selmani
Zyrtare Ligjore – Zyra Ligjore
Komuna e Mitrovicës
Email: teuta.selmani@rks-gov.net

From: Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, November 6, 2024 3:48 PM
To: Teuta Selmani <Teuta.Selmani@rks-gov.net>
Cc: Bedri Hamza <bedri.hamza@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Gezim Stavileci <Gezim.Stavileci@rks-gov.net>
Subject: FW: Përshëndetje!

Të nderuar,

Bashkangjitur e gjeni Draft Rregulloren e Asociacionit të Komunave për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës.

Fillimisht ju falenderoj për punën në Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, si dhe për mundësinë e ofruar për të dhënë rekomandimet dhe sugjerimet në Draftin final të Rregullores në fjalë.

Ndjejë obligim ligjor që të j'u përcjellë në mënyrë kronologjike punën dhe angazhimin e Kolegjiumit të Menaxherëve të Burimeve Njerëzore në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës në lidhje me obligimin ligjor për ndryshim-plotësimin e Rregulloreve për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Në kuadër të detyrës zyrtare, si anëtar i Kryesisë së Kolegjiumit të Menaxherëve të Burimeve Njerëzore në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në vitin 2023 kemi zhvilluar shumë takime në lidhje me Ndryshim – Plotësimin e kësaj Rregulloreje, takime të cilat në dhjetor të vitit 2023 janë konkretizuar me një punëtori tre (3) ditore në qytetin e Durrësit, e që qëllimi kryesor i asaj punëtorie ka qenë hartimi i një Drafti unik të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, që do të shërbej për të gjitha Komunat e Kosovës, duke i'a bashkangjitur si pjesë përbërëse Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Pas përfundimit të punëtorisë tre (3) ditore, Asociacioni i Komunave të Kosovës, ka hartuar Draftin Final të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, Draft të cilin u'a ka dërguar të gjithë Kryetarëve të Komunave të Kosovës, në mënyrë që të bëhen ndryshimet e nevojshme sipas nevojave të secilës Komunë, **mirëpo si Rregullore duhet ta ruaj Unifikimin e Organizimit të Brendshëm.**

Ne, pas analizimit me kujdes të Draftit final për Ndryshim – Plotësimin e Rregullores Bazë, (brenda afatit të dhënë për sugjerime), konsideroj që të gjitha ndryshim-plotësimet janë bërë sipas nevojave të institucionit..,

Me qëllim të organizimit sa më të mirë të Institucionit, duke u bazuar në punën e përbashkët të Kolegjiumit të Menaxherëve të Burimeve Njerëzore në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në lidhje me hartimin e një Draft-Rregulloreje, si dhe bazuar në Draftin-Final të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, Draft të cilin e ka hartuar Asociacioni i Komunave të Kosovës.,, rekomandoj si në vijim;

1. **<u>Rekomandim;</u> Të bëhet ndryshim-plotësimi i paragrafit 1.7 të Nenit 8, të Rregullores bazë, (Organizimi dhe Përbërja e Zyrës së Kryetarit të Komunës), Ashtu që paragrafi 1.7 i Nenit 8, të fshihet në tërsi nga ky nen, dhe të vendoset si paragraf në kuadër të një neni të ri; Organizimi dhe Përbërja e Zyrës së Kuvendit të Komunës;**

2. **<u>Rekomandim;</u> Të bëhet ndryshim-plotësimi i paragrafit 1.4 të Nenit 21, të Rregullores bazë, (Organizimi i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme), Ashtu që paragrafi 1.4 i Nenit 21, të fshihet në tërsi nga ky nen, dhe të vendoset si paragraf i ri, në kuadër të Nenit 8 të Rregullores bazë, (Organizimi dhe Përbërja e Zyrës së Kryetarit të Komunës);**

3. **<u>Rekomandim;</u> Të bëhet ndryshim-plotësimi i paragrafit 1.3 të Nenit 40, të Rregullores bazë, (Organizimi i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrime Evropiane), Ashtu që paragrafi 1.3 i Nenit 40, të fshihet në tërsi nga ky nen, dhe të vendoset si paragraf i ri, në kuadër të Nenit 8 të Rregullores bazë, (Organizimi dhe Përbërja e Zyrës së Kryetarit të Komunës).**

Ju njoftoj se ndryshimet sipas rekomandimeve të lartcekura si;
Sekretaria e Kuvendit, të vendoset në kuadër të Organizimit dhe Përbërjes së Zyrës së Kuvendit të Komunës;

Njësia për të Drejtat e Njëriut, të vendoset në kuadër të Organizimit dhe Përbërjës së Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Si dhe Sektori i Integrimeve Evropiane, të vendoset në kuadër të Organizimit dhe Përbërjës së Zyrës së Kryetarit të Komunës, kanë qenë në kundershtim me natyrën e punës së këtyre sektoreve, andaj rekomandimet e lartcekura për ndryshim-potësim të këtyre neneve i shërbejnë vendosjes së ligjshmerisë në raport me natyrën e punës së këtyre sektoreve, llogaridhënjës për kryerjën e detyrave të punës, si dhe organizimit të njejtë me të gjitha Komunat e Kosovës.

From: Teuta Selmani <Teuta.Selmani@rks-gov.net>
Sent: Friday, November 1, 2024 3:38 PM
To: Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>
Cc: Bedri Hamza <bedri.hamza@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Gezim Stavileci <Gezim.Stavileci@rks-gov.net>
Subject: RE: Përshëndetje!

Me respekt,

Teuta Selmani
Zyrtare Ligjore – Zyra Ligjore
Komuna e Mitrovicës
Email: teuta.selmani@rks-gov.net

From: Teuta Selmani
Sent: Friday, November 1, 2024 3:36 PM
To: Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>
Cc: Bedri Hamza <bedri.hamza@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Gezim Stavileci <Gezim.Stavileci@rks-gov.net>
Subject: Përshëndetje!

Të nderuar shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbar, Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0064559/24, dt. 27.09.2024 ka formuar Komisionin për Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Unë si Kryetare e Komisionit, ju njoftoj se Komisioni ka përfunduar Draftin Final në bazë të rekomandimeve që i kemi marrë nga Drejtoritë/Njësitë përkatëse, të cilin po ju bashkangjesim në attach, së bashku me Rregulloren bazë.

Ju lutem që të analizoni këtë Draft, dhe të na konfirmoni harmonizimin e tij dhe zbatimin e teknikave të aktit secili për fushën e tij, duke përfshirë aspektin ligjor dhe financiar dhe sugjerimet të i dërgoni më së largu deri më datë 06.11.2024 (ditën e Mërkurë) në ora 16:00 h.

Gjithashtu, në këtë Draft nuk kemi mundur të i përfshijmë përshkrimin e detyrave të punës për: Sektorin e Skemës Sociale, Sektorin e Ndihmës Sociale dhe Sektorin e Arkivës, derisa, të njëjtat të plotësohen nga Njësitë Përgjegjëse.

Në emër të komisionit ju falenderojë për angazhimin tuaj.

Me respekt,

Teuta Selmani
Zyrtare Ligjore – Zyra Ligjore
Komuna e Mitrovicës
Email: teuta.selmani@rks-gov.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 01-020/04-0064559 **dt.** 27.09.2024
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Kërkesën Elektronike të datës 25.09.2024 nga z. Valon Hetemi – Shef i Kabinetit të Kryetarit, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale)

1. **FORMOHET** Komisioni për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale, në këtë përbërje:

   1.1 Teuta Selmani Pllana – kryetare (Zyra Ligjore);
   1.2 Gëzim Stavileci – anëtar (Drejtoria për Administratë të Përgjithshme);
   1.3 Lavdim Musa – anëtar (Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore).

2. Komisioni është përgjegjës që të bëj ndryshimin e Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale, duke bërë harmonizimin e këtyre ndryshimeve në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe dispozitave ligjore pozitive tjera në fuqi.

3 Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores për Ndryshimin e Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.

4 Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Rregulloren Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat

dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5 Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi obligohet që të hartojë Draft-Rregulloren në afat më së largu brenda 3 (tre) muajsh, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

6 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

1x1 Kërkesa Elektronike e datës 25.09.2024 nga z. Valon Hetemi – Shefi i Kabinetit të Kryetarit.

T'i dërgohet:

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit

Teuta Selmani

From: Valon Hetemi
Sent: Wednesday, September 25, 2024 2:11 PM
To: Teuta Selmani; Lulzim Hajra; Bukurije Ujkani

Te nderuar,

Emrat e propozuar per formimin e Komisionit per Plotesim – Ndryshimin e Rregullores per Organizimin e Brendshem te Komunes jane:

1.Teuta Selmani Pllana – Kryesuse
2.Gezim Stavileci - anetar
3.Lavdim Musa - anetar

Valon Hetemi

Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut / Chief of the Cabinet at Municipality of Mitrovica South

Komuna e Mitrovicës së Jugut | Municipality of Mitrovica South
Rr./ Str. "Bedri Gjinaj" Mitrovicë / Mitrovica
Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Mob: +383 (0)49 230 301
Email: valon.hetemi@rks-gov.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of **Mitrovica South**

Kryetari i Komunës
Nr. 01-030/01-0074195/24
Dt. 14.11.2024

Bazuar në nenin 13, nenin 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) , nenin 43 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, nenin 38 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës Në Shërbimin Civil, Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, sjell këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi nr. 01-052/01-0074146, i datës 13.11.2024, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për nëpunësit civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut, shtojca-Lista e klasifikimit të vendeve të punës është pjesë e këtij vendimi.
2. Obligohen Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që ta zbatoj vendimin dhe të përgatit akt emërimet për nëpunësit civil të Komunës së Mitrovicës së Jugut sipas klasifikimit.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bedri HAMZA
Kryetar i Komunës

SHTOJCA NUMËR 1: **Tabela e klasifikimit të vendeve të punës, në Komunën e Mitrovicës së Jugut**

Nr.	Struktura	Kategoria (*sipas ligjit për zyrtarët publik*)	Grupi (*përgjithshëm ose i veçantë*)	Klasa (*sipas ligjit për pagat në sektorin publik*)	Numri i zyrtarëve
1.	**KUVENDI I KOMUNËS**				
	- Kryesuesi i Kuvendit	Kryesues i Kuvendit Komunal 2	Funksionar Publik	Y11	1
	- Anëtarët e Kuvendit	Anëtar i Kuvendit Komunal i	Funksionar Publik	Y34	34
	- Asistenti i Kryesuesit	Nëpunës i Kabineti 1	Gripi i administrimit të përgjithshëm	C18	1
2.	**ZYRA E KRYETARIT**				
	- Kryetar i Komunës	Kryetar i komunës 2	Funksionar publik	Y3	1
	- Nënkryetar i Komunës	Nënkryetar i komunës 2	Funksionar publik	Y11	1
	- Shef kabineti	Këshilltar politik (Shef kabineti) 1	Zyrtar i kabinetit	C8A	1
	- Zyrtar për marrëdhënie me publikun	Nëpunës kabineti 1	Zyrtar i kabinetit	C18	1
	- Zyrtar aministrativ	Nëpunës kabineti 1	Zyrtar i kabinetit	C18	1
	- Asistent administrative i Nënkryetarit	Nëpunës kabineti 1	Zyrtar i kabinetit	C18	1
	- Zyrtar për logjistikë (Shofer) i Kryetarit	Nëpunës kabineti 2	Zyrtar i kabinetit	C23	1
	- Asistent administrativ	Nëpunës i kabinetit 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	C23	1
	- Punëtor në bufe	Nëpunës teknik dhe mbështetës 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ49	1
	- Përfaqësuesi ligjor i komunës	Avokat komunal	Grupi ligjor	V4	1
	- Zyrtar i lartë ligjor	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore				
	- Menaxher i burimeve njerëzore	Drejtues i ulët	Grupi i burimeve njerëzore	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë i burimeve njerëzore	Profesional 1	Grupi i burimeve njerëzore	GJ27	2
	- Zyrtar i burimeve njerëzore	Profesional 2	Grupi i burimeve njerëzore	GJ35	2
	Zyra për komunikim me publikun				
	- Udhëheqës i njësisë për komunikim me publikun	Drejtues i ulët	Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informim	GJ3	1
	- Zyrtar për informim	Profesional 2	Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informim	GJ35	2
	- Zyrtar për komunikim me publikun	Profesional 2	Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informim	GJ35	1
	Zyra ligjore				
	- Udhëheqës i zyrës ligjore	Drejtues i ulët	Grupi ligjor	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë ligjor	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	2

	- Zyrtar ligjor	Profesional 2	Grupi ligjor	GJ35	1
	Zyra e prokurimit				
	- Udhëheqës i prokurimit	Drejtues i ulët	Grupi i prokurimit publik	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë i prokurimit	Profesional 1	Grupi i prokurimit publik	GJ27	2
	Zyrtar i prokurimit	Profesional 2	Grupi i prokurimit publik	GJ35	2
	Sektori për punë të kuvendit komunal				
	- Udhëheqës i sektorit për punë të kuvendit komunal	Drejtues i ulët	Grupi ligjor	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për çështjet e kuvendit të komunës	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	Njësia e auditimit të brendshëm				
	- Udhëheqës i auditimit të brendshëm	Drejtues i ulët	Grupi i auditimit të brendshëm	W9	1
	- Auditor i brendshëm	Auditor i brendshëm	Grupi i auditimit të brendshëm	W15	2
	Zyra komunale për komunitete dhe kthim				
	- Udhëheqës i sektorit për komunitete dhe kthim	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për komunitete	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	GJ27	1
	- Zyrtar i lartë për kthim dhe intergim të komuniteteve	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	GJ27	1
	- Zyrtar për komunitete	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar për kthim të qëndrueshëm	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Asistent administrativ	Profesional 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ43	1
3.	**DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**				
	- Drejtor i Drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	- Zyrtar për financa	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ35	1
	- Zyrtar për mbështetje ligjore	Profesional 2	Grupi ligjor	GJ35	1
	Sektori për gjendje civile				
	- Udhëheqës i sektorit për gjendje civile	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për mbështetje ligjore	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	- Zyrtar për gjendje civile	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	GJ35	15

	Qendra për shërbime të qytetarëve				
	- Udhëheqës i sektorit për shërbime me qytetarë	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Zyrtar për shërbim me qytetarë	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	8
	- Zyrtar për arkiv	Profesional 2	Grupi i arkiv-dokumentacionit	GJ35	3
	- Recepsionist	Teknik dhe mbështetës 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ50	1
	Njësia për të drejtat e njeriut				
	- Udhëheqës i njësisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për barazi gjinore	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	GJ27	1
	- Zyrtar për të drejtat e njeriut	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	GJ35	1
	- Zyrtar për të drejta të fëmijëve	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	GJ35	1
	Sektori për teknologji informative				
	- Udhëheqës i sektorit për teknologji informative	Drejtues i ulët	Grupi i teknologjisë informative	GJ3	1
	- Zyrtar për teknologji informative	Profesional 2	Grupi i teknologjisë informative	GJ35	3
	Sektori i punëve të përbashkëta				
	- Udhëheqës i Sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar për furnizim dhe transport	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Monitorues i kamerave	Profesional 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ43	1
	- Ndihmës punëtor	Teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ50	1
	- Vozitës	Teknik dhe mbështetës 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	6
	- Roje objekti	Teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	5
	- Mirëmbajtës i objektit	Teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	2
4.	**DREJTORIA E SHËNDETËSISË**				
	- Drejtor i Drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	Sektori i administratës në shëndetësi				
	- Udhëheqës i sektorit të administratës në shëndetësi	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar i Lartë për shëndetësi	Profesional 1	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë	GJ27	1

	- Zyrtar për shëndetësi	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë	GJ35	1
	- Zyrtar ligjor	Profesional 2	Grupi ligjor	GJ35	1
	- Zyrtar për financa	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ35	1
5.	**DREJTORIA E ARSIMIT**				
	- Drejtor i drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	- Zyrtar i lartë ligjor	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	Sektori për arsim				
	- Udhëheqës i sektorit për zhvillimin e arsimit	Drejtues i ulët	Grupi i arsimit	GJ3	1
	- Zyrtar për arsimin parashkollor	Profesional 2	Grupi i arsimit	GJ35	2
	- Zyrtar për arsimin e mesëm të ulët	Profesional 2	Grupi i arsimit	GJ35	2
	- Zyrtar për arsimin e mesëm të lartë	Profesional 2	Grupi i arsimit	GJ35	2
	Sektori i administratës në arsim				
	- Udhëheqës i sektorit të administratës në Arsim	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar për buxhet dhe financa	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ35	1
	- Zyrtar për bashkëpunim	Profesional 2	Grupi ligjor	GJ35	1
	- Zyrtar për infrastrukturë dhe menaxhim të objekteve	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar për paga	Profesional 2	Grupi i burimeve njerëzore	GJ35	1
	- Zyrtar i pasurisë	Profesional 2	Grupi i ekonomisë	GJ35	1
	- Zyrtar për teknologji informative	Profesional 2	Grupi i teknologjisë informative	GJ35	1
6.	**DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA**				
	- Drejtor i Drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	- Zyrtar i lartë për mbështetje ligjore	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	- Zyrtar i lartë certifikues	Profesional 1	Grupi i ekonomisë	GJ27	1
	Sektori për buxhet dhe financa				
	- Udhëheqës i sektorit për buxhet dhe financa	Drejtues i ulët	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa	Profesional 1	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ27	2
	- Zyrtar për buxhet dhe financa	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ35	6
	- Zyrtar për financa	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ35	1
	- Zyrtar për zotim të mjeteve buxhetore	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ35	1
	- Zyrtar i pasurisë	Profesional 2	Grupi i ekonomisë	GJ35	1

	- Zyrtar i lartë për shpenzime - Zyrtar për të hyra financiare - Zyrtar për arkiv - Arkëtar - Vozitës	Profesional 1 Profesional 2 Profesional 2 Profesional 3 Teknik dhe mbështetës 2	Grupi i buxhetit dhe financave Grupi i buxhetit dhe financave Grupi i arkiv-dokumentacionit Grupi i ekonomisë Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ27 GJ35 GJ35 GJ43 GJ50	1 1 1 2 1
	Sektori i tatimit në pronë - Udhëheqës i sektorit të tatimit në pronë	Drejtues i ulët	Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	GJ3	1
	- Zyrtar për mbledhjen e tatimit	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	GJ35	6
	- Zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	GJ35	2
	- Zyrtar për regjistrim dhe menaxhimin të dhënave të tatimit në prone	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave	GJ35	2
7.	**DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM, TURIZËM DHE INTEGRIME EVROPIANE** - Drejtor i Drejtorisë - Zyrtar i lartë ligjor	Drejtor i drejtorisë komunale 2 Profesional 1	Funksionar publik Grupi ligjor	Y18 GJ27	1 1
	Sektori i ekonomisë dhe turizmit - Udhëheqës i sektorit - Zyrtar për ekonomi	Drejtues i ulët Profesional 2	Grupi i ekonomisë Grupi i ekonomisë	GJ3 GJ35	1 2
	Sektori për integrim evropian - Udhëheqës i sektorit - Zyrtar i lartë për integrim evropian	Drejtues i ulët Profesional 1	Grupi i shkencave politike Grupi i shkencave politike	GJ3 GJ27	1 1
	- Zyrtar për integrim evropian	Profesional 2	Grupi i shkencave politike	GJ35	1
	Sektori i zhvillimit - Udhëheqës i sektorit - Zyrtar për regjistrimin e bizneseve	Drejtues i ulët Profesional 2	Grupi i ekonomisë Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3 GJ35	1 2
8.	**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE URBANIZMIT** - Drejtor i Drejtorisë - Zyrtar për buxhet dhe financa - Zyrtar i lartë Ligjor - Zyrtar për mbështetje ligjore	Drejtor i drejtorisë komunale 2 Profesional 2 Profesional 1 Profesional 2	Funksionar publik Grupi i buxhetit dhe financave Grupi ligjor Grupi ligjor	Y18 GJ35 GJ27 GJ35	1 1 1 1

	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	Sektori i planifikimit				
	- Udhëheqës i sektorit të planifikimit	Drejtues i ulët	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ3	1
	- Zyrtar për planifikim dhe sistem të adresave	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ11	1
	- Zyrtar për hapësira publike	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	Sektori i Urbanizmit				
	- Udhëheqës i sektorit të urbanizmit	Drejtues i ulët	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ3	1
	- Zyrtar për urbanizëm dhe planifikim	Profesional 2	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ11	1
	- Zyrtar për leje ndërtimore	Profesional 2	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ11	1
	- Zyrtar i lartë për elektrikë	Profesional 1	Grupi i inxhinierisë elektrike	GJ11	1
	- Zyrtar i lartë për arkitekturë	Profesional 1	Grupi i arkitekturës	GJ27	1
	Sektori i legalizimit				
	- Udhëheqës i sektorit të legalizimit	Drejtues i ulët	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për legalizim	Profesional 1	Grupi i arkitekturës	GJ11	1
	- Zyrtar i lartë për arkitekturë	Profesional 1	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ11	1
9.	**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURËS**				
	- Drejtor i drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	- Zyrtar i lartë ligjor	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	- Zyrtar i lartë për financa	Profesional 1	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ27	1
	- Asistent administrativ	Profesional 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ43	1
	Sektori i shërbimeve publike				
	- Udhëheqës i sektorit të shërbimeve publike	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Zyrtar për mirëmbajtjen e rrugëve	Profesional 2	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ35	1
	- Zyrtar për transport dhe trafik	Profesional 1	Grupi i inxhinierisë mekanike	GJ11	1
	- Zyrtar për ambient	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	GJ11	1
	- Punëtor fizik	Teknik dhe mbështetës 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ50	1
	Sektori i infrastrukturës				
	- Udhëheqës i sektorit të infrastrukturës	Drejtues i ulët	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ3	1
	- Zyrtar për ndërtim dhe rindertim te rrugeve	Profesional 1	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ11	2
	- Zyrtar për ndërtimtari	Profesional 1	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ11	2

10.	**DREJTORIA E BUJQËSISË**				
	- Drejtor i drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y8	1
	- Zyrtar ligjor	Profesional 2	Grupi ligjor	GJ35	1
	Sektori i bujqësisë				
	- Udhëheqës i sektorit të bujqësisë	Drejtues i ulët	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për blegtori	Profesional 1	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	GJ11	1
	Zyrtar për bujqësi	Profesional 1	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	GJ11	1
	- Zyrtar për bashkëpunim	Profesional 2	Grupi i shkencave politike	GJ35	1
	Sektori i zuvillimit rural				
	- Udhëheqës i sektorit të zhvillimit rural	Drejtues i ulët	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	GJ3	1
	- Zyrtar për produkte ushqimore joshtazore	Profesional 2	Grupi i shkencave natyrore	GJ11	1
	- Zyrtar për mbrojtje dhe shfrytëzimin e kullosave	Profesional 2	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	GJ35	1
	- Zyrtar për zhvillim rural dhe bujqësor	Bujqësor	Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	GJ11	1
11.	**DREJTORIA E INSPEKCIONIT**				
	- Drejtor i Drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	- Zyrtar i lartë ligjor	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	- Asistent administrative	Profesional 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ43	2
	Sektori i inspekcionit të tregut				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Inspektor i tregut	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	GJ19	4
	Sektori i inspekcionit të ndërtimit				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Inspektor i ndërtimit	Profesional 1	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit	GJ19	4
	Sektori i inspekcionit të shërbimeve publike dhe mbrojtje të mjedisit				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Inspektor i shërbimeve publike	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ19	4
	- Inspektor i mbrojtjes së mjedisit	Profesional 1	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	GJ19	4
	Sektori i inspekcionit të transportit rrugor				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1

	- Inspektor i transportit rrugor	Profesional 1	Grupi i përgjithshëm i inxhinierisë	GJ19	4
12.	**DREJTORIA PËR SIGURI DHE EMERGJENCA**				
	- Drejtor i Drejtorisë	Drejtor i drejtorisë klomunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	Sektori i parandalimit dhe gatishmërisë				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i sigurisë	GJ3	1
	- Zyrtar për emergjenca	Profesional 2	Grupi i sigurisë	GJ35	2
	Sektori i reagimit dhe rimëkëmbjes				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i sigurisë	GJ3	1
	- Zyrtar për emergjenca	Profesional 2	Grupi i sigurisë	GJ35	2
13.	**DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT**				
	- Drejtor i drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y8	1
	- Zyrtar i lartë për mbështetje ligjore	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	- Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa	Profesional 1	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ27	1
	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	Sektori i kulturës				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar për kulturë	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	GJ35	2
	Sektori i Sportit				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Zyrtar për sport	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	2
	Sektori i rinisë				
	- Udhëheqës i sektorit të rinisë	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar për rini	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	GJ35	2
	- Zyrtar për shoqëri civile	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	Biblioteka e qytetit				
	- Drejtor i biblioteksës	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar i libraries	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Bibliotekist	Bibliotekist	Grupi i arsimit	E23	5
	- Librar	Bibliotekist	Grupi i arsimit	E23	7

	- Zyrtar për biblioteka	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	2
	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Pastrues	Nëpunës teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	2
	Qendra e kulturës				
	- Drejtori i qendrës së kulturës	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	Grupi i shkencave shoqërore	K5	1
	- Zyrtar ligjor	Profesional 2	Grupi ligjor	GJ35	1
	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar për kulturë	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	GJ35	1
	- Zyrtar i depos	Profesional 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ43	1
	Muzeu i qytetit				
	- Drejtori i muzeut	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	Grupi i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore	K5	1
	- Zyrtar për shërbim me qytetarë	Profgesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar i arkivit	Profgesional 2	Grupi i arkiv dokumentacionit	GJ35	1
	- Zyrtar teknik i muzeut	Profgesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Operator në kompjuter	Profgesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar i lartë për trashëgimi kulturore	Profgesional 1	Grupi i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore	GJ35	1
	- Zyrtar për etnologji	Profgesional 2	Grupi i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore	K7	1
	- Roje objekti	Nëpunës teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	2
	Palestra e sporteve				
	- Udhëheqës i palestrës	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Mbikëqyrës i mirëmbajtjes	Nëpunës teknik dhe mbështetës 1 (Udhëheqës)	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ49	1
	- Mirëmbajtës	Nëpunës teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	3
	- Koordinator i punëve teknike	Nëpunës teknik dhe mbështetës 1 (Udhëheqës)	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ49	1
	- Mirëmbajtës teknik i objektit	Nëpunës teknik dhe mbështetës 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ50	4
	Teatri i qytetit				
	- Drejtori i Teatrit	Drejtues i mesëm	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	K4	1
	- Zyrtar administrative dhe financiar	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar administrative	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1

	- Teknik i ndriçimit në teatër	Profesional 3	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	K8	1
	- Aktor	Profesional 1	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	K6	10
	- Organizator	Profesional 2	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	K7	1
	- Kostumograf	Proesional 3	Krijues dhe performuEs i artit dhe kulturës	K8	1
	- Mjeshtër i skenës dhe shtëpiak	Proesional 3	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	K8	1
	- Përgjegjëse për skenën e fëmijëve	Proesional 3	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	K8	1
	- Elektricist/Tonist	Profesional 3	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	K8	1
	- Rekuiziter/Biletashitës	Profesional 3	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	K8	1
	- Punëtor skene	Profesional 3	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës	K8	2
	- Pastruese	Nëpunës teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	1
14.	**DREJTORIA E MBROJTJES SË MJEDISIT**				
	- Drejtor i Drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	- Zyrtar i lartë ligjor	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	- Zyrtar për buxhet dhe financa	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ35	1
	Sektori i mbrojtjes së mjedisit				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	GJ3	1
	- Zyrtar për leje mjedisore	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	GJ35	1
	- Zyrtar për mbrojtje të mjedisit	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	GJ35	1
	Sektori për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	GJ3	1
	- Zyrtar për menaxhimin e mbeturinave	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	GJ35	1
	- Zyrtar për ambient	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i mjedisit	GJ35	1
15.	**DREJTORIA E GJEODEZISË KADASTRIT DHE PRONËS**				
	- Drejtor i drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 3	Funksionar publik	Y8	1
	- Zyrtar për financa	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ35	1
	- Asistent administrativ	Profesional 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ43	1
	Sektori i gjeodezisë				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i gjeodezisë	GJ3	1

	- Zyrtar për kadastër dhe gjeodezi	Profesional 2	Grupi i gjeodezisë	GJ11	1
	- Zyrtar për Gjeodezi	Profesional 2	Grupi i gjeodezisë	GJ35	5
	Sektori i kadastrit				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për financa	Profesional 1	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ27	1
	- Zyrtar i lartë për mbështetje ligjore	Profesional 1	Grupi ligjor	GJ27	1
	- Zyrtar për bashkëpunim	Profesional 2	Grupi i shkencave politike	GJ35	1
	- Zyrtar për kadastër	Profesional 2	Grupi i gjeodezisë	GJ35	1
	- Zyrtar për hipoteka	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	Sektori i pronës				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi ligjor	GJ3	1
	- Zyrtar për çështje pronësore	Profesional 2	Grupi ligjor	GJ35	3
16.	**DREJTORIA E MIRËQENIES SOCIALE**				
	- Drejtor i Drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	Sektori i mirëqenies sociale				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar për mirëqenie sociale	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar për strehim	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	GJ35	1
	Sektori për përkujdesje ndaj familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve dhe viktimave civile				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar për kategoritë e luftës	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	GJ35	2
	Qendra për punë sociale	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Drejtor i qendrës	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	GJ35	1
	- Zyrtar për buxhet dhe financa	Profesional 2	Grupi i arkiv dokumentacionit	GJ35	2
	- Zyrtar për arkiv				
	Sektori i shërbimeve sociale				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për shërbime sociale	Profesional 1	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	GJ27	9
	- Zyrtar për çështje psikologjike	Profesional 2	Grupi i psikologjisë	GJ35	2
	Sektori i skemës së ndihmës sociale				
	- Udhëheqës i sektorit	Drejtues i ulët	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	GJ3	1
	- Zyrtar i asistencës sociale	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	GJ35	6

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of **Mitrovica South**

Kryetari i Komunës
Nr. 01-020/04 - 0047307/24
Dt. 15/04/2024

Në pajtim me nenin 13 dhe 58, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 77 i Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, për zbatimin e nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikim të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kryetari i Komunës sjell:

V E N D I M
(për formimin e grupit të vlerësimit për klasifikimin në shërbimin civil)

1. Formohet Grupi i vlerësimit për klasifikim në shërbimin civil, në përbërje:

    1. Lavdim Musa - kryesues
    2. Berat Jashari – anëtar
    3. Arsim Dragaj – anëtar.

2. Grupi punues është përgjegjës për klasifikimin e vendeve të punës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024, për Klasifikim të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi nr. 01-120/04-0093870/23, i datës 29.12.2023.

4. Vendimi hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

T`i dërgohet:
1X1 Kryetarit të Komunës
1X1 Anëtarëve të Komisionit
1X1 Zyrës së Personelit

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DATË/A:	**14.10.2024**
REFERENC-Ë:	02-110/04-0068130/24
PËR/ZA/TO:	**Znj.Vesa Broja-Kryesuese e Kuvendit të Komunës , Mitrovica e Jugut**
PËRMES/PREKO/THROUGH:	**Kryetarin e Komunës, z.Bedri HAMZA**
NGA/OD/FROM:	**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport** **Drejtor Z. Fahri Jashari**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Kërkesë**

E nderuara znj Broja,

Pas përfundimit të hartimit për ndryshim/plotësimit të Draft-Statutit të Bibliotekës së Qytetit "Latif Berisha", nga ana e Komisionit, ju prezantojmë Draft-Statutin dhe kërkojmë ta procedoni për votim në Kuvendin e Komunës në seancën e ardhshme.
Të bashkagjitur do të gjeni dokumentet përcjellëse në lidhje me draft/statutin.

Me respekt,

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Formulari për procedim të lëndës për nënshkrim;

Përmes këtij formulari, nga personat nënshkrues **KONFIRMOHET**, së Lënda e Proceduar për nënshkrim Nr. 02-110/04-0068130/24, dt. 14.10.24 (për hartimin e Statutit të Bibliotekës së qytetit "Latif Berisha", është në përputhje me ligjet në fuqi dhe të gjitha aktet juridike në fuqi.

Nr.	Personi përgjegjës	Pozita	Nënshkrimi
1.	Fahri Jashari	Propozuesi	
2.		Udhëheqësi i Sektorit	
3		Zyrtari/ja Ligjor/e e Drejtorisë	
4.	Fahri Jashari	Drejtori	
5.		Zyra ligjore	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 01-020/04-0026265/23 **dt.** 28.03.2023
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0026265/23, dt. 28.03.2023, të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Hartimin e Ndryshim/Plotësimit të Draft – Statutit të Bibliotekës së Qytetit "Latif Berisha" me Nr. Prot. 02/06-52716/6, dt. 27.12.2012)

1. **FORMOHET** Komisioni për Hartimin e Ndryshim/Plotësimit të Draft - Statutit të Bibliotekës së Qytetit "Latif Berisha" me Nr. Prot. 02/06-52716/6, dt. 27.12.2012), në këtë përbërje:

   1.1 Bedri Murati – kryetar (DKRS);
   1.2 Lavdim Musa – anëtar (NJMBNJ);
   1.3 Mentor Ujkani – anëtar (DBF);
   1.4 Arbër Hajra – anëtar (DKRS);
   1.5 Merita Preteni – anëtare (SK).

2. Komisioni është përgjegjës që të bëj hartimin e Ndryshim/Plotësimit të Draft – Statutit të Bibliotekës së Qytetit "Latif Berisha" me Nr. Prot. 02/06-52716/6, dt. 27.12.2012, dhe të bëj harmonizimin e tij me dispozitat ligjore pozitive në fuqi.

3 Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft – Statutit të lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.

4 Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr. 04/L-097 për Bibliotekat, Ligjin Nr. 06/L - 121 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-097 për Biblioteka, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Statutin e Bibliotekës së Qytetit "Latif Berisha" Nr. 02/06-52716/6, dt. 27.12.2012, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5 Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi obligohet që të hartojë Draft-Statutin në afat më së largu brenda 6 (gjashtë) muajsh, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

6 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

Propozim-Vendimi i DKRS-së Nr. 01-020/04-0026265/23, dt. 28.03.2023.

T'i dërgohet:

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DATË/A:	28.03.2023
REFERENC-Ë:	01-020/04-0026265/23
PËR/ZA/TO:	Kryetarin e Komunës, z.Bedri HAMZA
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Drejtoresha Znj. Valdete Idrizi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim- vendim

Në bazë të nenit 13, të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës"nr28/15), 4 qershor 2008, si dhe pika 1.5 e nenit 77-të të statutit të Komunës së Mitrovicës me nr. 02-060/01-0056607/20-4 të datës 20.04.2020, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport sjellë këtë:

Propozim – Vendim

I propozohet Kreyetarit të Komunës së Mitrovicës çë të formojë komisionin për ta bërë plotësim ndryshimin e statutit të Biblotekës së Qytetit "Latif Berisha" me nr të prot. 02/06-52716/6 dt. 27.12.2012.

a. Bedri Murati - Zyrtar Ligjor në DKRS-së - Kryetar
b. Lavdim Musa - Zyrtar i Personelit – anëtar
c. Mentor Ujkani – Zyrtar në Drejtorin e Financave - anëtar
d. Arbër Hajra – Zyrtar i administrates në DRKS-së - anëtar
e. Merita Preteni – Zyrtare e lartë për Kuvend - anëtare

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Formulari për procedim të lëndës për nënshkrim;

Përmes këtij formulari, nga personat nënshkrues **KONFIRMOHET**, së Lënda e Proceduar për nënshkrim Nr. _____ , dt._____ (Propozim vendim për ta **bërë plotësim ndryshimin e statutit të Biblotekës së Qytetit "Latif Berisha"**)" është në përputhje me ligjet në fuqi dhe të gjitha aktet juridike në fuqi.

Nr.	Personi përgjegjës	Pozita	Nënshkrimi
1.		Propozuesi	
2.		Udhëheqësi i Sektorit	
3	Besim Muarti	Zyrtari/ja Ligjor/e e Drejtorisë	
4.	Valdete Idriz	Drejtori /esha	
5.		Zyra ligjore	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

KONSULTIM PUBLIK PËR DRAFT - STATUTIN E BIBLIOTEKËS KOMUNALE TË MITROVICËS "LATIF BERISHA"

Lista e pjesëmarrjes
Participants List

11.10.2024, Mitrovicë

Nr.	Emri dhe mbiemri Name and Surname	Institucioni Institution	Kontakti email Contact email	Kontakti tel Contact tel	Fotografitë dhe videot e realizuara gjatë kësaj ngjarje mund të përdoren si material promovues për projektin; Photos and videos taken during this event can be used as promotional material for the project;	Nënshkrimi Signature
1	Kastriot Hasani		kastriot.hasani@rks-gov.net	049/552-313		Hasani
2	VISAR BERISHA		[illegible]	049 189 221		[illegible]
3	Vjosa Veseli	sh.m.e. Hasan Prishtina	vjosaveseli@gmail.com	049-770778	✓	Veseli
4	Majlinda Begiri	sh.m.e. Hasan Prishtina	begiri.linda@hotmail.com	049-542 188	✓	[illegible]
5	Majlinda Jashari		mjashari13@hotmail.com	049 971 275		[illegible]

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

6	Sadije Jashari	Komuna e Mitrovicës	sadije.jashari@rks-gov.net		✓	
7	Ardita Veseli Gjinovci	Komuna e Mitrovicës	ardit.v.gjinovci@rks-gov.net 049 283 582		✓	
8	Selvete Tahiri	Komuna e Mitrovicës	selvete.tahiri@rks-gov.net		✓	
9	Tyrkan Dedinja	Komuna e Mitrovicës	tyrkan.dedinja@rks-gov.net		✓	
10	Donjeta Maxhuni	Komuna e Mitrovicës	donjeta.maxhuni@rks-gov.net			
11	Gonxhe Prekaçi	Komuna e Mitrovicës	gonxhe.prekaci@rks-gov.net			
12	Albina Ibishi	DKRS	albinaibishi3@gmail.com		✓	
13						
14						
15						

Takimi i Bordi i Komisionit për
Plotësimin/Ndryshimin e Statutit të
Bibliotekës së Qytetit „Latif Berisha"
Lista e Pjesëmarrësve e
Bedri Memati

Mentor Djkani

Merita Prekeno

Arbër Hoxha

23.05.2023

Takimi i bërë i Komisionit për Profesionalizimin e Stafit të Bibliotekës Komunale „Ibrahim Berisha"

Anëtarët e Komisionit:

1. Bekim Mehmeti
2. Fatime Hyseni
3. Arbër Hasani
4.
5.

Data 14.09.2023

Mitrovicë

DRAFT - STATUTI
I
BIBLIOTEKËS KOMUNALE TË MITROVICËS
"LATIF BERISHA"

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Më këtë Statut rregullohet statusi juridik i Bibliotekës Komunale të Mitrovicës "Latif Berisha" (në tekstin e mëtejmë Biblioteka), veprimtaria e bibliotekës, organizimi, përfaqësimi, planifikimi dhe transparenca.

Neni 2

Biblioteka është një ndër institucionet qendrore të qytetit dhe ka për qëllim t'i shërbejë formimit kulturor të qytetarëve përmes librit, shtypit periodik, internetit etj. Biblioteka është qendra më e rëndësishme e qytetit në grumbullimin, ruajtjen, përpunimin dhe shërbimin e librit. Është qendër metodike për krejt rrjetin e bibliotekave të qytetit.

Neni 3

Për realizimin e qëllimit, të drejtave dhe përgjegjësive që i takojnë, Biblioteka vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit për Biblioteka, Ligjit për institucionet kulturore, këtë Statut dhe vendimet që i miraton Kuvendi i Komunës së Mitrovicës.

II. STATUSI JURIDIK I BIBLIOTEKËS

Neni 4

3.1 Biblioteka e Mitrovicës është themeluar në vitin 1946. Me vendim të kryetarit të Këshillit komunal të Mitrovicës më 25.11. 1999 emërtohet Biblioteka e Qytetit "Latif Berisha".

3.2 Komuna siguron mbështetjen financiare dhe ruan të drejtat e saja administrative.

Neni 5

Selia e Bibliotekës është në Mitrovicë, rruga "_____", nr. ___.

Neni 6

6.1 Emërtimi i Bibliotekës është: *Biblioteka Komunale e Mitrovicës "Latif Berisha"*.

6.2 Biblioteka ka status të institucionit publik, me të drejta dhe përgjegjësi që i takojnë me Ligj, Statut dhe vendime të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës.

6.3. Pasuria e Bibliotekës është pronë e Komunës.

6.4. Në ballinën hyrëse të objektit të Bibliotekës vendoset mbishkrimi në gjuhët zyrtare, të cilat parashihen me Ligjin për përdorim të gjuhëve.

Neni 7

7.1 Biblioteka ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore, e cila përdoret për protokollimin e shkresave.

7.2 Vula e rrumbullakët është me diametër 4 cm, në tre rrathë koncentrikë, dhe përmban këto të dhëna:

7.2.1 Në rrethin e parë të jashtëm shkruhet: Republika e Kosovës.

7.2.2 Në rrethin e dytë shkruhet: Komuna e Mitrovicës dhe Mitrovicë.

7.2.3 Në rrethin e tretë shkruhet: Biblioteka Komunale "Latif Berisha".

7.2.4 Në sipërfaqen e mbetur brenda rrethit të tretë të vulës vendoset emblema e komunës, kurse në prapavijë libri i hapur.

7.3 Teksti i vulës është me shkronja të mëdha të shtypit, në madhësi dhe formë të njëjtë, në gjuhët zyrtare t ë Kosovës.

7.4 Vula katrore e protokollit është e madhësisë 6 x 2.5 cm, me këtë përmbajtje, sipas renditjes:

7.4.1 Republika e Kosovës.

7.4.2 Komuna e Mitrovicës.

7.4.3 Biblioteka Komunale "Latif Berisha".

7.4.4 Numri i protokollit i njësisë organizative, në vazhdim lihet hapësira për shënimin e numrit të protokollit të shkresës.

III. VEPRIMTARIA E BIBLIOTEKËS

Funksionet dhe detyrat e Bibliotekës Komunale

Neni 8

8.1 Biblioteka është institucion kulturor dhe informues, që nxit të mësuarit gjatë gjithë jetës, zgjerimin e dijeve dhe interesin për lexim në rajonin ku ajo zhvillon veprimtarinë e saj.

8.2 Biblioteka siguron qasje të lirë në dije e informacion dhe ofron shërbim të barabartë për të gjithë qytetarët.

8.3 Biblioteka është institucion kyç për koleksionimin, ruajtjen dhe propagandimin e kulturës së Mitrovicës.

8.4 Biblioteka krijon katalog dhe siguron informacion të materialeve bibliotekare me karakter historik, kulturor dhe shkencor.

8.5 Koleksionet e Bibliotekës, me materiale në shqip dhe në gjuhë të huaja, krijohen nëpërmjet blerjes, shkëmbimit dhe dhuratave. Komuna kujdeset që çdo vit të ndajë fonde financiare për pasurimin e Bibliotekës me literaturë në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhë të huaja.

8.6 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport kujdeset që të gjitha materialet e sesioneve shkencore apo të simpoziumeve, historikët e ndryshëm për qytetin dhe rrethinën të depozitohen në të, të klasifikohen dhe të futen në shërbim të lexuesve e studiuesve në të ardhmen.

8.7 Biblioteka, sipas nevojës, mund të themelojë degët e veta në lokalitete, sipas kërkesave dhe mundësive buxhetore.

8.8 Stafi profesional i Bibliotekës përzgjidhet në përputhje me përgatitjen profesionale bibliotekare.

8.9 Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta, Biblioteka ka të drejtë të hyjë në marrëdhënie me bibliotekat e komunave tjera, me qëllim bashkëpunimi në fushën e bibliotekarisë për dhënien e ndihmës së ndërsjellë njëra-tjetrës dhe plotësimin e veprimtarisë me koleksione, huazime dhe falje të materialeve bibliotekare.

8.10 Biblioteka e përfshirë në cilëndo formë të bashkëpunimit ndërkomunal, veç e veç apo bashkërisht, mban përgjegjësi juridike për të gjitha veprimet juridike që rezultojnë nga bashkëpunimi në fjalë.

8.11 Sipas pikës 10 të këtij neni, me propozimin e vet bibliotekave të interesuara, Ministria e Kulturës mund të koordinojë punën për arritjen e një marrëveshjeje, me të cilën caktohet biblioteka që do ta kryejë funksionin e bibliotekës koordinuese.

Neni 9

9.1 Në kuadër të Bibliotekës zhvillohen edhe këto veprimtari:

9.1.1 Koordinimi dhe mbikëqyrja e punës profesionale të degëve brenda territorit të komunës së Mitrovicës, duke ndihmuar në pasurimin e fondeve me koleksione bibliotekare.

9.1.2 Grumbullimi i materialit bibliotekar i formateve të ndryshme nga të gjitha fushat e dijes, regjistrimi, përpunimi, sistemimi, ruajtja, mirëmbajtja, ofrimi në shfrytëzim për përdoruesit dhe digjitalizimi i materialit ekzistues.

9.1.3 Ofrimi i qasjes në materialin bibliotekar për të gjithë shfrytëzuesit e saj, brenda territorit të komunës e më gjerë.

9.1.4 Bashkëpunimi në përpilimin e katalogut të përbashkët elektronik me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe ofrimi i tij në dispozicion të përdoruesve.

9.1.5 Bashkëpunimi me bibliotekat komunale të themeluara në Kosovë, Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, bibliotekat tjera të themeluara me ligj dhe bibliotekat ndërkombëtare.

9.1.6 Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative në ambientet e saj, siç janë: ekspozitat e librit, promovimet, tribunat, takimet me krijues, orët letrare dhe veprimtaritë tjera bibliotekare.

9.1.7 Bashkëpunimi me institucionet tjera kulturore, shtëpitë botuese, shkollat dhe komunitetin, më qëllim të nxitjes së interesimit për librin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
9.1.8 Prezantimi i shërbimeve dhe veprimtarive të saj për publikun përmes ueb–faqes, katalogëve, fletushkave e formave tjera të informimit.
9.1.9 Përpilimi dhe botimi i publikimeve profesionale, si: katalogë, doracakë, fletëpalosje, revista etj., në pajtim me Ligjin për Bibliotekat.
9.1.10 Hartimi dhe propozimi i projekteve e programeve për zhvillimin e rrjetit bibliotekar të degëve që i mbikëqyrë.
9.1.11 Huazimi dhe këmbimi i materialeve bibliotekare për t'i përmbushë nevojat dhe kërkesat e shfrytëzuesve.
9.1.12 Mbledhja e informacioneve dhe materialeve të nevojshme brenda territorit të komunës, të cilat i ruan dhe i ofron në shërbim të përdoruesve.
9.1.13 Shfrytëzimi i literaturës së digjitalizuar, bazuar në teknologjinë e hapur.
9.1.14 Ushtrimi edhe i veprimtarive tjera, në pajtim me Ligjin dhe këtë Statut.

Neni 10

10.1 Shërbimet që u bëhen lexuesve janë me pagesë
10.2 Llojet e shërbimit me pagesë, tarifat për shërbime të veçanta, si dhe gjobat për moskthim të literaturës në afat apo për moskthim fare, miratohen nga Kuvendi i Komunës.

IV. ORGANET E BIBLIOTEKËS

Neni 11

11.1 Organet e Bibliotekës janë:
- Këshilli drejtues
- Drejtori
- Kolegjiumi profesional

Neni 12

Këshilli drejtues
12.1. Këshilli drejtues i bibliotekës përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, të cilët duhet t'i përkasin fushës së bibliotekarisë, kulturës ose arsimit. (Njeri nga ta te jete perfaqesues nga komuna.
12.2. Këshilli i Bibliotekës ka për detyrë të:

a) jep këshilla, mendime dhe sugjerime për organizimin, veprimtarinë dhe shërbimet bibliotekare;
b) mbron vlerat kulturore, në përputhje me Ligjin për biblioteka, Ligjin për institucionet e kulturës, këtë Statut dhe aktet të tjera; c) shqyrton planin dhe raportin e punës;
d) propozon ndryshimet në Statut dhe ndryshime të akteve tjera.

Neni 13

13.1 Drejtori i bibliotekës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

13.1.1. Është organ ekzekutiv i bibliotekës që udhëheq, organizon dhe mbikëqyrë veprimtarinë dhe funksionimin e Bibliotekës

13.1.2. Përfaqëson Bibliotekën brenda dhe jashtë vendit.

13.1.3. Harton dhe aprovon strategjitë dhe politikat zhvillimor të Bibliotekës.

13.1.4. Harton planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar të bibliotekës.

13.1.5. Për punën e tij i raporton dhe i përgjigjet Këshillit Drejtues

13.1.6. Organizon, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Bibliotekës.

13.1.7. Propozon politikat e zhvillimit të Bibliotekës dhe politikat për mbështetje financiare; organizon, mbikëqyr dhe motivon punën e personelit dhe jep udhëzime dhe urdhëresa për punë.

13.1.8. Paraqet raportet përkatëse për rezultatet e punës, ecurinë e shërbimeve dhe realizimin e buxhetit, përmes keshillit drejtues.

13.1.9. Përcjell problematikën e Bibliotekës dhe merr masa për zgjidhje më të mira.

13.1.10. Ushtron edhe detyra e autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet tjera që kanë të bëjnë me bibliotekat.

13.2. Drejtori i Bibliotekës zgjidhet me konkurs publik dhe duhet të plotesoi keto kushte:

13.2.1. Te ketë diplomë universitare;

13.2.2. Të ketë katër (4) vite përvojë pune profesionale;

13.2.3. Shkallë e lartë e njohurive në menaxhim, resurse humane dhe organizim të punës;

13.4 Mandati i drejtorit të bibliotekës është katër (4) vjeçar, me mundësi të vazhdimit edhe një mandat tjetër duke u bazuar ne përformancen e treguar, sipas vlerësimit të këshillit drejtues.

Neni 14

Kolegjiumin Profesional

14.1 Kolegjiumin profesional e përbëjnë anëtarët nga degët e Bibliotekës, dhe eshte organ këshillëdhënës i drejtorit të Bibliotekës:

14.2 Jep mendime profesionale lidhur me organizmin e punës dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarisë së Bibliotekës;

14.3 Jep propozime për aftësimin profesional të punëtorëve;

14.4 Bashkëvepron në përpilimin e punimeve profesionale, të cilat i boton Biblioteka.

14.5 Përbërja dhe organizimi i Kolegjiumit Profesional rregullohet me akt të veçantë, të cilin e nxjerr drejtori.

V. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Neni 15

15.1Veprimtarinë e vet Biblioteka e realizon përmes njësive organizative – sektorëve.
15.1.Sektorët e Bibliotekës janë:
15.1.1 Sektori i Hulumtimit dhe i Zhvillimit Bibliotekar;
15.1.1.2Sektori i Pasurimit dhe i Përpunimit të Koleksioneve;
15.1.1.3.Sektori i të Rriturve;
15.1.1.4 Sektori i Fëmijëve;
15.1.1.5Sektori i Periodikut me Sallë të Leximit;
15.1.1.6Sektori i Trashëgimisë dhe i Ruajtjes së Librit;
15.1.1.7Sektori i Punëve të Përbashkëta;
15.1.1.8Këndi Ndërkombëtar;
15.1.1.9Info – bibliobusi.
15.2.Puna e të gjitha degëve dhe sektorëve të Bibliotekës koordinohet mes veti, por edhe me sektorin përkatës të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe përmirësimit të metodës së punës për të dhënë efekte maksimale në fushën e edukimit dhe të argëtimit
15.3Biblioteka, në kuadër të saj, ka edhe degët brenda territorit të komunës ku vepron.
15.3.1 Biblioteka, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, mund të themelojë sektorë dhe degë të tjera sipas kërkesave, mundësive buxhetore dhe kritereve të përcaktuara me ligj.
15.3.2 Me aktin për organizim të brendshëm të Bibliotekës rregullohet organizimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive – degëve dhe sektorëve.

VI. PËRFAQËSIMI

Neni 16 Bibliotekën
e përfaqëson Drejtori i saj.

VII. FINANCIMI I BIBLIOTEKËS

Neni 17

17.1 Mjetet financiare për kryerjen e veprimtarisë Biblioteka i siguron nga:
17.1.1 buxheti i Komunës;
17.1.2 të ardhurat nga donacionet, fondacionet, OJQ – të e themeluara në Kosovë dhe jashtë saj,
17.1.3 shërbimet me pagesë,
17.1.4 burimet tjera të parapara me ligj dhe me akte tjera nënligjore.
17.2 Pagat për stafin dhe mjetet për investime kapitale, si dhe mjetet për mallra dhe shërbime menaxhohen nga Drejtori i Bibliotekës dhe Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport.

17.3 Financimi i projekteve artistike dhe shpenzimet komunale, në përputhje me planin buxhetor vjetor, derdhen në xhirollogarinë e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe menaxhohen nga drejtori i drejtorisë.
17.4 Menaxhimi i llogarisë se Bibliotekës bëhet nga drejtori i drejtorisë. Çdo transfer bankar nga xhirollogaria e Bibliotekës duhet të nënshkruhet në bankë nga drejtori i drejtorisë ose nga zyrtari i autorizuar nga drejtoria përkatëse për financa.

VIII. PLANI DHE RAPORTI I PUNËS

Neni 18

18.1 Drejtori i Bibliotekës harton planin e punës dhe raporton për punën e tij.
18.2 Plani i punës hartohet në pajtim me qëllimet për të cilat është themeluar ky institucion, si dhe me vëllimin dhe cilësinë e shërbimeve të kryera nga Biblioteka.

Neni 19

Plani i punës dhe raporti i punës për çdo vit kalendarik miratohet nga Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

IX. NJOFTIMI I PUNONJËSVE, TRANSPARENCA DHE SEKRETI ZYRTAR

Njoftimi i punonjësve

Neni 20

20.1 Njoftimi i punonjësve bëhet:

20.1.1 përmes publikimit të vendimeve të marra në tabelën e shpalljeve të Bibliotekës;

20.1.2 në bazë të kërkesës së secilit punonjës, në mënyrë që t'i jepen shënimet e kërkuara lidhur me realizimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tij.

Transparenca dhe sekreti zyrtar

Neni 21

21.1 Puna e Bibliotekës është transparente për publikun.
21.2 Transparenca për punën e Bibliotekës realizohet përmes:

21.2.1 organizimit të ekspozitave për prezantim;
21.2.2 bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat tjera në fushën e shkencës, të arsimit, të kulturës dhe
21.2.3 Ueb – faqes.

Neni 22

Drejtori i Bibliotekës është i autorizuar që të japë njoftim me shkrim dhe njoftim përmes shtypit, radios dhe TV – së për çështjet që kanë të bëjnë me punën e Bibliotekës. Neni 23

23.1 Sekret zyrtar në Bibliotekë është dokumentacioni dhe shënimet, transparenca e të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e Bibliotekës dhe të Komunës në përgjithësi.

23.2 Sekret zyrtar do të trajtohet dokumentacioni dhe shënimet që parashihen si të tilla me vendim të veçantë të kryetarit të Komunës, përkatësisht të Kuvendit të Komunës.

X. TE DREJTAT, OBLIGIMET DHE PERGJEGJESITE E PUNETOREVE

Neni 24

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve përcaktohen sipas Ligjit për Biblioteka, Ligjit për Institucionet e Kulturës, Ligjit të Zyrtarëve Publik, Ligjit të Punës, si dhe akteve nenligjore ne fuqi.

XI. AKTET E BIBLIOTEKËS

Neni 25

25.1 Në bazë të Ligjit për biblioteka, Ligjit per institucionet kulturore dhe Statutit të bibliotekës, drejtori i Bibliotekës nxjerr vendime në lidhje me fushveprimtarinë e bibliotekës

25.2 Aktet e cekura në pikën 1 të këtij neni duhet të nxirren në afat prej 6 muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

25.3 Aktet e miratuara publikohen në tabelën e shpalljeve të Bibliotekës.

XI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Nga dita kur hyn në fuqi ky Statut, pushojnë të vlejnë statutet dhe ndryshimet e tyre të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

Neni 27

Në rast se dispozitat e këtij Statuti janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Bibliotekat, përparësi kanë dispozitat e ligjit.

Neni 28

Ky Statut hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južne Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	**08.11.2024**
REFERENC-Ë:	02-030/01-0073426/24 dt 11.11.2024
PËR/ZA/TO:	**znj. Vesa BROJA, Kryesuese e Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës së Jugut**
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	**z. Bedri HAMZA – Kryetar i Komunës së Mityrovicës së Jugut**
NGA/OD/FROM:	**znj. Drita IBRAHIMI – Drejtore e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Kërkesë**

I/E nderuar,

Pas përfundimit të hartimit të Projekt – Planit Komunal për Përsona me Aftësi të Kufizuar ne Mitrovicën e Jugut nga ana e Komisionit dhe ekspertëve profesional e e ndihmuar nga OJQ-ja DOWN SYNDROM KOSOVA NE MITROVICË si dhe korigjimet pas sygjerimeve të OJQ-së Demokracia + ju prezanton Plan – Projektin e përfunduar ne fjalë.

Me respekt,

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

PLANI I VEPRIMIT

për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Mitrovicës së Jugut

2025 - 2027

_____/_____ 2024

Deklarata e kryetarit të komunës

Të nderuar qytetarë të komunës së Mitrovicës së Jugut,

Plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuar në komunën e Mitrovicës së Jugut, është kontribut i radhës për mbështetjen dhe fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara si dhe dëshmon përkushtimin institucional ndaj këtij grupi të qytetarëve, me qëllim të sigurimit të shërbimeve kualitative për të gjithë qytetarët.

Synim i komunës mbetet sigurimi i ndryshimeve pozitive në shoqëri përmes institucioneve prandaj komuna e Mitrovicës së Jugut vazhdon fuqizimin e kapaciteteve të saja vepruese përmes hartimit të këtij dokumenti strategjik për shërbimet, situatën dhe fushat e ndërhyrjes për periudhën tre vjeçare për personat me aftësi të kufizuar. Ky dokument strategjik do të shërbejë në promovimin e të drejtave, dinjitetin dhe mirëqenien e kësaj kategorie të qytetarëve në shoqëri.

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) duhet të përfshihen në të gjitha segmentet e shoqërisë si në atë ekonomik, politik, shoqëror dhe kulturor dhe pikërisht përmes këtij dokumenti komuna e Mitrovicës së Jugut do të dizajnoj mënyra për ndërhyrje dhe për të krijuar zgjidhje të qëndrueshme të sfidave të cilat hasen sot në procesin e përfshirjes së PAK në shoqëri.

Sigurimi i mbështetjes së plotë institucionale dhe pjesëmarrja aktive e PAK në jetën shoqërore dhe në zhvillim, promovim dhe avancim të drejtave të tyre, mbrojtja e dinjitetit dhe mbështetja për të pasur qasje të barabartë në punësim, arsim dhe shërbime janë dhe do të mbeten prioritetet e komunës. Veprimet e propozuara në këtë dokument, shprehin qartë hapat që do të ndërmerren me qëllim të përmbushjes së objektivave.

Me këtë rast, inkurajoj institucionet e qeverisjes lokale, përfaqësuesit e shoqërisë civile, komunitetin e bizneseve, komunitetin etnik dhe ndërkombëtar të bashkangjiten në nismen e zbatimit të këtij dokumenti strategjik dhe të punojmë së bashku me qëllim të ndërtimit të një qeverisje lokale e cila është në shërbim të qytetarëve.

Sinqerisht,

Bedri Hamza,
Kryetar i komunës së Mitrovicës së Jugut

Përmbajtja

Parathënie 5
Hyrje 6
Përcaktimi i Aftësisë së Kufizuar 6
Parimet Themelore 6
Parimi i së drejtës shoqërore, barazisë dhe mosdiskriminimit 6
Parimi i Vetëvendosjes 6
Parimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta 7
Parimi i Jetesës pa Barriera dhe Mjedisit të Lirë 7
Parimet e Identifikimit dhe Trajtimit të Hershëm 7
Parimi i Rehabilitimit 7
Parimi i Qëllimshmërisë 7
Përmbledhja 7
Plani i aktiviteteve 9

Shkurtesat

AMF	Ambulanca e Mjekësisë Familjare
DMS	Drejtoria e Mirëqenies Sociale
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DKRS	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DShPI	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë
DSh	Drejtoria e Shëndetësisë
DPU	Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizimit
FNVA	Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore
GP	Grupi Punues
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
KK	Kuvendi i Komunës
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
QPS	Qendra për Punë Sociale
QKMF	Qendra Kryesore e e Mjekësisë Familjare
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
SKPAK	Strategjia Komunale Për Persona me Aftësi të Kufizuara
ZBGj	Zyra për Barazi Gjinore
ZDNj	Zyra për të Drejta të Njeriut
ZL	Zyra Ligjore
ZK	Zyra e Kryetarit
OPAK	Organizatat për personat me aftësi të kufizura

Parathënie

Personat me aftësi të kufizuara (PAK), përbëjnë një numër të konsiderushëm të popoullsisë në komunën e Mitrovcës së Jugut. Ky grup i qytetarëve nuk kanë qasje në shërbime profesionale psiko-sociale dhe shëndetësore. Gjithashtu komuniteti i PAK, janë të diskriminuar në shfryëzimin e qasjes në hapësirat publike, përfshirë dhe objektet e institucioneve publike dhe të mirat e tjera që ofrohen nga komuna për qytetarët e saj. Në vitin 2013 është zhvilluar Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për një periudhë 10 vjeçare e cila ndër të tjerash parasheh edhe krijimin e planeve komunale për aftësinë e kufizuar. Mirëpo deri më tani, ky hap i rëndësishëm për PAK, nuk është ndërmarrë dhe komuna e Mitrovicës së Jugut ende nuk e ka zhvilluar planin e saj të veprimit për personat me aftësi të kufizuara, prandaj paraqitet problem në zhvillimin e aktiviteteve si dhe në buxhetimin adekuat për plotësimin e nevojave të këtij grupi të qytetarëve. Marrë në konsiderat nevojat dhe kërkesat e komunitetit të PAK, Shoqata Down Syndrome Kosova, ka iniciuar hartimin e këtij plani me vendim të kryetarit të komunës, z.Bedri Hamza. Komuna e Mitrovicës së Jugut, ka njohur faktin se mungesa e planit të aktiviteteve ka vështirësuar gjendjen e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, mungesa e bashkëpunimit të deritanishëm në mes të përfaqësuesëve të strukturave të komunës dhe përfaqësuesëve të personave me aftësi të kufizuara ka rezultuar në shtyrjen e përpilimit të planit të përbashkët të veprimit, i cili do të definoj mënyrat për të ofruar shërbime për të gjithë qytetarët pa pasur diskriminime të asnji lloji. Qasja e personave me aftësi të kufizuara në shërbime dhe të mira të tjera nuk mund të konsiderohen dytësore por të trajtohen me prioritet maksimal.

Plani i hartuar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara u mundëson PAK, të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në aktivitetet ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. Ky plan i veprimit për aftësinë e kufizuar ka një definicion të gjerë duke marrë parasysh përfshirjen e të gjitha kategorive të aftësisë së kufizuar si: intelektuale, fizike, dëgjimore dhe vizuale.

Hyrje

Plani i veprimit komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) në komunën e Mitrovicës së Jugut, është hartuar në përputhje dhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Nacionale Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013 - 2023 dhe të Planit të Veprimit Për Zbatimin e Strategjisë Nacionale Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013 – 2015.

Qëllimi i planit të veprimit, është gjithëpërfshirja, eliminimi i barrierave ekzistuese dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, përmes gëzimit të të drejtave bazë në arsim, shërbime cilësore shëndetësore dhe psiko-sociale dhe krijimin e kushteve për punësim.

Përcaktimi i Aftësisë së Kufizuar

Në përputhje me terminologjinë e Kombeve të Bashkuara, me konceptin e mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara si dhe në përputhje me kategorizimin ndërkombëtar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), termi "person me handikap" është zëvendësuar me termin "Person me Aftësi të Kufizuara" (individualisht) dhe "Persona me Aftësi të Kufizuara" (në nivel shoqëror).

Parimet Themelore

Ky dokument strategjik, për të gjitha palët e interesit, si ato të organizatave të shoqërisë civile ashtu edhe nga institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore, duhet të udhëhiqet nga parimet e përgjithshme të **<u>së drejtës për të qenë pjesë e shoqërisë kosovare</u>**. Janë gjithsej shtatë parime në bazë të së cilave është hartuar plani i veprimit për PAK për komunën e Mitrovicës së Jugut.

Parimi i së drejtës shoqërore, barazisë dhe mosdiskriminimit

Personat me aftësi të kufizuara janë anëtarë të barabartë të shoqërisë; ata mund të kërkojnë të njëjtat të drejta dhe të përfitojnë të njëjtën ndihmë sociale dhe Ilojet e asistencës si gjithë qytetarët e tjerë; ata nuk duhet të diskriminohen në asnjë fushë të jetës shoqërore. Tutje, ky parim promovon barazinë gjinore duke iu garantuar të drejtat të gjithë individëve pavarësisht aftësive dhe gjinisë, me qëllim të krijimit të kushteve që mundësojnë integrimin dhe pjesëmarrjen aktive të individëve me AK, duke marrë në konsideratë dhe dinemsionin gjinor duke iu përshtatur nevojave.

Parimi i Vetëvendosjes

Vjen nga përqasja me të drejtën shoqërore dhe nënkupton që mjedisi ku jetojnë personat me aftësi të kufizuara, duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që t'i inkurajojë ata të jetojnë një jetë të pavarur dhe të jenë në gjendje të vendosin vet. Vetëvendosja ka të bëjë gjithashtu me të drejtën për të menaxhuar lëvizjet, kohën dhe pasurinë individuale. Ky parim gjithashtu parashikon që çdo masë në lidhje me

rehabilitimin duhet të ndërmerret në bashkëpunim me personat me aftësi të kufizuar. Ai/ajo nuk duhet të trajtohet asnjëherë papëlqimin e tij/saj.

Parimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta

Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e shoqërisë ku ata jetojnë, prandaj nuk kanë pse të integrohen, sepse zotërojnë të njëjtat të drejta si njerëzit me zhvillim tipik. Ata kanë përfitime që i lejojnë të marrin pjesë plotësisht në të gjitha fushat e jetës shoqërore, ku përfshihet rehabilitimi mjekësor, pjesëmarrja në jetën në komunitet dhe në punë. Jetesa pa pengesa është një kusht i rëndësishëm për pjesëmarrje.

Parimi i Jetesës pa Barriera dhe Mjedisit të Lirë

Ndërtesat dhe shërbimet e tjera, mjetet e transportit, pajisjet teknike, sistemet e përpunimit të informacionit, burimet akustike dhe vizuale të shërbimeve informative dhe të komunikimit dhe mjediset e tjera të krijuara konsiderohen papengesa (pa barriera), nëse ato zakonisht përdoren nga personat me aftësi të kufizuar pa vështirësi të veçanta dhe si rregull pa ndihmën e të tjerëve.

Parimet e Identifikimit dhe Trajtimit të Hershëm

Ky parim ka të bëjë me identifikimin e rasteve që nga fëmijëria duke iu ofruar mbështetje profesionale përmes intervenimit të hershëm me shërbime cilësore shëndetësore dhe terapeutike.

Parimi i Rehabilitimit

Qëndron në bazë të procesit, i cili u siguron personave me aftësi të kufizuara mjetet dhe rrugët për një jetesë të pavarur. Ky parim, ka të bëjë me trajtimin e personit si tërësi me theks në aftësitë e tij/saj. Ndër të tjera, parimi i rehabilimit fokusohet tek rastet në mënyrë profesionale për qëllim të krijimit të kushteve të barabarta sociale, në edukim, arsim, rekreacion, punësim dhe kujdes familjar.

Parimi i Qëllimshmërisë

Parashikon ndihmën që duhet t'i ofrohet çdo personi me aftësi të kufizuar, pavarësisht nga aftësia e kufizuar, edhe nëse përgjegjësia për këtë ndihmë mbahet nga fondet e dhëna nga institucione të ndryshme.

Përmbledhja

Plani komunal i veprimit për aftësinë e kufizuar është dokument publik i rëndësishëm, i cili përshkruan konceptet se si komuna do t’i qaset diversitetit dhe gjithëpërfshirjes si dhe specifikon synimet dhe planet e saj për të eliminuar diskriminimin në raport me qytetarët me aftësi të kufizuara. Planet e veprimit të aftësisë së kufizuar njihen edhe si plane për “qasje dhe integrim” dhe i mundësojnë komunës

të arrijë një numër të qëllimeve. Ato i asistojnë komunës që të njoh më mirë nevojat dhe prioritetet e PAK. Planet e veprimit për PAK, minimizojnë mundësinë për të diskriminuar qytetarët në bazë të aftësisë së kufizuar si dhe fokusimin e shpenzimeve në fusha të rëndësisë së lartë duke klasifikuar prioritetet. Planet e veprimit për PAK, janë dokumente formale me kërkesa të veçanta të identifikuara nga vetë-qytetarët me aftësi të kufizuara si dhe me organizatat që përfaqësojnë grupe të ndryshme të qytetarëve me përfaqësuesit/et e personave me aftësi të kufizuara, të cilat bazohen në të drejtat e njeriut. Plani aktual i veprimit është rezultat i iniciativës të shoqatës Down Syndrome Kosova mbështetur nga UNICEF në partneritet me USAID. Gjatë hartimit të këtij plani kontribut të veçantë përveç shoqatës Down Syndrome Kosova kanë dhënë edhe pesë shoqata të tjera të shoqërisë civile si: Handikos Mitrovica, OPFAKos, Shoqata e të Verbëve, Shoqata e të Shurdhërve dhe Hendifer, të cilat merren me aftësinë e kufizuar dhe kanë konsistencë të qartë në misionin e tyre. Gjithashtu kontribut të rëndësishëm kanë dhënë dhe grupi i përfaqësuesve komunal i emëruar nga kryetari i komunës së Mitrovicës së Jugut. Ky grup, ka mbuluar drejtoritë relevante të komunës dhe ka dhënë kontribut në specifikimin dhe qartësimin e aktiviteteve. Për më shumë, komuna e Mitrovicës së Jugut, aktualisht ka në funksion komitetin konsultativ për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe për persona me aftësi të kufizuar të cilët do të rrisinë bashkëpunimin, koordinimin dhe monitorim e këtij dokumenti.

Plani i aktiviteteve

Objektiva	**1. Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe shërbimeve shëndetësore**								
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit			Indikatorët	Buxheti		
			2025	**2026**	**2027**		**2025**	**2026**	**2027**
1.1.Janë përmirësuar shërbimet terapeutike dhe mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara.	Kontraktimi i organizatave të licencuara për ofrim të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.	DMS DSH Donatorët	X	X	X	1.1.1 Numri i shërbimeve të kontraktuara	100,000.00	100,000.00	100,000.00
1.2.Janë monitoruar OJQ-të, e kontraktuara për cilësinë e shërbimeve të ofruara 1.3.Është krijuar sistemi mbikëqyrës dhe	Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve të ofruara nga OJQ-të, e kontraktuara	DMS DSH Donatorët	X	X	X	1.1.1. Numri i OJQ-ve, të kontrakuara 1.1.2. Raporti periodik për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga monitorimet e realizuara dhe matja e kënaqësisë së	1,000.00	1,000.00	1,000.00

raportues mbi zbatimin e planit për PAK						përdoruesve të shërbimeve			
	Krijimi dhe zbatimi i sistemit mbikëqyrës dhe raportues për zbatimin e planit për PAK	DMS DSH	X	X	X	1.3.1 Numri i takimeve të mbajtura 1.3.2. Publikimi i raportit të progresit	200	200	200
	Organizimi i fushatave vetëdijësuese mbi të drejtat e komunitetit PAK – njohja dhe respektimi i tyre	DMS ZDNJ	X	X	X	1.3.1 Numri i fushatave të realizuara dhe % e qytetarëve të informuara për shërbimet për PAK.	3,000.00	3,000.00	3,000.00
1.4.Janë liruar personat me aftësi të kufizuara nga tatimi në pronë.	Nxjerrja e vendimit për lirim të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, për tatim në pronë.	DSHPI	X	X	X	1.4.1. Numri i vendimeve të nxjerra			

1.5.Janë siguruar vizitat në shtëpi nga specialisti i mjekësisë familjare. 1.6.Janë krijuar kushtet për punë të organizatave të shoqërisë civile që punojnë me aftësi të kufizuara. 1.7.Janë siguruar shërbimet terapeutike për personat me aftësi të kufizuar.	Vizitat e rregullta nëpër familje të personave me aftësi të kufizuara.	DSH	X	X	X	1.5.1. Numri i familjeve të vizituara 1.5.2. Numri i vizitave në përgjithësi 1.5.3. Përmes instrumentit matës "anketës" do të matet cilësia e shërbimit nga përfituesit dhe familjarët e tyre	30,000.00	30,000.00	30,000.00
	Rregullimi i hapësirave të punës së organizatave të shoqërisë civile që punojnë me personat me aftësi të kufizuara.	DSHPI	X	X		1.6.1. Numri i organizatave përfituese nga rregullimi i hapësirave	50,000.00	50,000.00	
	Mbulimi i shpenzimeve komunale për OJQ-të që ofrojnë shërbime për persona me aftësi të kufizuara.	DSHPI	X	X	X	1.7.1. Numri i OJQ-ve përfituese nga mbulesa e shërbimeve komunale.	15,000.00	15,000.00	15,000.00

	Ngritja e vetëdijes së publikut dhe zyrtarëve për punësim të personave me aftësi të kufizuara.	Zyra e Kryetarit	X	X	X	1.7.2. Numri i trajnimeve të zyrtarëve	200	200	200

Objektiva	**2. Përmirësimi i gjithëpërfshirjes në jetën publike**								
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit			Indikatorët	Buxheti		
			2025	**2026**	**2027**		**2025**	**2026**	**2027**
2.1. Perceptimet dhe qëndrimet e komunitetit rreth personave me aftësi të kufizuara janë përmirësuar, dhe përfshirja e PAK në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike është rritur pas	Fushata vetëdijesuese për të ndryshuar perceptimet e komunitetit rreth personave me aftësi të kufizuar dhe për të promovuar përfshirjen e plotë të PAK në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike	Zyra e Kryetarit ZDNJ	X	X	X	2.1. Numri i fushatave të realizuara dhe % e qytetarëve të përfshirë	5,000.00	5.000.00	5,000.00

realizimit të fushatës vetëdijësuese									
2.2. Këshilli për PAK është formuar dhe ka filluar bashkëpunimin me komunën në hartimin dhe vlerësimin e politikave dhe planeve për personat me aftësi të kufizuara	Formimi i një këshilli për PAK që do të bashkëpunojë me komunën në hartimin dhe vlerësimin e politikave dhe planeve për këtë kategori	ZK ZDNJ DMS DSH	X	X	X	2.2. Numri i takimeve të këshillit dhe numri i rekomandimeve të propozuara dhe të implementuara			
2.3. Janë fuqizuar mekanizmat për identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuar.	Trajnimi i personelit mjekësor për identifikim të hershëm të aftësi së kufizuara.	DSH DKA	X	X	X	2.3.1. Numri i trajnimeve të mbajtura 2.3.2. Numri i personelit të trajnuar	450	450	450
2.4. Është krijuar databaza e integruar për personat me aftësi të kufizuara.	Krijim i databazës së integruar për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.	ZDNJ DKA QPS OSHC QMF				2.4.1. Numri i personave të përfshirë në databazë 2.4.1.1. Përqindja e burrave dhe grave që kanë akses në shërbime të caktuara (shëndetësore, edukative, punësimi) krahasuar me nivelin e mundësive për çdo gjini. 2.4.1.2. Në çfarë mase shërbimet e veçanta janë të disponueshme për gratë me	200	200	200

						aftësi të kufizuara, si dhe cilësia e shërbimeve të shëndetit riprodhues dhe mbështetjes emocionale për këtë grup.			
	Njoftimi i personave me aftësi të kufizuara për regjistrim në databazë.	ZDNJ OSHC DKA QPS	X	X	X	2.4.1.1. Numri i publikimeve Numri i klikimeve në publikime	200	200	200
	Azhurnimi periodik gjashtë-mujor i databazës.	ZDNJ	X	X	X	2.4.2. Numri i azhurnimeve			
2.5 Janë krijuar mekanizma lehtësues për gjithëpërfshirje në sistemin e rregullt arsimor.	Vlerësimi i fëmijëve me NVA, nga ekipa komunale pedagogjike	DKA	X	X	X	2.5.1Numri i fëmijëve të vlerësuar nga ekipa komunale pedagogjike 2.5.2 Raportet vlerësuese të fëmijëve të vlerësuar			
	Sigurimi i transportit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.	DKA	X	X	X	2.5.3 Numri i fëmijëve përfitues	10,000.00	10,000.00	10,000.00
	Punësimi i asistentëve – Profili asistent/e për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.	DKA	X	X	X	2.5.4. Numri i asistentëve të caktuar.			
	Angazhimi i mësuesve mbështetës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.	DKA	x	X	X	2.5.5 Numri i mësuesve mbështetës të angazhuar.	40,000.00	40,000.00	40,000.00
Objektiva	**3. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara.**								

Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit			Indikatorët	Buxheti		
			2025	**2026**	**2027**		**2025**	**2026**	**2027**
3.1. Janë krijuar dhe implementuar programe praktikash profesionale me pagesë për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në bashkëpunim me institucionet publike dhe bizneset lokale, duke ofruar mundësi punësimi afatshkurtra dhe përvojë pune	Krijimi i programeve të praktikave profesionale me pagesë në bashkëpunim me institucionet publike dhe bizneset lokale për të ofruar mundësi punësimi afatshkurtra dhe përvojë pune për PAK.	ZK DKRS DZHET	X	X	X	3.1. Numri i PAK të përfshirë në programe praktike dhe numri i vendeve të punës të krijuara pas përfundimit të praktikës	10,000.00	10,000.00	10,000.00
3.2.Është siguruar respektimi i kuotës për punësim të personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik	Inkurajimi i personave me aftësi të kufizuara për aplikim në konkurse të punës.	Zyra e Kryetarit	X	X	X	3.1.1Numri i publikimeve në mediat sociale 3.1.2 Numri i klikimeve në publikime 3.1.3. Numri i aplikimeve të PAK në konkurse publike	200	200	200
	Bashkëpunimi me shoqërinë civile për përpilim të kritereve të	Zyra e personelit	X	X	X	3.1.4Numri i kritereve të përpiluara			

	punësimit të personave me aftësi të kufizuara.								
	Krijimi i kushteve për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në QAP përmes trajnimeve profesionale	ZK QAP DMS OJQ	X	X	X	3.1.5. Numri i PAK të përfshirë në trajnime			
	Inkurajimi i personave me aftësi të kufizuara për regjistrim në qendrat regjionale për punësim.	OSHC	x	X	x	3.1.6Numri i publikimeve në mediat sociale 3.1.7 Numri i klikimeve në publikime	200	200	200
	Bashkëpunimi me bizneset vendore për punësim të personave me aftësi të kufizuara.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik / Zyra Regjionale e Punësimit	X	X	X	3.1.8Numri i bizneseve të kontaktuara 3.1.9 Numri i bizneseve që kanë punësuar persona me aftësi të kufizuar			
	Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (PAK) për bizneset, duke përfshirë informacione rreth	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik / Zyra Regjionale e Punësimit	X	X		3.1.10. Numri i udhëzuesve të shpërndarë	2,000.00	2,000.00	

	lehtësive, përfitimeve, dhe përgatitjes së vendeve të punës për PAK	dhe Zyra e Kryetarit							
	Subvencionimi i ngritjes së kapaciteteve profesionale të personave me aftësi të kufizuara.	DKRS / ZDNJ	x	X	x	3.1.11 Numri i personave me aftësi të kufizuar të përkrahur	9,000.00	12,000.00	12,000.00
	Subvencionimi i përgatitjes profesionale me punë praktike për personat me aftësi të kufizuara.	DMS	x	X	x	3.1.12 Numri i pozitave të punës të subvencionuara	9,000.00	12,000.00	12,000.00
	Ngritja e vetëdijes së publikut dhe zyrtarëve për punësim të personave me aftësi të kufizuara.	Zyra e Kryetarit	x	X	x	3.1.13 Numri i publikimeve në mediat sociale 3.1.14 Numri i klikimeve në publikime	200	200	200
Objektiva	3. **Sigurimi i qasjes dhe lirisë së lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara**								
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit			Indikatorët	Buxheti		
			2025	**2026**	**2027**		**2025**	**2026**	**2027**

3.1.Janë identifikuar objektet me pengesa në qasje.	Vlerësimi i objekteve publike me pengesa në qasje.	Drejtorati i Urbanizmit	X			4.1.1 Numri i objekteve të identifikuara			
	Rregullimi i qasjes në objektet publike.	DSHPI	x	X	x	4.1.2 Numri i objekteve ku është rregulluar qasja	30,000.00	30,000.00	30,000.00
	Rregullimi i qasjes (rampat, dyert, tualetet dhe trafik urban) në shkolla fillore dhe të mesme.	DSHPI / DKA	x	X	X	4.1.3 Numri i shkollave ku është rregulluar qasja	20,000.00	20,000.00	20,000.00
	Krijimi i një mekanizmi monitorimi për inspektimin dhe shqyrtimin e vazhdueshëm të objekteve publike për të siguruar që ato janë të përshtatshme dhe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara (PAK)	DSHPI	X	X	X	4.1.4. Numri i objekteve të vlerësuara			
3.2.Është mundësuar liria e lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara.	Lirimi i parkingjeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara.	Drejtorati i Urbanizmit Policia e Kosovës	x	X	x	4.2.1 Numri i parkingjeve të liruara			

	Subvencionimi për rregullimin e qasjes për familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara.	DMS	x	X	x	4.2.2. Numri i familjeve të subvencionuara	5,000.00	5,000.00	5,000.00
	Vendosja e sinjalistikës akustike në udhëkryqe në zona strategjike dhe me frekuentim të lartë për të siguruar efektshmëri.	DSHPI	x	X	X	4.2.3 Numri i udhëkryqeve ku është vendosur sinjalistika akustike	500	500	500
	Zgjidhja e problemit të shtyllave për pengim të parkimit të makinave.	DSHPI	x	X	X	4.2.4 Numri i shtyllave të larguara	??	??	??
	Vendosja e pllakave taktile në trotuare për mundësim të lëvizjes e lirë dhe orientimin e personave të verbër	Drejtorati i Urbanizmit / DSHPI	x	X	x	4.2.5 Metrat e trotuareve të rregulluara me pllaka taktile	??	??	??
	Ofrimi i programeve të dedikuara për aftësitë e jetës së pavarur për PAK si: kurse për orientim në hapësira publike dhe përdorimin e transportit publik	ZK DSHPI DMS	X	X		4.3.3 Numri i programeve të ofruara 4.3.4. Numri i pjesëmarrësve në program	5,000.00	5,000.00	
3.3.Është siguruar pjesëmarrja e përfaqësuesit të personave me aftësi të kufizuara në	Nxjerrja e vendimit për pjesëmarrjen e përfaqësuesit të zyrës për të drejtat e njeriut në komisionet për vlerësim dhe aprovim	Zyra e Kryetarit				4.3.1 Numri i vendimeve të nxjerra 4.3.2 Numri i takimeve ku ka marrë pjesë zyrtari për të drejtat e njeriut.			

komisionin për vlerësim dhe aprovim të projekteve.	të projekteve të komunës.								

Plani i veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në komunën e Mitrovicës së Jugut 2025-2027 është inicuar dhe realizuar nga Shoqata Down Syndrome Kosova, mbështetur nga UNICEF në partneritet me USAID, në kuadër të projektit "Fuqizimi i cilësisë së shërbimeve të integruara, efektive dhe të qëndrushme për fëmijët dhe adoleshentët aftësi të kufizuar intelektuale" që zbatohet nga Shoqata Down Syndrome Kosova.

Përmbajtja e këtij plani është përgjegjësi e Shoqatës Down Syndrome Kosova dhe OPAK, dhe nuk pasqyron pikëpamjet e UNICEF dhe USAID.

DOWN SYNDROME KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS-OPSTINA MITROVICA
16-030/01-0068428/24
16.10.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DREJTORIA PËR MIRËQENIE SOCIALE
Mitrovicë

NJOFTIM

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.3 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës neneve 17 paragrafi 1, 19 dhe 22 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 Për Administratë të hapur në Komuna; në nenin 25 dhe 26 të Statutit të Komunës; bazuar në Planin e veprimit për transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2023-2027, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Zyrën për Informim, Drejtoria e Mirëqenies Sociale ORGANIZON:

KONSULTIM PUBLIK
PËR
PLANIN E VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E MITROVICËS SË JUGUT

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultimin Publik për Planin e Veprimit për personat me aftësi te kufizuara në Mitrovicën e Jugut për vitet 2025-2027.

Konsultimi publik do të mbahet **të enjten më dt. 24.10.2024** në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 14.^{00}.

Njëkohësisht të gjithë qytetarët dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 15 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i bëjnë përmes ueb faqes së Komunës https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/, te Z. Nexhat Rushiti (zyrtar nga drejtoria) në e-mailin: nexhat.rushiti@rks-gov.net, ose drejtpërdrejtë në Zyrën pritëse dhe Zyrën Nr. 68 të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, ku edhe mund të merret Planin e Veprimit për personat me aftësi te kufizuara në Mitrovicën e Jugut për vitet 2025-2027.

Planin e Veprimit për personat me aftësi te kufizuar ne Mitrovicën e Jugut për vitet 2025-2027 po ashtu mund ta gjeni të publikuar në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke klikuar linkun: https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/category/shpalljet/njoftimet/.

Mitrovicë

Drejtoresha e Drejtorisë
së Mirëqenies Sociale

Drita IBRAHIMI

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	13.11.2024
REFERENCË:	02-110/05-0074119/24
PËR/ZA/TO:	**znj. Vesa BROJA – Kryesuese e Kuvendit të Komunës** **z. Bedri Hamza – Kryetar i Komunës**
CC:	**Anëtarët e kuvendit të komunës**
PËRMES/PREKO/THROUGH:	**Nazmi Jashari – Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit**
NGA/OD/FROM:	**Znj. Drita Ibrahimi – Kryetare e komisionit për hartimin e planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuar 2025-2027**
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	**Raport nga Konsultimi Publik për Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2025-2027**

Hyrje

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020 e komunës së Mitrovicës Juguore, neni 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullore (MAPL), Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës; neni 3 paragrafi 5, neni 6 dhe neni 7, paragrafi 1.3, të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standartet Miminale të Konsultimit Publik në Komuna dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve tjera gjatë procesit të politikë bërjes dhe vendimarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës Jugore, Grupi punes ka shpallur Konsultim Publik për Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2025-2027, për datë 24.10.2024, në sallën e kuvendit të komunës, duke filluar nga ora 14:00.

Ecuria e Procesit

Grupi punes në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në komuna ka publikuar Njoftimin për Konsultim Publik të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar në komunën e Mitrovicës së Jugut në ueb faqen e Komunës dy javë para mbajtjes së takimit në likun dhe në rrjtet sociale të komunës, po ashtu njoftimii është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës.

Njoftimi për konsultim public është shpallur në afatin e paraparë ligjor, respektivisht neni 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 Për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, duke u interesuar që të sigurohet njoftimi i plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me ftesën për konsultim publik, palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2025-2027, që ka qenë objekt i konsultimit public, shpjegime shtesë si dhe informata për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Metoda e Konsultimit	Datat/Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë	20
2. Publikimi në ueb faqe	14 ditë para mbajtjes së takimit kryesor	

Me planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2025-2027 në komunën e Mitrovicës së Jugut, synohet të rregullohet mirëqenia psiko-sociale e personave me aftësi të kufizuar, përfshirja, punësimi etj duke krijuar interesin më të mire për këtë grup të qytetarëve.

Pjesëmarrës në konsultimin publik ishin: grupi punues për hartimin e planit për PAK, Zyra për komunikim me Publikun dhe 20 pjesëmarrës.

Procesverbal nga Konsultimi Publik

20 pjesëmarrës të pranishëm

Drita Ibrahimi – drejtore e mirëqenies sociale: theksoj rëndësinë e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025-2027 në Mitrovicën e Jugut. Plani synon të sigurojë barazi dhe përfshirje për individët me aftësi të kufizuara, duke filluar nga familjet e tyre deri tek institucionet vendore. Në bashkëpunim me menaxherin e Qendrës së Down Syndrome Kosova, është bërë identifikimi i donatorëve për realizimin e këtij plani. Tutje, plani i veprimit për PAK është hartuar në mënyrë që të përfitojnë të gjithë personat me aftësi të kufizuara nga objektivat e caktuara.

Ju bëj thirrje për prindërit, familjarët dhe të gjithë ata që punojnë ngushtë me këta individë, të ofrojnë sugjerime dhe të ndajnë vështirësitë që hasin në përditshmërinë e tyre. Kjo do të ndihmojë në krijimin e zgjidhjeve efektive për nevojat e tyre. Në anën tjetër, komuna është e angazhuar në përmirësimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara, përmes subvencioneve, mundësive për punë praktike, rregullimit të infrastrukturës në shkolla dhe ofrimit të ndihmave të ndryshme. Këto nisma janë një hap i rëndësishëm drejt integrimit dhe mbështetjes së këtyre individëve në shoqëri.

Xhenis Beqiri: Menaxheri i Down Syndrome Kosova - Mitrovicë, ju falemnderit për kohën dhe përkushtimin tuaj për hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për komunitetin e aftësisë së kufizuar në Mitrovicë. Plani i veprimit është inicuar dhe hartuar nga Shoqata Down Syndrome Kosova, është mbështetur nga komuna e Mitrovicës, ndërsa financimi i aktiviteteve dhe hartimi i tij janë realizuar përmes fondeve të Bashkimit Evropian, konkretisht nga UNICEF. Për të u kthyer në retroperspektivë, gjatë vitit të kaluar, janë mbajtur takime me përfaqësues të komunës dhe organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, të cilat kanë kontribuar në identifikimin e prioriteteve dhe hartimin e planit.

Plani i veprimit për PAK, përmbanë katër objektiva kryesore:

1. Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe shërbimeve shëndetësore
2. Përmirësimi i gjithëpërfshirjes në jetën publike
3. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara
4. Sigurimi i qasjes dhe lirisë së lëvizjes për këta individë

Këto objektiva janë të përcaktuara për periudhën 2025-2027 dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara në Mitrovicë. Aktiviteti i parë në kuadër të Planit të Veprimit synon përmirësimin e shërbimeve terapeutike dhe mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara. Për realizimin e këtij qëllimi, pritet të kontraktohen organizatat e licencuara për ofrimin e shërbimeve për këtë grup të qytetarëve. Drejtoria e Mirëqenies Sociale do të jetë institucioni përgjegjës për implementimin e këtij aktiviteti.

Si aktivitet i dytë, është parashikuar lirimi i personave me aftësi të kufizuara nga tatimi në pronë. Ky proces do të menaxhohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës, e cila do të nxjerrë vendimin për lirim nga tatimi për të gjithë individët në këtë kategori.

Aktiviteti i tretë përfshin sigurimin e vizitave në shtëpi nga specialisti i mjekësisë familjare për ata persona me aftësi të kufizuara që nuk kanë mundësi të realizojnë kontrollet mjekësore në Qendrën e Mjekësisë Familjare (QKMF). Drejtoria e Shëndetësisë do të jetë bartës i këtij aktiviteti.

Për më tepër, një tjetër aktivitet do të fokusohet në krijimin e kushteve të përshtatshme për punën e organizatave të shoqërisë civile që punojnë me personat me aftësi të kufizuara. Ky aktivitet do të realizohet përmes rregullimit të hapësirave të punës për këto organizata, me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës si bartëse të këtij procesi.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me sigurimin e shërbimeve terapeutike për personat me aftësi të kufizuara, përmes mbulimit të shpenzimeve komunale për organizatat joqeveritare (OJQ) që ofrojnë këto shërbime. Në kuadër të shërbimeve komunale, parashikohet mbulimi i kostove për ujë, energji elektrike dhe tatime, duke marrë parasysh se organizatat e shoqërisë civile shpesh hasin vështirësi në përballimin e këtyre shpenzimeve. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës do të jetë bartëse e këtij aktiviteti.

Për të ngritur vetëdijen e publikut dhe zyrtarëve mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara, është vendosur që Zyra e Kryetarit të marrë përsipër këtë aktivitet. Kjo do të përfshijë iniciimin e dhe shpalljen e konkursve për punësimin e personave me aftësi të kufizuar në institucione.

Drejtoresha ekzekutive e **Handikos Mitrovica, znj. Myrvete Hasani**, theksoi se Spitali i Mitrovicës, veçanërisht repartin e fizioterapisë, ka kushte të mira për realizimin e terapisë fizikale. Megjithatë, ajo vuri në dukje se pritja për këto shërbime mund të arrijë deri në gjashtë muaj. Ajo propozoi organizimin e një takimi me spitalin, në mënyrë që disa nga terapitë fizikale të ofrohen drejtpërdrejt në repartin e fizioterapisë.

Gjithashtu, znj. Hasani theksoi rëndësinë e vizitave të vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në zonat rurale dhe që kanë vështirësi për të realizuar kontrollat mjekësore në spitale. Këto masa janë të domosdoshme për të siguruar mbështetje dhe kujdes të vazhdueshëm për këtë kategori të rëndësishme të shoqërisë.

Znj. Drita Ibrahimi, drejtore e mirëqenies sociale, theksoi se do t'i adresojë kërkesat e ngritura drejt Drejtorisë së Shëndetësisë dhe do të organizojë një takim për shqyrtimin e këtyre çështjeve.

Bekimi Ferati, kryetar i shoqatës së Verbërve Mitrovicë njoftoi se ekipa mjekësore ka realizuar tashmë vizita mjekësore në shtëpi për personat e verbër, duke kontribuar në përmirësimin e shërbimeve për këtë kategori.

Avni Kelmendi, Kryetar OPFAKOS Mitrovicë, shprehu shqetësimin e tij për pritjet e gjata në caktimin e termineve për terapi fizikale. Ai theksoi se, për shkak të numrit të madh të individëve që kërkojnë këto shërbime, pritjet për termine mund të zgjaten nga gjashtë muaj deri në një vit. Ai vlerësoi bashkëpunimin me Drejtorinë e Shëndetësisë, e cila ka realizuar kontrolle të përgjithshme stomatologjike për të gjithë anëtarët e shoqatës, por gjithashtu theksoi koston e lartë të shërbimeve të ofruara. Tutje, ai kërkoi që komuna të gjejë një zgjidhje për transportin e personave me aftësi të kufizuara, qoftë për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme apo për realizimin e kontrollave mjekësore. Sa i përket tatimit në pronë për personat me aftësi të kufizuara, ai sugjeroi që të shqyrtohet mundësia e krijimit të një autorizimi ose kompenzimi për familjet që kanë një anëtar me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ato të lirohen nga ky tatim. Për më tepër, z. Kelmendi, theksoi vështirësitë që hasin në parkingun e Shtëpisë së Shëndetit dhe kërkoi nga zyrtarët policorë të rrisin vetëdijen lidhur me parkimin në vendet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar që këto vende të mos zënë nga të tjerët. Këto masa janë të domosdoshme për të siguruar akses të lehtë dhe të barabartë për të gjithë individët me aftësi të kufizuara.

Koordinatorja gjeografike për Save the Children në Mitrovicë, Fahrije Kabashi, theksoi rëndësinë e kontraktimit të organizatave të licencuara për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale (DMS) si bartëse të këtij aktiviteti. Ajo sugjeroi që përgjegjësia duhet të ndahet gjithashtu me Drejtorinë e Shëndetësisë (DSH), e cila ka filluar tashmë blerjen e disa shërbimeve për javën rozë. Një objektivë e ardhshme është krijimi

i një ekipi që do të ofrojë terapia fizikale për individët që nuk kanë mundësi të shkojnë fizikisht në spital, duke përfshirë edhe angazhimin e HANDIKOS-it për realizimin e këtyre shërbimeve.

Znj. Myrvete Hasani theksoi se Handikos Mitrovica, ka një fizioterapeut të mbështetur nga DSH, megjithatë, nuk ka kushte të mjaftueshme për të realizuar të gjitha terapitë e nevojshme për të gjithë anëtarët e shoqatës.

Elfije Kelmendi, psikologe në Handikos Mitrovica, kërkoi shqyrtimin e mundësive për lirimin nga tatimi në pronë për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre.

Xhenis Beqiri vazhdoi me prezantimin e aktiviteteve për përmirësimin e gjithëpërfshirjes në jetën publike. Aktiviteti i parë përfshin trajnimin e personelit mjekësor për identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuar, trajnime këto që do të realizohen nga DSH. Qëllimi është që mjekët të trajtohen si pika referuese për organizatat që punojnë me këtë grup të qyetetarëve.

Fahrije Kabashi rekomandoi që në identifikimin e hershëm të personave me aftësi të kufizuar të përfshihet edhe Drejtoria Komunale të Arsimit, duke theksuar se identifikimi mund të bëhet edhe në institucionet parashkollore.

Xhenis Beqiri gjithashtu theksoi se aktualisht nuk ekziston një databazë që identifikon të gjithë personat me aftësi të kufizuara në komunën e Mitrovicës. Zyra për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të Drejtorisë së Administratës Publike, do të punojë në krijimin e një databaze të tillë duke u bazuar në këtë plan të hartuar.

Aktiviteti i radhës do të përfshijë sigurimin e transportit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, si dhe angazhimin e asistentëve dhe mësuesve mbështetës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Drejtoria Komunale e Arsimit do të jetë përgjegjëse për këtë iniciativë.

Objektiva e tretë, që ka të bëjë me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, është paraparë inkurajimi i këtij grupi për të aplikuar në konkurse pune dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile për hartimin e kritereve të punësimit. Kjo do të realizohet përmes Zyrës së Kryetarit dhe Zyrës së Personelit, duke inkurajuar gjithashtu anëtarët e OJQ-ve për regjistrim në qendrat regjionale për punësim. Për më tepër, do të krijohet një bashkëpunim me bizneset vendore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke ofruar kushte të tilla si lirim nga tatimi për bizneset që punësojnë këta individë. Bartës i këtij aktiviteti do të jetë Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Zyra Regjionale e Punësimit.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm do të fokusohet në subvencionimin e ngritjes së kapaciteteve profesionale për personat me aftësi të kufizuara, me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Departamentin për të Drejtat e Njeriut si bartës. Po ashtu, nga Zyra e Kryetarit do të kërkohet ngritja e vetëdijes së publikut dhe zyrtarëve për rëndësinë e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Myrvete Hasani, theksoi se qëllimi kryesor është që personat me aftësi të kufizuara të mos perceptohen si pacientë, por si individë që jetojnë një jetë normale dhe kontribuojnë në shoqëri.

Xhenis Beqiri: Objektivat e fundit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara përfshijnë sigurimin e qasjes dhe lirisë së lëvizjes për këtë grup. Aktivitetet që pritet të

ndërmerren për realizimin e këtyre objektivave përfshijnë vlerësimin e objekteve publike për pengesat në qasje, një proces që do të udhëhiqet nga Drejtoria e Urbanizmit.

Po ashtu, është paraparë rregullimi i qasjes në objektet publike nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës, si dhe realizimi i rregullimeve të nevojshme (rampat, dyert, tualetet dhe transporti urban) në shkollat fillore dhe të mesme, nga DSHPI dhe DKA.

Një tjetër iniciativë është shtimi i numrit të parkingjeve për personat me aftësi të kufizuara dhe lirimi i parkingjeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar, me Drejtoratin e Urbanizmit si bartës të këtij aktiviteti, si dhe vendosja e sinjalistikës akustike në udhëkryqe nga DSHPI.

Bekimi Ferati, theksoi se përveç mungesës së semaforëve akustikë për personat e verbër, gjithashtu mungon ecja e shkopit në brilla, një nevojë e rëndësishme për sigurinë e këtyre individëve.

Avni Kelmendi, sugjeroi që, gjatë pranim-nderhyrjeve për ndërtimin e shkollave nga Drejtoria e Urbanizmit, të kërkohet përfshirja e elementeve që lehtësojnë hyrjen dhe daljen e personave me aftësi të kufizuara.

Myrvete Hasani, kërkoi që këto sugjerime të shqyrtohen gjithashtu në ndërtimin e ndërtesave, duke u siguruar që të krijohet një pjerrinë më e përshtatshme dhe që dritat të vendosen në një lartësi të caktuar dhe të përshtatshme për nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Xhenis Beqiri: Të gjitha komentet dhe sugjerimet e dhëna do të inkorporohen në Planin e Veprimit, i cili do të përditësohet dhe shpërndahet me të gjithë pjesëmarrësit në takim. Këto nisma janë thelbësore për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Drita Ibrahimi: Plani i veprimit pas inkorporimit të komenteve, do të prezantohet në Asamblenën Komunale për votim, në muajin nëntor, 2024.

Xhenis Beqiri: Falemnderit për pjesëmarrjen dhe angazhimin tuaj në përmirësimin e mirëqenies sociale.

Më datë 5.11.2024 është pranuar email zyrtar nga Demokracia + OJQ nga Prishtina e cila ka ofruar disa rekomandime për përfshirjen e tyre në planin e veprimit PAK;

Objektiva e parë: **Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe shërbimeve shëndetësore**

Rekomandojmë të përmendet krijimi i një sistemi mbikëqyrës dhe raportues. Të mbahen takime periodike vjetore për vlerësimin e progresit, me përfshirjen e të gjitha palëve të interesit. Një raport publik që pasqyron progresin dhe sfidat do të siguronte transparencë dhe do të ndihmonte në identifikimin e fushave që kanë nevojë për përmirësim. – ***Aktiviteti është përfshirë***

Rekomandojmë që të formoni një këshill të përhershëm për PAK, që përfshin përfaqësues nga grupe të ndryshme të komunitetit, për të siguruar që zëri i tyre merret parasysh në vendimmarrje dhe në zbatimin e politikave. – ***aktiviteti tashmë gjen zbatim***

Të kjo pjesë e aktiviteteve rekomandojmë të shtohet ky aktivitet: Organizimi i një fushate ndërgjegjësimi që informon qytetarët dhe PAK për të drejtat e tyre, shërbimet që kanë në dispozicion dhe mundësitë për mbështetje institucionale. Si indikator për këtë aktivitet të shtohet: Numri i fushatave të realizuara dhe % e qytetarëve të informuar për shërbimet për PAK. – ***aktiviteti është përfshirë***

Rekomandojmë që disa indikatorë të formulohen në atë mënyrë që të jenë të bazuar në rezultate. Fokusi të jetë në indikatorë që matin ndikimin dhe rezultatet konkrete për mirëqenien dhe përfshirjen e PAK. Për shembull, në vend të vetëm "numrit të vizitave", matni gjithashtu "përmirësimin e cilësisë së jetës së familjeve të PAK pas vizitave". Shtoni anketime për të vlerësuar se sa janë të kënaqur PAK dhe familjet e tyre me shërbimet dhe aktivitetet. Kjo tregon nëse indikatorët po arrijnë qëllimin e tyre. Të rishikohen indikatorët çdo vit për tu siguruar që ato përputhen me objektivat dhe nevojat aktuale të PAK. Ky indikator të formulohet në atë mënyrë që shërben për të matur edhe ndikimin e vizitave në përmirësimin e mirëqenies së PAK. Rekomandojmë këtë formulim për këtë indikator: Numri i familjeve të vizituara dhe % e familjeve që raportojnë përmirësim në mirëqenie pas vizitave.– ***aktiviteti është përfshirë poashtu dhe indiaktorët e propozuar***

Përveç kontraktimit, sugjerojmë të bëhet një monitorim periodik i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga këto organizata për të garantuar që janë në përputhje me standardet. Gjithashtu, përfshini një indikator që mat kënaqësinë e PAK nga këto shërbime. – ***aktiviteti është përfshirë.***

Objektiva e dytë: **Përmirësimi i gjithëpërfshirjes në jetën publike**

Këtu rekomandojmë të shtohet ky aktivitet: Fushata vetëdijesuese për të ndryshuar perceptimet e komunitetit rreth personave me aftësi të kufizuar dhe për të promovuar përfshirjen e plotë të PAK në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike. – ***aktiviteti është përfshirë***

Me qëllim për të iu mundësuar PAK pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe ndikim në politikat dhe vendimet që ndikojnë në jetën e tyre, rekomandojmë të kjo pjesë të shtohet ky aktivitet: Formimi i një këshilli për PAK që do të bashkëpunojë me komunën në hartimin dhe vlerësimin e politikave dhe planeve për këtë kategori. Si indikator për këtë aktivitet është: Numri i takimeve të këshillit dhe numri i rekomandimeve të propozuara dhe të implementuara. – ***aktiviteti dhe indikatorët e propozuar janë përfshirë***

Për këtë aktiviteti Punësimi i asistentëve – Profili asistent/e për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. D+, ka propozuar: Në vend të një numri fiks asistentësh për shkollë, do të ishte më mirë të vlerësohen paraprakisht nevojat e secilit nxënës me aftësi të kufizuara për të përcaktuar numrin dhe llojin e asistencës që i duhet. Kjo do të ndihmojë në caktimin e asistentëve në mënyrë të drejtë dhe efektive, duke reduktuar mundësinë e mbingarkesës për një asistent. Një rekomandim konkret për vendosjen e numrit të asistentëve mund të ishte raporti **1 asistent për 1-3 nxënës** (në varësi të nevojave të tyre). Nëse një nxënës ka nevoja më intensive, një asistent i caktuar për të mund të jetë i domosdoshëm. Për nxënës me nevoja më të lehta, një asistent mund të kujdeset për 2-3 nxënës. – ***sugjerimi është përfshirë pjesërisht.***

Objektiva e tretë: **Punësimi i personave me aftësi të kufizuara**

Rekomandojmë këtë aktivitet të kjo pjesë: Krijimi i programeve të praktikave profesionale me pagesë në bashkëpunim me institucionet publike dhe bizneset lokale për të ofruar mundësi punësimi afatshkurtra dhe përvojë pune për PAK.Tregues për këtë aktivitet do të ishte: Numri i PAK të përfshirë në programe praktike dhe numri i vendeve të punës të krijuara pas përfundimit të praktikës. – ***aktiviteti është përfshirë poashtu dhe indikatorët***

Përveç inkurajimit, zhvilloni trajnime për zhvillimin e aftësive për kërkimin e punës, intervistat etj., për të ndihmuar PAK në procesin e aplikimit dhe përgatitjes për tregun e punës. ***Pjesërisht janë përfshirë***

Për të matur efektin e publikimeve shtoni këtu edhe këtë indikator: Numri i aplikimeve nga PAK në konkurse të punës pas publikimeve. – ***janë përfshirë këta indikatorë***

Ti kushtohet rëndësi informimit të komunitetit të biznesit rreth beneficioneve financiare në punësimin e PAK. Rekomandojmë të shtohet këtu: Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve për punësimin e PAK për bizneset, që përfshinë informata rreth lehtësive, përfitimeve, dhe përgatitjes së vendeve të punës për PAK. Për indikator: Numri i udhëzuesve të shpërndarë. – ***janë përfshirë***

Objektiva e katërt: **Sigurimi i qasjes dhe lirisë së lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara**

Në fund të kësaj pjese/objektive rekomandojmë të shtohet ky aktivitet: Krijimi i një mekanizmi monitorimi që inspekton/shqyrton vazhdimisht gjendjen e objekteve publike dhe të sigurojë që ato janë të përshtatshme për qasje nga PAK. Treguesi për këtë: Numri i inspektimeve të realizuara dhe % e ndërhyrjeve për përmirësimin e qasjes të raportuara çdo vit. ***Janë përfshirë***

Me qëllim për të rritur pavarësinë e personave me aftësi të kufizuara dhe për të ndihmuar në përfshirjen e tyre në shoqëri, duke ndjekur praktikat më të mira të vendeve tjera, sugjerojmë të shtohet këtu ky aktivitet: Programe të dedikuara për aftësitë e jetës së pavarur të PAK, siç janë kurse për orientimin në hapësirat publike dhe përdorimin e transportit publik. – ***është përfshirë rekomandimi***

Për këtë aktivitet D+ ka rekomanduar Vendosja e sinjalistikës akustike në udhëkryqe. – ***është përfshirë.***

Për këtë aktivitet D+ Vendosja e pllakave në trotuare për mundësim të lëvizjes së lirë për personat e verbër, Ky aktivitet rekomandojmë të formulohet kështu: Vendosja e pllakave taktile në trotuare për të mundësuar lëvizjen e lirë dhe orientimin e personave të verbër. ***Është përfshirë.***

Grupi punues e ka miratuar unanimisht planin e veprimit për PAK duke i përfshirë komentet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve.

Funded by the European Union

DOWN SYNDROME KOSOVA

unicef for every child

- Koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në kuadër të komunës;
- Zbatimin e politikave nacionale dhe lokale për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna
- Ofrimin e informacioneve përmes qendrës së informacionit, ku fëmijët dhe familjet në kuadër të komunës, mund të informohen apo të referohen tek shërbimet apo institucionet tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;
- Përcaktimin e së paku një (1) zyrtari përkatës përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës.

QPS-të në kuadër të fushëveprimit që ushtrojnë, kujdes të veçantë i kushtojnë kategorive të mëposhtme shoqërore përmes:

- Përkujdesjes dhe mbrotjes së fëmijëve pa kujdes prindëror,
- Mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjëve me nevoja të veçanta dhe të atyre në konflikt me ligjin,
- Mbrojtjes sociale të të rriturve me gjendje të nevojës sociale,
- Mbrojtjes së të rriturve me nevoja të veçanta,
- Mbrojtjes së të moshuarve pa kujdes familjar dhe pa mjete për jetesë,
- Punës së kujdestarisë dhe mbrojtjes së familjeve në realizimin e të drejtave juridike.

Asistenca sociale ndahet në dy kategori ku në to bëjnë pjesë një numër i madh i shfrytëzuesve të kësaj ndihme. Në kategorinë e parë si shfrytëzues së asistencës sociale bëjnë pjesë 1.314 familje me 5.297 anëtarë, kurse në kategorinë e dytë bëjnë pjesë 1.483 familje me 7.129 anëtarë.
QKS-ja e Mitrovicës së Jugut punëson gjithsej tetëmbëdhjetë punëtorë me orar të plotë në tri departamente:

- Shërbime sociale profesionale
- Skema e ndihmës sociale
- Administrata dhe financat

Më poshtë gjeni disa nga treguesit kryesor të shërbimeve sociale:

Tabela 6: Treguesit kryesorë të shërbimeve sociale në vitin 2023

Numri i popullsisë	71,909
Numri i personave mbi 60 vjeç e lart	7,461
Numri i personave që marrin pension bazë për të moshuarit në tremujorin e parë të vitit 2023	6,587
Numri i personave për të cilët burim kryesor i jetesës është ndihma sociale	5,842
Numri i familjeve që përfitojnë nga ndihma sociale në tremujorin e parë të vitit 2023	2,152
Numri i anëtarë të familjes që përfitojnë nga ndihma sociale në tremujorin e parë të vitit 2023	8,761
Numri i familjeve që marrin pension invalidor në tremujorin e parë të vitit 2023	1,296
Numri i familjeve në skemën e ndihmës për fëmijët me nevoja të veçanta në tremujorin e parë të vitit 2023	12
Numri i familjeve që përfitojnë pension për të pamurit e dobësuar në tremujorin e parë të vitit 2023	172
Buxheti vjetor i Qendrës për Punë Sociale	674,048.46
Numri i stafit të punësuar në Qendrën për Punë Sociale	18
Viti i themelimit të Qendrës për Punë Sociale	1964

Në kuadër të stafit të shërbimeve sociale në Komunën e Mitrovicës, nëntë punonjës punojnë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, nga të cilët shtatë janë të licensuar nga shteti.

Diagrami 1: Organogrami i Qendrës për Punë Sociale



182

QPS-ja ofron shërbime për të gjitha kategoritë e njerëzve në nevojë (të moshuar, persona me nevoja të veçanta duke përfshirë edhe fëmijët, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët në konflikt me ligjin, të mbijetuarit e dhunës në familje dhe të tjerët). Ndërsa, llojet e shërbimeve të ofruara nga QPS-ja në Mitrovicën e Jugut përfshijnë kujdestarinë, strehimin familjar, adoptimin, pajtimin familjar, kujdesin, strehimin në qendra komunitare, strehimin institucional, strehimin për viktimat e dhunës në familje, të trafikimit të qenieve njerëzore dhe krimeve seksuale. Vlen të theksohet se QPS-të ofrojnë edhe këshillime, mbrojtje dhe risocializim për fëmijët në konflikt me ligjin.
Në lidhje me kapacitetin e burimeve njerëzore për të ofruar shërbime, stafi është i trajnuar mirë dhe i përgatitur. Shumica prej tyre kanë mbi dhjetë vjet përvojë pune në këtë fushë dhe janë të licencuar, gjë që i bën ata në gjendje të ofrojnë shërbime cilësore për klientët e tyre. Megjithatë, për shkak të varfërisë së lartë dhe problemeve sociale në rajonin e Mitrovicës, numri i rasteve që punonjësit përballen tejkalon standardet minimale. Vlerësimet e paraqitura nga përfaqësuesit e QPS tregojnë se ata mund të plotësojnë rreth 40% të nevojave totale për shërbime sociale në Mitrovicën e Jugut. Sipas kategorisë së fëmijëve/personave në nevojë, QPS mund të ofrojnë sesione këshillimi, vizita familjare, referime dhe shërbime të ngjashme. Ato nuk janë në gjendje të sigurojnë shërbime afatgjate të rregullta si rehabilitimi, qendrat e kujdesit ditor për personat me nevoja të veçanta dhe vendosjet emergjente për fëmijët e keqtrajtuar.

QPS në Mitrovicën e Jugut përballet me sfida të mëdha, duke përfshirë mungesën e fondeve, mungesën e subvencioneve për ofruesit e shërbimeve dhe mungesën e burimeve njerëzore. Nga ana financiare, mungesa e një buxheti të dedikuar për shërbimet dhe mungesa e burimeve të tjera të të ardhurave kufizojnë kapacitetet e QPS-së për të ofruar shërbime të nevojshme. Në lidhje me burimet njerëzore, QPS-ja e Mitrovicës së Jugut nuk ka numrin e mjaftueshëm të ofruesve të shërbimeve sociale dhe gjithashtu ka nevojë për një psikolog dhe një staf pedagogjik. Vështirësitë më të mëdha hasen në ofrimin e shërbimeve për të moshuarit, viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët në konflikt me ligjin. Kapaciteti i strehimit për viktimat e dhunës në familje në Mitrovicën e Jugut nuk është i mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e komunitetit. Për sa i përket të moshuarve, QPS-ja zakonisht dërgon kërkesa tek Komuna e Prishtinës ose Skënderajit për të akomoduar të moshuarit në institucionet e tyre, por këto dy komuna rrallë mund të pranojnë një kërkesë të tillë për shkak të kapaciteteve të limituara. Gjithashtu, kapacitetet infrastrukturore janë të pamjaftueshme, me disa persona të vendosur në të njëjtin zyrë, që e vështirëson zbatimin e sesioneve të këshillimit, ndërsa mungesa e automjeteve pengon punën në terren. Për më tepër, objekti nuk është i përshtatshëm për qasje të lehtë për personat me nevoja të veçanta.

QPS e Mitrovicës së Jugut ka një bashkëpunim të ngushtë me disa Organizata Joqeveritare (OJQ) të nivelit kombëtar si SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijët, Terre des Homes, OFAP, dhe të tjerë. Megjithëse nuk ka memorandume të nënshkruara për partneritet në ofrimin e shërbimeve, partneritetet ekzistuese janë më shumë të fokusuara në ofrimin e mbështetjes për të përfituarit sesa në planifikimin e përbashkët për ofrimin e shërbimeve.

Më poshtë është paraqitur SWOT analiza e QPS-së ku kemi identifiku përparësitë dhe dobësitë, por edhe mundësitë dhe rreziqet me të cilat ballafaqohen shërbimet sociale dhe QPS e Mitrovicës Jugore:

(S) Anët e forta	**(W) Anët e dobëta**
Staf i kualifikuar dhe trajnuar Potenciali për përkrahjen e grupeve të margjinalizuara Fleksibilitet në ofrimin e shërbimeve Konsistencë e kapaciteve humane në avancimin e performances, llogaridhënjes dhe transparencës Koordinim i qëndrueshëm me hierarkinë horizontale dhe vertikale, sin ë nivel komunal ashtu edhe atë qendror	Mos adaptimi me risitë teknologjike - digjitalizimi Mungesë e mjeteve të avancuara për matje dhe vlerësim Ndikim i vogël në ndërtimin e politikave Varësi nga fondet e jashtme Rezistencë për ndryshim Kapacitetet e limituara të resurseve humane Qasshmëria e vështirësuar pas orarit të rregullt të punës, Mungesa e platformave online (e-qeverisja) Mungesa e ofrimit të e-shërbimeve për qytetarë Mungesa a kapaciteteve për hartim projektesh e iniciativash për donatorë e programe partneriteti
(O) Mundësitë	**(T) Kërcënimet**

Integrimi i mjeteve teknologjike
Avancimi me e-qeverisje dhe transformim digjital
Zhvillimi i platformave online
Promovimi përmes mediave dhe kanaleve sociale
Bashkëpunimet dhe partneritetet
Fuqizimi dhe angazhimi në komunitet
Trajnimet sistematike të stafit të ofruara nga MFPT/MD
Krijim i Lehtësirave për managjim të platformave, sistemeve e databazave,
Ngritja e kapaciteteve për hartim të concept propozimeve, iniciativave dhe partneriteteve

Niveli jo i kënaqshëm i shërbimeve të integruara për grupet e cenuara
Kapacitetet humane dhe materiale të limituara nga sektori i shërbimeve sociale
Niveli jo i kënaqshëm i shërbimeve të balancuara ndaj personave me nevoja të veçanta, grupeve të cënuara për grupet e cenuara
Mungesa e qendrave strehuese, rehabilituese, rekreative, sociale
Niveli jo i kënaqshëm i digjitalizimit, shërbimeve online dhe telemjekësisë
Mungesa e pilotimit të e-shërbimeve, telemjekësisë dhe digjitalizimit të shërbimeve

NIVELI QENDROR

Departmenti për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF) në MFPT ka detyrën e zhvillimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive, legjislacionit, monitorimit dhe zbatimit të standardeve në fushën e politikave sociale dhe të familjes. Përveç kësaj, ata janë përgjegjës për adresimin e kërkesave për licensime, administrimin e skemave të beneficioneve dhe zhvillimin e analizave në fushën e politikave sociale dhe të shërbimeve familjare.
Divizioni i Shërbimeve Sociale dhe Familjare (DSHSF) brenda MD, ka detyrën për të ruajtur, monitoruar dhe zbatuar standardet profesionale dhe disiplinore në fushën e shërbimeve sociale dhe të familjes, duke përfshirë licensimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale dhe të familjes. Pas decentralizimit në vitin 2009, shërbimet sociale dhe të familjes në përgjithësi ofrohen nga 40 QPS, të cilat operojnë në të gjitha 38 komunat e vendit. Këto institucione vendore kanë përgjegjësi për administrimin e Skemës së Ndihmës Sociale të Kosovës. Një numër i shërbimeve sociale ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile, të njohura si OJQ-të sociale, duke përdorur modele bashkëpunimi për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.
Një gamë shtesë shërbimesh sociale dhe familjare mbeten nën përgjegjësinë e MFPT/MD, duke përfshirë:

- shërbimet rezidenciale,
- shërbimet komunitare,
- shërbimet në shtëpi për të përfituarit,
- qendrat e kujdesit ditor për personat e moshuar dhe ata me nevoja të veçanta (për të dy gjinitë),
- si dhe shërbimet për viktima të dhunës familjare.

Gradualisht këto shërbime transferohen në përgjegjësinë e niveleve lokale. Procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare ishte planifikuar të përfundojë në vitin 2015, megjithatë sfidat e ndryshme kanë ngadalësuar procesin dhe transferimin e plotë në nivelin komunal.
Si në nivelin qendror (nëpërmjet MFPT/MD) ashtu edhe në nivelin lokal (nëpërmjet komunave), janë bërë hapa të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë së ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare përmes krijimit të partneriteteve midis institucioneve qeveritare, OJQ-ve dhe Ndërmarrjeve Sociale.

BAZA LIGJORE E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

I vetmi opsion që garanton adresimin e problemeve të identifikuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare është adresimi me ndryshime ligjore, meqë shkaku kryesor i problemeve të identifikuara janë dispozitat ligjore që krijojnë efekte në këtë sistem.
Më poshtë paraqesim një përmbledhje dhe analizë të legjislacionit bazë që rregullon çështjet e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë.

LIGJI NR. 02/L-17 PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Ky Ligj ka si qëllim të përcaktojë dhe rregullojë ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat dhe familjet në nevojë në Kosovë. Gjithashtu, ky ligj rregullon shërbimet për fëmijët dhe familjet, duke i kushtuar rëndësi të veçantë interesit më të mirë të fëmijës, si në aspektin e kujdesit direkt dhe punës me ta, ashtu edhe në aspektin e marrjes së vendimeve për fëmijën. Për shërbimet sociale dhe familjare ky ligj rregullon edhe shërbimet për të rriturit. Më bashkëpunim me familjet, komunitetet, organizatat joqeveritare dhe organet e tjera të parashikuara me ligj, komuna ofron kujdes social, këshillim dhe, në raste të veçanta, ndihmë materiale për njerëzit që kanë nevojë për shërbime sociale dhe jetojnë në territorin e saj.
Mbrojtja e të rriturve në rrezik me këtë ligj zbatohet kur ka dëshmi që një i rritur nuk është në gjendje të kujdeset për veten për shkak të aftësive të kufizuara mendore ose është i braktisur, i shfrytëzuar ose i abuzuar nga të tjerët për shkak të moshës, dobësisë ose aftësive të kufizuara fizike dhe mendore.

LIGJI NR. 04/L-081 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-17 PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Ligji i ndryshuar përveç ndryshimeve në përkufizime dhe riformulimeve të disa prej neneve të Ligjit nr.02/L-17 në kuadër të nenit 11 të ligjit paraprak për Mbrojtjen e fëmijëve në rrezik shtoj dhe nenet 11.A që trajton mbrojtjen e fëmijëve kryerës të veprave penale, pa përgjegjësi penale dhe nenin 11.B që trajton mbrojten dhe trajtimin e fëmijëve me sjellje asociale.

LIGJI Nr. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS

Ky Ligj rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare. Gjithashtu, ligji parasheh kujdestarinë për fëmijët e mitur që të gëzojnë mbrojtje të veçantë nga institucionet publike, për moshat madhore që të sigurojnë jetë të pavarur dhe mbrojtje të personalitetit të tyre, dhe personave nën përkujdesje për sigurimin e të drejtave pasurore.

LIGJI Nr.06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJÊS

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga qfardo lloj keqtrajtimi si fizik dhe mendor, abuzime keqpërdorim , shfrytëzim neglizhencë apo ndonjë formë tjetër që ekspozon, fëmijën në rrezik, jetën, shëndetin, arsimin edukimin dhe zhvillimin normal që në të ardhmen të bëjë jetë të pavarur për të dhe familjen.

LIGJI Nr. . 08/L-185 PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE

Rrjedhimisht duke kontribuar në bazë të këtij legjuislacioni për parandalimin e djunës në familje dhe dhunës në baza gjinore kontribuohet në mirëqenien e fëmijve spse dihet mirëfilli se çdo lloj dhune në familje të dëmtuarit më të mdhënj ose dëmin më të m,adh si pasojë e dhunës në familje e përjetojnë fëmijët .

LIGJI Nr.03/L-040 PËR VETËQEVERISJE LOKALE

Ky Ligj vendos bazën ligjore për të siguruar një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Ligji përcakton statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet themelore të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e institucioneve komunale, marrëdhëniet brenda komunave dhe bashkëpunimin ndërkufitar, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet mes komunave dhe pushtetit qendror. Në lidhje me shërbimet sociale dhe familjare ligji përcakton ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, si përkujdesi për personat në nevojë, strehimi familjar, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të fushës së mirëqenies sociale.

LIGJI NR.03/l-049 PËR FINANCA I PUSHTETIT LOKAL

Ky ligj përcakton burimet financiare që janë në dispozicion të komunave në Kosovë, duke përfshirë të ardhurat vetanake komunale, grantet dhe burimet financiare të tjera të nevojshme për të ushtruar kompetencat komunale. Në kontekstin e kompetencave vetanake, ku përfshihet edhe ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, ligji thotë: Parimi i pavarësisë financiare të komunave do të zbatohet në mënyrë që financimi dhe ushtrimi i kompetencave vetanake komunale të kryhen për të mirën e popullsisë së komunës dhe në përputhje me standardet dhe kushtet e aplikueshme të përcaktuara për këto kompetenca me ligj. Të gjitha të ardhurat e mbledhura ose të pranuara nga komuna në bazë të autorizimit nga ligji, nga burimet në vijim, konsiderohen si të hyra vetanake të komunës: a) taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna, si dhe detyrimet rregulluese dhe gjobat e autorizuara në bazë të këtij ligji. Ky ligj parashikon një burim tjetër financimi për këto shërbime (Granti i Përgjithshëm). Komunat kanë të drejtë të pranojnë një Grant të Përgjithshëm që mund ta shfrytëzojnë për të ushtruar kompetencat e tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

LIGJI NR. 2003/15 PËR SKEMËN SOCIALE DHE LIGJI NR. 04/L-096 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E SKEMËS SË NDIHMËS SOCIALE

Ligji nr. 2003/15 për Skemën Sociale në Kosovë, ka hyrë në fuqi ne vitin 2003. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurohet rrjeti i sigurisë sociale në kuadrin e gjërë të mbrojtjes sociale në Kosovë dhe të lehtësohet varfëria me anë të ndihmave sociale për të varfrit dhe familjet nevojtare. Me këtë ligj rregullohet skema e ndihmës sociale në Kosovë me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesit të familjeve të rrezikuara në aspektin social. Me hyrjen në fuqi te Ligji Nr. 04/L – 096, per plotesimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/15 per skemen e ndihmes sociale ne Kosovë, numri i familjeve dhe anëtarëve përfitues kishte rënie, veçanërisht në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së kategorisë së II-të, përkundër faktit se parametrat e varfërisë dhe papunësisë nuk tregojnë rezultate të përmirësimit. Një ndër vështirësit kryesore me të cilën perballet aktualisht Kosova sa i përket infrastruktures aktuale ligjore eshte ndikimi shume i kufizuar i ndihmës së skemës sociale në uljen e varfërisë në Kosovë e që rrjedhimisht është qëllimi kryesor, kriteret përjashtuese të përzgjedhjes, veçanërisht për Kategorinë II, që familja të ketë së paku një fëmijë nën moshën 5 vjeç dhe vetëm një anëtar të familjes të aftë për punë dhe të regjistruar si i/e papunë, të cilat përjashtojnë shumë familje të varfra nga mundësia e përfitimit nga SNS-ja. Këto dy kritere po ashtu shkaktojnë probleme në zbatim të kornizës ligjore sepse shumë familje nga Kategoria II e përfituesve detyrohen të ndërrojnë statusin e anëtarëve të familjes për të kaluar në Kategorinë I pasi fëmija i vogël të arrijë moshën 5 vjeçare dhe/apo

të mos punojnë ose të punojnë në ekonominë joformale për të mos e humbur të drejtën në përfitim kur fëmija i madh në familje të arrijë moshën 18 vjeçare. Gjithashtu, testi i varfërisë nuk është në përputhje me profilin e varfërisë në Kosovë apo me nevojat e të varfërve, që ndikon në kufizim të mbulueshmërisë dhe lë shumë familje të varfra jashtë skemës. Shuma mujore e SNS-së bie proporcionalisht në vlerë me rritje të familjes, duke pamundësuar mbulimin e nevojave bazike të ushqyeshmërisë sidomos për këto familje. Vlera e ulët e pakos së lirimeve, shërbimeve, dhe përfitimeve tjera në të cilat kanë të drejtë përfituesit e SNS-së në kombinim me shumën e ulët mujore nuk janë të mjaftueshme të ngrisin familjet përfituese mbi kufirin e varfërisë.

LIGJI NR. 03/l-022 PËR PËRKRAHJE MATERIALE FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR TË PËRHERSHME

Me këtë ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilat ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me nevoja të veçanta të përhershme dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahje materiale. Kjo përkrahje u takon fëmijëve me nevoja të veçanta të përhershme të moshës 1 – 18 vjeçare, që janë banor të Republikës së Kosovës dhe janë me nevoja të veçanta të përhershme që në mënyrë të pavarur të lëvizin dhe t'I kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore, ku për këta persona është I nevojshëm kujdesi I huaj prej 24 orëve. Në rast të nevojës për ekspertizë, është QPS që zhvillon procedurën për njohjen e ndihmës materiale për familjen me fëmijë me nevoja të veçanta të përhershme. Në përputhje me ligjin e Republikës së Kosovës, ministria garanton fshehtësinë e informatave personale, ndërsa familja përkujdesëse është e obliguar të lajmërojë DMS-në apo QPS-në si monitorues të realizimit të kësaj të drejte ne lidhje me ndryshimet potenciale.

AKTET E TJERA NËNLIGJORE DHE JURIDIKE

(UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 01/2011 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PAS BARTJES SË PËRGJEGJËSIVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE NË NIVELIN KOMUNAL)

Me këtë Udhëzim Administrativ (UA) nr. 01/2011 përcaktohen procedurat për zbatimin e legjislacionit për shërbimet sociale dhe familjare në nivelin komunal në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Ky UA përcakton procedurat e transferimit të përgjegjësive nga nivel qendror në nivelin komunal. Ai përmban detyrimet e MFPT/MD-së lidhur me shërbimet sociale dhe familjare, si dhe detyrimet e komunës në lidhje me këto shërbime, në përputhje me Ligjin nr. 02/L-17. Procedurat e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve sociale janë të përshkruara në nenin 7 të këtij udhëzimi administrativ, ndërsa procedurat e inicijuara nga Qendrat për Punë Sociale për realizimin e shërbimeve sociale janë të përshkruara në nenin 8. Në procedurat e veçanta për përkujdesjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, përcaktohen përgjegjësitë e Qendrave për Punë Sociale, roli i tyre, dhe format alternative që duhet të zbatohen në këto raste, gjithmonë në përputhje me Ligjin nr. 02/L-17. Në nenin 10, "mbi mbrojtjen e viktimave të dhunës seksuale, trafikimit dhe krimeve seksuale", ky udhëzim obligon Qendrat për Punë Sociale të zbatojnë Procedurat Standarde të Veprimit për të siguruar mirëqenien e qytetarit, duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi. Përfundimisht, ky UA përfshin procedurat për ndihmën e familjeve me fëmijë me nevoja të veçanta, si dhe për mbrojtjen e personave të moshuar dhe personave me nevoja të veçanta.

PLANI MATRICOR PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

Ngritja e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe rritjes së cilësisë së mbrojtjes sociale, arritjes së barazisë gjinore dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare me një fokus të veçantë në grupet e cenueshme dhe barazinë gjinore. Komuna e Mitrovicës Jugore bazuar në detyrat dhe përgjegjësit e saj, përmes Drejtorisë së Mirëqenies Sociale ka përcaktuar objektivat primare të planit të veprimit për shërbimeve sociale dhe familare sikurse në vijim:

PRIORITETI I: Ofrimi i shërbimeve dhe përkrahjes për rrjetin e kujdesit social bazuar në nevojat e fëmijëve, rinisë, grave e moshave të shtyera dhe grupeve të cenuara, i fokusuar në zhvillimin dhe fuqizimin e familjes, komunitetit dhe kulturës së mirëqenies:

Objektivi 1.1: Implementimi i shërbimit të kujdesit social, edukative vetëdijësues për fëmijë dhe mosha rinore, përfshirja e asamblesë së fëmijëve ,grupi avokues i fëmijëve me aftësi të kufizuara ,,Hëna ' ,Ekipi për të drejtat e fëmijëve i dal nga Ligji për mbrojtjen e fëmijëve .

Objektivi 1.2: Zhvillimi i programeve të udhëhequra nga sektori i shërbimeve sociale komunale, bashkë me partner dhe rrjete për të përkrahur kujdesin emergjent, dhe shërbimin e specializuar afatgjatë të kujdesit social, si dhe monitorimin e raportimin.

Objektivi 1.3: Vazhdimi i implementimit të aktiviteteve e shërbimeve post-monitorim, për të siguruar kualitet dhe qëndrueshmëri të përkrahjes dhe shërbimeve.

PRIORITETI II: Avancimi i kapaciteteve, promvimi i telemjekësisë, digjitalizimi i shërbimeve dhe zhvillimi i platformave:

Objektivi 2.1: Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve njerëzore, materiale dhe infrastrukturore duke përfshirë sinjalistikën krijimi i hapësirës miqësore si dhe respektimi i UA – 33/2007 për kushtet teknike te objektivave ndertimore që përfshirë toaletet e qasshme për nevojat e personave me aftësi të kufizuara .

Objektivi 2.2: Tranformimi digjital i shëbimeve sociale dhe shërbimeve online mundësia e hapjes së një vebfaqe të QPS-së si shumë e nevojshme për promovimin e shërbimeve që ofron ky institucion

Objektivi 2.3: Promovimi i Telemjekësisë përmes shërbimit këshillues e informues

PRIORITETI III: Avancimi i mundësive për partneritete dhe bashkëpunimeve me nivel qendror institucional, donatorë, partner dhe komunitetin e biznesit, diasporës dhe programeve tjera sektoriale:

Objektivi 3.1: Nxitja zotuese e bashkëpunimeve, partneriteteve dhe ndërlidhjeve

Objektivi 3.2: Zhvillimi I kapaciteteve dhe ngritja institucionale për bashkëpunime të avancuara

Objektivi 3.3: Infrastrukturë sociale mbështetëse partneriteti

PRIORITETI IV: Ofrimi i resurseve dhe mjeteve si dhe mbështetja sociale për fëmijët dhe të rinjt për tranzicion të suksesshëm rinor dhe zhvillim:

Objektivi 4.1: Përkrahja e fëmijëve dhe të rinjve në tranzicionin e suksesshëm në moshën madhore dhe shërbimet përkatëse (pas mbështetjes institucionale)

Objektivi 4.2: Zhvillimi dhe implementimi i fushatave vetëdijësuese dhe promovuese për tranzicionin e shëndetshëm të pjekurisë dhe zhvillim të profileve për moshat e rritura

Objektivi 4.3: Strehimi familjar – forma alternative e përkujdesjes për fëmijët pa kujdes prindëror

Shërbimet Sociale dhe Familjare		Ndërlidhja me Plane Tjera			GJITHPËRFSHIRJA JONË–Plan-Veprimi Komunal i Shërbimeve Sociale & Familjare			
PRIORITETI I		AKTIVITETI	INSTITUCIONI DREJTUES	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	HISEDARËT NË AKTIVITETE	BUXHETI	PLANI KOHOR	IMPLEMENTUESI
Ofrimi i shërbimeve dhe përkrahjes për rrjetin e kujdesit social bazuar në nevojat e fëmijëved, rinisë, grave e moshave të shtyera dhe gruopeve të cënuara, i fokusuar në zhvillimin dhe fuqizimin e familjes, komunitetit dhe kulturës së mirëqenies	*Obj 1.1:* Implementimi i shërbimit të kujdesit social, edukative vetëdijësues për fëmijë dhe mosha rinore, përfshirja e asamblesë së fëmijëve ,grupi avokues i fëmijëve me aftësi të kufizuara ,,Hëna ' ,Ekipi për të drejtat e fëmijëve i dal nga Ligji për mbrojtjen e fëmijëve	Akt 1.1.1 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara	QPS	Ministria e drejtësisë /DSHSF (Departamenti per sherbime socioale dhe familjare)	OJQ për veprimarinë adekuate	(Buxhetin e posedon ministria) /vit		DMS
		Akt 1.1.2 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët ne konflikt me ligjin	QPS	Policia, PTHK, GJTHK, Shërbimi Sprovues - MD	OJQ, Strehimoret, KOMF, Prindërit, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë			DMS
		Akt 1.1.3 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët e përfshirë ne martesa te hershme organizatat që në fokus kanë fuqizimin e komuniteteve jo shumicë siq është Komitetit për Komunitete si dhe preventiva	QPS	GHTH, Policia, Shëndetësia	OJQ, Strehimoret, Prindërit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Arsimit			DMS
		Akt 1.1.4 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët e ekspozuar ndaj abuzimit, braktisjes apo shfrytëzimit	QPS	GJTH, PTHP, Policia Arsimi, Shëndetësia, Njësia për të drejtat e njeriut	OJQ, Strehimoret, Familjet Strehuese, TdH, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Arsimit	Me diskutu me Driten per secilin aktivitet		DMS
		Akt 1.1.5 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët me sjellje asociale	QPS	GJTH, PTHP, Policia, Shëndetësia	OJQ, Strehimoret, Arsimi, Familjet Strehuese, TdH, Prindërit/kujdestari			DMS
		Akt. 1.1.6 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët në situatë rruge (fëmijët që punojnë dhe lëmosh kërkues)	QPS	GJTH, PTHP, Policia, Shëndetësia	OJQ, Strehimoret, Arsimi, Familjet Strehuese, TdH, Prindërit/kujdestari			DMS
		Akt. 1.1.7 Ofrimi i shërbimeve për të rinjët që abuzojnë substanca narkotike dhe familjet e tyre	QPS	GJTH, PTHP, Policia, Arsimi, Shëndetësi	OJQ, Strehimoret, Arsimi, Familjet Strehuese, KOMF, TdH, DKRS			DMS

Treguesit	Të dhënat aktuale - 2023	Rezultati i Synuar - 2024	Rezultati i Aktual - 2024	Rezultati i Synuar -2025	Rezultati i Aktual -2025	Rezultati i Synuar -2026	Rezultati i Aktual -2026
Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që marrin shërbime sociale	182	200	200	215	210	220	215
Numri i fëmijëve ne konflikt me ligjin që marrin shërbime sociale	81	30	15	110	115	120	115

	Numri i fëmijëve të përfshirë në martesa të hershme që marrin shërbime sociale	0	0	0		5	5	7	7
	Numri i fëmijëve të ekspozuar ndaj abuzimit, braktisjes apo shfrytëzimit që marrin shërbime sociale	0	0	0		5	5	6	6
	Numri i fëmijëve me sjellje asociale që marrin këshillime e asistencë sociale	24	5	4		30	30	35	35
	Numri i fëmijëve lëmoshë-kërkues rrugë që marrin këshilime, e trajtim social	0	3	2		5	5	5	5
	Numri i të rinjve abuzues me substanca narkotike që marrin këshilime e trajtim mjekësore psiko-social	2	0	0		2	2	3	3
Obj 1.2: Zhvillimi i programeve të udhëhequra nga sektori i shërbimeve sociale komunale, bashkë me partner dhe rrjete për të përkrahur kujdesin emergjent, dhe shërbimin e specializuar afatgjatë të kujdesit social, si dhe monitorimin e raportimin.	Akt 1.2.1 Kujdesi për të moshuarit pa përkujdesje familjare	QPS	MFPT/MD, SHPMPF,	OJQ-të, Qendrat e Kujdesit Ditor Qendra e Shëndetit Mendor (Ministria e Shëndetësisë)	€/muaj/klient		DMS
	Akt 1.2.2 Ofrimi i shërbimeve për të moshuarit me nevoja të veçanta	QPS	MFPT/MD, SHPMPF,	OJQ-të, Qendrat e Kujdesit Ditor, Qendra e Shëndetit Mendor (Ministria e Shëndetësisë)	€/muaj/klient		DMS
	Akt 1.2.3 Ofrimi i shërbimeve për te moshuarit e ekspozuar ndaj abuzimit, braktisjes apo shfrytëzimit	QPS	MFPT/MD, SHPMPF,	OJQ-të, Qendrat e Kujdesit Ditor, Qendra e Shëndetit Mendor (Ministria e Shëndetësisë)	€/muaj/klient		DMS

Treguesit	Të dhënat aktuale 2023	Rezultati i Synuar - 2024	Rezultati i Aktual - 2024	Rezultati i Synuar -2025	Rezultati i Aktual -2025	Rezultati i Synuar -2026	Rezultati i Aktual -2026
Numri i të moshuarve pa përkujdesje familjare që marrin shërbime sociale	6	6	3	8	8	10	10
Numri i të moshuarve me nevoja të veçanta që marrin shërbime sociale	10	6	1	12	12	15	15
Numri i të moshuarve të ekspozuar ndaj abuzimit, braktisjes apo shfrytëzimit që marrin shërbime sociale	0	0	0	0	0	1	1
Obj 1.3: Vazhdimi i implementimit të aktiviteteve e shërbimeve post-monitorim, për të siguruar kualitet dhe qëndrueshmëri të përkrahjes dhe shërbimeve.							
Akt 1.1.1 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara		QPS	Ministria e drejtësisë / DSHSF (Departamenti per sherbime sociale dhe familjare)	OJQ dhe OSHC	(Buxhetin e posedon ministria) /vit		DMS
Akt 1.1.2 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët ne konflikt me ligjin		QPS	Policia, PTHP, GJTHP, Shërbimi Sprovues-MD	OJQ, Strehimoret, KOMF, Prindërit			DMS
Akt 1.1.3 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët e përfshirë ne martesa te hershme		QPS	GHTH, Policia, Shëndetësia	OJQ, Strehimoret,			DMS
Akt 1.1.4 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët e ekspozuar ndaj abuzimit, braktisjes apo shfrytëzimit		QPS	GJTH, PTHP, Policia Arsimi, Shëndetësia	OJQ, Strehimoret, Familjet Strehuese, TdH			DMS
Akt 1.1.5 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët me sjellje asociale		QPS	GJTH, PTHP, Policia, Shëndetësia	OJQ, Strehimoret, Arsimi, Familjet Strehuese, TdH			DMS
Akt. 1.1.6 Ofrimi i shërbimeve për fëmijët në situatë rruge – (fëmijë që punojnë dhe lëmosh kërkues).		QPS	GJTH, PTHP, Policia, Shëndetësia	OJQ, Strehimoret, Arsimi, Familjet Strehuese, TdH			DMS
Akt. 1.1.7 Ofrimi i shërbimeve për të rinjët që abuzojnë substanca narkotike dhe familjet e tyre		QPS	GJTH, PTHP, Policia, Arsimi, Shëndetësi	OJQ, Strehimoret, Arsimi, Familjet Strehuese, KOMF, TdH			DMS
Treguesit	**Të dhënat aktuale - 2023**	**Rezultati i Synuar - 2024**	**Rezultati i Aktual - 2024**	**Rezultati i Synuar -2025**	**Rezultati i Aktual -2025**	**Rezultati i Synuar -2026**	**Rezultati i Aktual -2026**

	Numri i fëmijëve me Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që marrin shërbime sociale	182	185	183	190	185	200	195
	Numri i fëmijëve ne konflikt me ligjin që marrin shërbime sociale	115	30	13	120	120	125	125
	Numri i fëmijëve te përfshirë ne martesa te hershme që marrin shërbime sociale	1	0	0	3	3	3	3
	Numri i fëmijëve te ekspozuar ndaj abuzimit, braktisjes apo shfrytëzimit që marrin shërbime sociale	2	0	0	2	2	3	3
	Numri i fëmijëve me sjellje asociale që marrin këshillime e asistencë sociale	33	5	4	35	35	37	37
	Numri i fëmijëve Iëmoshë-kërkues rruge që marrin këshilime, e trajtim social	3	3	2	5	5	7	7
	Numri i të rinjve abuzues me substanca narkotike që marrin këshilime e trajtim mjekësore psiko-social	1	0	0	3	3	5	5

Shërbimet Sociale dhe Familjare		Ndërlidhja me Plane Tjera			GJITHPËRFSHIRJA JONË – *Plan-Veprimi Komunal i Shërbimeve Sociale* & Familjare			
PRIORITETI II		AKTIVITETI	INSTITUCIONI DREJTUES	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	HISEDARËT NË AKTIVITETE	BUXHETI	PLANI KOHOR	IMPLEMENTUESI
Avancimi i kapaciteteve, promovimi i telemjekësisë digjitalizimi i shërbimeve dhe zhvillimi i	**Obj 2.1:** Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve njerëzore, materiale dhe infrastrukturore	Akt 2.1.1 Ndërtimi i qendrës sociale/Renovim i QPS	MFPT/Komuna	DMS	Donatorët, OJQ,			Komuna
		Akt 2.1.2 Avancimi i kapaciteteve materiale e teknologjike	MFPT/Komuna	DMS	Donatorët, OJQ,			Komuna
		Akt 2.1.3 Avancimi i kapaciteteve njerëzore nga fusha e shëbimeve sociale	Komuna	DMS/donatorët	Donatorët, OJQ,			Komuna
		Akt 2.1.4 Partneritetet & bashkëpunimet vendore e ndërkombëtare	Komuna	DMS/donatorët	Donatorët, OJQ,			Komuna

platformave online

Treguesit		Të dhënat aktuale - 2023	Rezultati i Synuar -2024	ezultati i Aktual - 2024	Rezultati i Synuar -2025	Rezultati i Aktual -2025	Rezultati i Synuar -2026	Rezultati i Aktual -2026
Hapësirë e re për shërbime sociale			Shtëpia për fëmijë pa përkujdesje familjare (1)		Shtepia për përkujdesje ndaj personave të moshuar (1)			
Pajisje të reja për ofrim cilësor të shërbimeve sociale e familjare		Kompjuterë (, Llaptop, Pintera, Tavolina, Telefona (mobile), Veturë nga DRC (00km), Orendi (5), Tabela (4), Tabela per sticker (8), Frigorifer (2), Tablatë (11) (118 paisje nga EULEX) ne vitin 2020 Vetura nga komuna ne vitin 2021	Kompjuterë (4), Tabletë (5)		Veturë në dispozicion 24 orë për QPS (1)			
Trainime të vazhdueshme nga fusha specifike për stafin e shërbime sociale		23	28	15	25	25	28	28
Explorimi dhe instalimi i praktikave të mira për partneritete e bashkëpunime		6	10	8	10	10	12	12
Obj 2.2: Tranformimi digjital i shëbimeve sociale dhe shërbimeve online	**Akt 2.2.1 Krijimi i platformës autonome digjitale /e-gjithëpërfshirja/**		DMS	DMS, MPFT	DMS, MPFT, Donatorët		2024 / 2025	DMS
	Akt 2.2.2 Sistemi i Integruar i informacionit dhe menaxhimit të shërbimeve sociale e familjare		DMS	DMS, MPFT	DMS, MPFT, Donatorët		2024 / 2025	DMS
	Akt 2.2.3 Ngritja e Kapaciteteve të IT & Digjitale për fushën e shërbimeve sociale dhe familjare komunale		DMS	DMS, MPFT	DMS, MPFT, Donatorët		2023 / 2025	DMS
	Akt 2.2.4 Avancimi i komunikimit më publikun, promovimi e vizibiliteti		DMS	DMS, MPFT	DMS, MPFT, Donatorët		2023 / 2025	DMS

Treguesit	Të dhënat aktuale - 2023	Rezultati i Synuar -2024	Rezultati i Aktua -2024	Rezultati i Synuar -2025	Rezultati i Aktual -2025	Rezultati i Synuar -2026	Rezultati i Aktual -2026
Funksionimi dhe operimi i Platformës online	0	0	0	1	1	1	1
Popullimi dhe përpunimi i plotë i të dhënave për shërbime sociale e familjare	1	1	1	1	1	1	1
Përditësimi i plotë i të dhënave dhe manxhimi	1	1	1	1	1	1	1
Komunikimi i avancuar dhe kreativ me publikun, përfituesit, mediat përmes platformës dhe rrjeteve sociale	0	0	0	1	1	1	1

Obj 2.3: Promovimi i Telemjekësisë përmes shërbimit këshillues e informues	Akt 2.3.1 Instalimi i setit të telemjekësisë në QKMF/QPS	DMS/QPS	Komuna, Ministria	Komuna, Ministria, OJQ, Donatorët		2024 - 2025	DMS/QPS
	Akt 2.3.2 Trainimi dhe aftësimi i personelit për operim me pajisjet e telemjekësisë	DMS/QPS	Komuna, Ministria	Komuna, Ministria, OJQ, Donatorët		2024 - 2025	DMS/QPS
	Akt 2.3.3 Pilotimi i shërbimeve të telemjekësisë të 25 përfitues (censorë/telekomandë)	DMS/QPS	Komuna, Ministria	Komuna, Ministria, OJQ, Donatorët		2024 - 2025	DMS/QPS

Treguesit	Të dhënat aktuale 2023	Rezultati i Synuar - 2024	Rezultati i Aktual - 2024	Rezultati i Synuar - 2025	Rezultati i Aktual -2025	Rezultati i Synuar -2026	Rezultati i Aktual -2026
Numri i i shërbimeve të ofruara	6735	7000	1696	7050	7020	7150	7150
Numri i vizitave në teren	167	90	29	100	100	120	120
Numri i përfituesve nga shërbimet e njësisë së telemjekësisë	0	0	0	10	10	15	15

Shërbimet Sociale dhe Familjare		Ndërlidhja me Plane Tjera			GJITHPËRFSHIRJA JONË - Plan Veprimi Komunal i Shërbimeve Sociale & Familjare			
PRIORITETI III	OBJEKTIVA	AKTIVITETI	INSTITUCIONI DREJTUES	INSTITUCION MBËSHTETËS	HISEDARËT NË AKTIVITETE	BUXHETI	PLANI KOHOR	IMPLEMENTUESI
Avancimi i mundësive për partneritete dhe bashkëpunime	*Obj 3.1:* Nxitja zotuese e bashkëpunimeve, partneriteteve dhe ndërlidhjeve	Akt 3.1.1 Disenjimi i mundësive të barabarta për iniciativa me karakter promovimi e rrjetëzimi nga fusha sociale	Komuna-MFPT/MD	Qeveria, Komuna, OJQ, Donatorë	OJQ, Handikos, QPS	€/mujore		DMS
		Akt 3.1.2 Investimet efiçiente e të qëndrueshme në strukturat e infrastrukturës sociale *hapësira shkollore,	QPS Qendrat e specializuara	MFPT/MD, MSH, DSHPS,	OJQ, Handikos,	€/mujore		DMS

ve me nivel qendror institucional, donatorë, partner dhe komunitetin e biznesit, diasporës dhe programeve tjera sektoriale

qendra kulturore, rinore, sportive, edukaave, turistike, publike, për fëmijë, gra, të rinj e të moshuar, biznese dhe diasporë		Qendrat e Specializuara				
Akt 3.1.3 Promovim të nismave e iniciativave nga partneritet publik-private në modernizim dhe menaxhim të infrastrukturës sociale e mbështetëse	QPS, ZRP, Qendrat e Specializuara	MFPT, MSH, Komuna, Qendrat e specializuara	OJQ, Handikos	€/fëmijë		DMS
Akt 3.1.4 Investim në fushata të përbashkëta vetëdijësimi për njohjen e vlerës së shtuar të infrastrukturës mbështetëse sociale, si rritje e mundësive shumë-dimensionale për ndërkombëtarizim dhe bashkëpunime të reja sociale	QPS, QKMF, QSHM	MFPT/MD, MSH, Komuna, Qendrat e specializuar	OJQ, Handikos	€/fëmijë		DMS
Akt 3.1.5 Koncepte të reja të administrimit e menaxhimit jo-publik të infrastrukturës sociale mbështetëse	QPS, QKMF, QSHM	MFPT/MD, MSH, Komuna, Qendrat e specializuar	OJQ, Handikos,	€/fëmijë		DMS

Treguesit	Të dhënat aktuale - 2023	Rezultati i Synuar -2024	Rezultati i Aktual -2024	Rezultati i Synuar -2025	Rezultati i Aktual -2025	Rezultati i Synuar -2026	Rezultati i Aktual -2026
Numri i iniciativave për promovim e rrjetëzim social	0	0	0	3	3	5	5
Numri i investimeve eficiente e të qëndrueshme në strukyturat e infrastrukturën sociale për grupt dhe kategoritë sociale	8	0	1	10	10	12	12
Numri i iniciativave publiko-private nga sektori social	291	300	291	310	310	330	330
Numri i aktiviteteve informuese, vetëdijësuese, promovuese, mediale etj për sektorin social dhe mbështetës	20	12	12	25	25	32	32
Numri i pilot projekteve si konceote të reja të administrimit e menaxhimit jo-publik të infrastrukturës sociale mbështetëse	0	0	0	2	2	3	3

Obj 3.2: *Zhvillimi i kapaciteteve dhe*	Akt 3.2.1 Ndërtimi i kapaciteteve zhvillimore për mekanizmat dhe organizatata publike dhe jopublike që merren me sektorin e shërbimeve sociale e familjare	QPS. Policia	PTHP, GJHP, Policia, Shëndetësia	Qendrat e specializuara, Strehimoret e Sigurisë	€		DMS

ngritja institucionale për bashkëpunime të avancuara	Akt 3.2.2 Ngritja e kapaciteteve të punonjësve institucional në ngritjen e cilësisë dhe zgjerimin e shërbimeve profesionale	QPS, Strehimoret e Sigurisë	Strehimoret e Sigurisë, MFPT/MD, MPB	OJQ-të e Shoqëria Civile	€		DMS
	Akt 3.2.3 Projekte dhe programe zhvillimore në fushën e bashkëpunimeve sektoriale ndër-regjionale, nacionale dhe ndërkombëtare	QPS, ZKK	MPB, MFPT/MD, Komuna, QPR	OJQ-të, IOM, UNHCR, CRPK			DMS
	Akt 3.2.4 Bashkëfinancimi i projekteve në fushën e trainimit dhe aftësimit profesional në sektorin e shërbimeve sociale	QPS, GJTHP	QPS, GJTHP, Këshillimoretpsiko-sociale	OJQ-të, Qendra për Ndihmë Juridike falas, Këshillimoret psiko-sociale			DMS
							DMS

Treguesit	Të dhënat aktuale 2023	Rezultati i Synuar -2024	Rezultati i Aktual -2024	Rezultati i Synuar -2025	Rezultati i Aktual -2025	Rezultati i Synuar -2026	Rezultati i Aktual -2026
Numri i zyrtarëve profesional publik e jo-publik të trajnuar/aftësuar në sektorin e shërbimeve sociale	8	11	8	11	11	12	12
Numri i zyrtarëve profesional të trajnuar/aftësuar në ngritjen e cilësisë dhe zgjerimin e shërbimeve profesionale sociale	8	11	8	11	11	12	12
Numri i projekteve dhe programeve të aprovuara/impplementuara nga sektori i shërbime sociale në partneritet	1	1	1	3	3	3	3
Numri i projeketeve me bashkëfinancim për trajnime/aftësime profesionale nga sektori shërbimeve sociale	0	0	0	1	1	3	3

Obj 3.3: *Infrastrukturë sociale mbështetëse partneriteti*	**Akt 3.3.1 Investimi në hapësirat/këndet multifunksionals në qëndrat e shërbimeve sociale/familjare**	QPS	DSHP, MFPT/MD, Familjet Strehuese	OFAP, Familjet Strehuese, UNDP	€		QPS
	Akt 3.3.2 përmirësimi i inventarit dhe hapësirave për aktivitete extra-modulare	QPS	DSHP, MFPT/MD, Familjet Strehuese	OFAP, Familjet Strehuese			QPS

Akt 3.3.3 Restaurimi dhe ruatja e aseteve strategjike të sektorit të shërbimeve sociale e familjare	QPS	DSHP, MFPT/MD, Familjet Strehuese	OFAP, Familjet Strehuese			QPS
Akt 3.3.4 Organizimi i aktiviteteve ndihmuese, promovuese e vetëdijësuese me akterët e mbrendshëm dhe të jashtëm	QPS	DSHP, MFPT/MD, Familjet Strehuese	OFAP, Familjet Strehuese			QPS
Akt 3.3.5 ndër-regjionalizimi dhe ndërkombëtarizimi i bashkëpunimeve dhe partneriteteve sektoriale	QPS	DSHP, MFPT/MD, Familjet Strehuese	OFAP, Familjet Strehuese			QPS
Akt 3.3.6 Avancimi i sistemit të shërbimeve sociale dhe familjare me komunitetet, klusteret dhe odat e asociacionet tjera partnere	QPS	DSHP, MFPT/MD, Familjet Strehuese	OFAP, Familjet Strehuese			QPS

Treguesit	Të dhënat aktuale 2023	Rezultati i Synuar -2024	Rezultati i Aktual -2024	Rezultati i Synuar -2025	Rezultati i Aktual -2025	Rezultati i Synuar -2026	Rezultati i Aktual -2026
Numri i Hapësirave/këndeve të reja	0	1	0	0	0	1	1
Numri i Inventarit të renovuar/përmirësuar për aktivitete extra-modulare	0	0	0	0	0	1	1
Numri i aktiviteteve të organizuara (ndihmuese/promovuese/vetëdijësuese)	3	3	2	5	5	6	6
Numri i aktiviteteve ndër-regjionale e ndërkombëtare për bashkëpunim dhe partneritet sektoriale	0	1	0	1	1	1	1
Numri i praktikave të mira në sistemet e shërbimeve sociale e familjare të implementuara	0	0	0	3	3	5	5

Shërbimet Sociale dhe Familjare		Ndërlidhja me Plane Tjera			GJITHPËRFSHIRJA JONË - Plan Veprimi Komunal i Shërbimeve Sociale & Familjare			
PRIORITETI IV		AKTIVITETI	INSTITUCIONI DREJTUES	INSTITUCION MBËSHTETËS	HISEDARËT NË AKTIVITETE	BUXHETI	PLANI KOHOR	IMPLEMENTUESI
Ofrimi i resurseve dhe mjeteve si dhe mbështetja sociale për fëmijët dhe të rinjt për tranzicion të suksesshëm rinor dhe zhvillim	***Obj 4.1:*** *Përkrahja e fëmijëve dhe të rinjve në tranzicionin e suksesshëm në moshën madhore dhe shërbimet përkatëse (pas mbështetjes institucionale)*	Akt 4.1.1 Mbështetja e të rinjëve për zhvillim karriere, krijim familje, punësim e mirëqenie	Komuna - MFPT/MD	Qeveria, Komuna, OJQ, Donatorë	OJQ, Handikos			DMS
		Akt 4.1.2 Ofrimi i mbështetjes për absorbimin e subvencioneve dhe incentivave institutionale dhe masave qeveritare përkrahëse	QPS Qendrat e specializuara	MFPT/MD, MSH, DSHPS, Qendrat e Specializuara	OJQ, Handiko			DMS
		Akt 4.1.3 Ndërlidhje e të rinjve me programet dhe mbështetjen tranzicionale prej moshës adult në atë të pavarur	QPS, ZRP, Qendrat e Specializuara	MFPT/MD, MSH, Komuna, Qendrat e specializuara	OJQ, Handikos	€/fëmijë		DMS
		Akt 4.1.4 Mbështetja dhe trajnimi në aftësim profesional, shkathtësi të buta, Shkathësi pune dhe benefite tjera drejt gjenerimit të të hyrave, përfitimeve sociale, shëndetësore, familjare, të punësimit, banimit etj	QPS, QKMF, QSHM	MFPT/MD, MSH, Komuna, Qendrat e specializuar, APRK	OJQ, Handikos			DMS

Treguesit	Të dhënat aktuale - 2023	Rezultati i Synuar -2024	Rezultati i Aktual -2024	Rezultati i Synuar -2025	Rezultati i Aktual -2025	Rezultati i Synuar -2026	Rezultati i Aktual -2026
Numri i të rinjëve që marrin mbështetje për zhvillim karriere, krijim familje, punësim e mirëqenie	0	0	0	50	50	100	100
Numri i të rinjëve që mbështeten për absorbimin e subvencioneve dhe incentivave institutionale dhe masave qeveritare përkrahëse	0	0	0	0	0	0	0
Numri i të rinjëve që facilitohen në ndërlidhje me programet dhe mbështetjen tranzicionale prej moshës adult në atë të pavarur	0	0	0	0	0	0	0

	Numri i të rinjëve që marrin mbështetje dhe trajnime në aftësim profesional, shkathtësi të buta, Shkathësi pune dhe benefite tjera drejt gjenerimit të të hyrave, përfitimeve sociale, shëndetësore, familjare, të punësimit, banimit	0	0	0	10	10	20	20
Obj 4.2: *Zhvillimi dhe implementimi i fushatave vetëdijësuese dhe promovuese për tranzicionin e shëndetshëm të pjekurisë dhe zhvillim të profileve për moshat e rritura.*	Akt 3.2.1 Ofrimi i shërbimeve për gratë, viktima të dhunës		QPS. Policia	PTHP, GJHP, Policia, Shëndetësia	Qendrat e specializuara, Strehimoret e Sigurisë	€		
	Akt 3.2.2 Ofrimi i shërbimeve për gratë, viktima të trafikimit		QPS, Strehimoret e Sigurisë, Strehimorja e Sigurisë së lartë në Lipjan	Strehimoret e Sigurisë, MFPT/MD, MPB	OJQ-të e Shoqëria Civile	€		
	Akt 3.2.3 Ofrimi i shërbimeve për familjet e riatdhesuara		QPS, ZKK	MPB, MFPT/MD Komuna, QPR	OJQ-të, IOM, UNHCR, CRPK			
